

المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, M ëshiruesit!

RIZGJIMI ISLAM NDËRMJET
MOSPAJTIMIT TË LEJUAR DHE PËRÇARJES SË URREJTUR

Dr. Jusuf Kardavi

Botuar nga: Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

DY FJALË PËR AUTORIN 10
HYRJE 11
METODOLOGJIA JONË NË KËTË HULUMTIM 15
HYRJE 17
LLOJET DHE SHKAQET E 17
MENDIMEVE TË NDRYSHME 17
1. SHKAQET MORALE 18
2. SHKAQET INTELEKTUALE 19
MENDIMET E NDRYSHME 21
FIKHORE (JURIDIKE) 21
KAPITULLI I PARË 24
BASHKIMI ËSHTË OBLIGIM KURSE PËRÇARJA KRIM 24
PJESA E PARË 24
BASHKIMI DHE BASHKËPUNIMI 24
JANË OBLIGIME ISLAME 24
NGA UDHËZIMET E SUNNETIT 31
TË PEJGAMBERIT A.S. 31
ISLAMI URREN PËRÇARJEN 36
PJESA E DYTË 40

PËRÇARJA E UMMETIT NUK 40
ËSHTË PËRCAKTIM HYJNOR E 40
AS I PËRHERSHËM 40
HADITHI I PËRÇARJES SË 45
UMMETIT NË 73 FRAKSIONE 45
KAPITULLI I DYTË 52
BAZAT TEORIKE E PRAKTIKE TË FIKHUT TË MENDIMEVE TË NDRYSHME 52
PJESA E PARË 52
DALLUESHMËRIA NË ÇËSHTJET E DORËS SË DYTË TRAJTOHET 52
SI DOMOSDOSHMËRI, MËSHIRË E GJERËSI 52
1. DALLUESHMËRIA DHE DOMOSDOSHMËRIA 52
NATYRA E FESË 53
NATYRA E GJUHËS 55
NATYRA E NJERËZVE 57
NATYRA E GJITHËSISË DHE E JETËS 61
B. EKZISTIMI I MENDIMEVE TË NDRYSHME ËSHTË MËSHIRË 62
KUNDËRSHTIM DHE MBROJTJE 66
MENDIMET E NDRYSHME NË ÇËSHTJET E DORËS SË DYTË KONSIDEROHEN MËSHIRË 67
EKZISTIMI I MENDIMEVE TË NDRYSHME ËSHTË PASURI 70

I. MENDIMET E NDRYSHME MEDHHEBORE 72
MEDHHEBET E BESIMIT 73
MEDHHEBET E FIKHUT 73
EKZISTIMI I MENDIMEVE TË NDRYSHME NË SHEKUJT MË TË MIRË TË UMMETIT 75
MENDIMET E NDRYSHME KANË EKZISTUAR EDHE NDËRMJET MELEQVE 79
EDHE NDËRMJET PEJGAMBERËVE PATI MENDIME TË NDRYSHME 80
POLEMIKA E URREJTUR 82
PJESA E DYTË 84
MBËSHTETJA NË METODËN MESATARE DHE LARGIMI NGA HOLLËSITË E TEPËRTA NË FE 84
SHKATËRRIMI I EKSTREMISTËVE 87
PJESA E TRETË 93
MBËSHTETJA NË ÇËSHTJET E QARTA E JO NË TË DYSHIMTAT 93
PJESA E KATËRT 96
LARGIMI NGA QËNDRIMET 96
KATEGORIKE NË ÇËSHTJET E 96
IXHTIHADIT 96
PJESA E PESTË 99
NJOHURITË E OBLIGUESHME 99
MBI MENDIMET E NDRYSHME 99

TË DIJETARËVE 99
PJESA E GJASHTË 106
PËRKUFIZIMI I KONCEPTEVE 106
DHE TERMINOLOGJISË 106
PJESA E SHTATË 117
ORIENTIMI I MUSLIMANËVE 117
NGA ÇËSHTJET E RËNDËSI- 117
SHME TË UMMETIT 117
PJESA E TETË 124
BASHKËPUNIMI NË ÇËSHTJET E PËRBASHKËTA 124
NË FUND: 132
PJESA E NËNTË 133
TOLERANCA NË ÇËSHTJET 133
DISKUTABILE 133
A. RESPEKTIMI I MENDIMIT TË TJETËRKUJT 134
B. MUNDËSIA E SAKTËSISË SË SHUMËFISHTË 135
C. HARMONIZIMI ME REALITETIN 140
DYSHIME 142
PJESA E DHJETË 145

MOSAKUZIMI I ATIJ QË 145
DEKLARON SE S'KA ZOT 145
TJETËR PËRVEÇ ALLLLAHUT 145
NUK AKUZOHET PËR KUFËR AI QË I REFUZON HADITHET "AHAD" PËR SHKAK TË NDONJË DYSHIMI 154
KAPITULLI I TRETË 157
BAZAT MORALE TË FIKHUT TË DALLIMEVE NË MENDIME 157
RËNDËSIA E BAZAVE MORALE 157
PJESA E PARË 158
SINQERITETI DHE PASTRIMI 158
NGA EPSHET DHE PASIONET 158
PJESA E DYTË 162
LARGIMI NGA MBËSHTETJET 162
EKSTREMISTE NË PERSONA, ... 162
DOKTRINA E FRAKSIONE 162
FANATIZMI DHE MENDIMI PERSONAL 163
FANATIZMI NË MEDHHEB 165
EKSTREMIZMI KUNDËR MEDHHEBEVE 172
DHE IMAMËVE 172
FANATIZMI NDAJ 179

NJONJË GRUPI APO PARTIE 179
FORMAT MORALE TË ÇLIRIMIT NGA FANATIZMI 181
PJESA E TRETË 182
TË MENDUARIT MIRË PËR TË 182
TJERËT 182
PJESA E KATËRT 187
MOSAKUZIMI I ATYRE QË 187
MENDOJNË NDRYSHE 187
SHEMBUJ NGA KULTURA E DIALOGUT MIDIS DIJETARËVE TË NJOHUR 188
PJESA E PESTË 194
LARGIMI NGA QËNDRIMET 194
KATEGORIKE E ARMIQËSORE 194
PJESA E GJASHTË 200
ZHVILLIMI I DIALOGUT NË 200
FORMËN MË TË MIRË 200
PËRMBYLLJE 207
Ç' DËSHIROJMË ME KËTË 207
HULUMTIM? 207
IMAM HASAN EL-BENNA DHE FIKHU I DALLIMEVE 210

ASPEKTI POLITIK 210
ASPEKTI IDEOLOGJIK 211
ASPEKTI FETAR 211
BASHKOJMË E NUK PËRÇAJMË 213
DALLIMI ËSHTË I DOMOSDOSHËM 214
UNANIMITETI NË ÇËSHTJET DYTËSORE ËSHTË I PAKUPTIMTË 215
KËRKOJMË FALJE PREJ ATYRE QË MENDOJNË NDRYSHE NGA NE 215

DY FJALË PËR AUTORIN

- U lind në Egjipt më 1926/1344

- Kreu (hifzin) memorizimin e Kur'anit në moshën 10 vjeçare.

- Studioi në El Ez-her nga niveli fillor deri në atë universitar dhe më 1973/1393 mori titullin "Doktor në filozofi".

- Punoi si hatib, mësues dhe autor në Departamentin e Vakëfeve dhe në El Ez-her.

- Aktualisht është i caktuar për dekan të Fakultetit të Sheriatit dhe Studimeve Islame si dhe drejtor i Qendrës së Studimeve mbi Sunnetin dhe Siren në Universitetin e Katarit. Është anëtar i shumë shoqatave akademike islame etj.

- Ka botuar mbi 42 libra që trajtojnë aspekte të ndryshme të jetës, letërsisë dhe poezisë islame. Midis tyre janë: Fikhu i zekatit; Hallalli dhe harami në Islam; Imani dhe jeta; Fetva bashkëkohore; Rizgjimi islam ndërmjet kundërshtimit dhe ekstremizmit, etj.

- Artikujt dhe punimet e tij janë botuar në shumë gazeta dhe revista arabe islame.

- Dr. Kardavi konsiderohet si një nga mendimtarët më të moderuar islamë dhe njëri prej atyre që kombinojnë diturinë tradicionale të Sheriatit me një kuptim bashkëkohor të problemeve (Fikh ul

Vâki'). Shkrimet e dr. Kardavit kanë gjetur një përkrahje të gjerë në të gjitha shtresat e botës islame dhe shumë prej tyre janë përkthyer në gjuhë të ndryshme.

HYRJE

Falënderimi i takon All-llahut kurse paqja dhe mëshira Pejgamberit a.s., familjes së tij, shokëve dhe ithtarëve që i ndjekin udhëzimet e tij.

Nuk më brengos ballafaqimi i zgjimit bashkëkohor islam me armiqtë e jashtëm të cilët e shfrytëzojnë çdo rast për veprimtaritë e tyre të fshehta, ngase kjo çështje është e logjikshme dhe rezultat i ndeshjes ndërmjet të vërtetës dhe të pavërtetës apo ndërmjet të mirës e të keqes. Këtë ligj e ka krijuar Zoti në gjithësinë ku jetojmë:

"Ne, secilit pejgamber ia bëmë ndonjë armik prej jobesimtarëve..!"

(Furkan, 31).

Në kuadër të armiqësisë kundër ummetit e besimtarëve, Zoti i Madhëruar thotë:

"Ata do t'ju luftojnë juve vazhdimisht për t'ju zbrapsur, nëse munden, nga feja juaj".

(Bekare, 217).

Përkundrazi, unë brengosem nga sulmet e brendshme kundër zgjimit, nga armiqësia ndaj njëritjetrit dhe nga mjerimi i brendshëm.

Nuk brengosem në qoftë se këtë zgjim e kaplojnë shkolla, shoqëri e grupacione që kanë metodologji të posaçme për t'i shërbyer Islamit dhe për ta përforcuar atë në tokë konform qëllimeve të tyre të caktuara, mënyrave e periudhave të definuara dhe qëllimit të pastër të ithtarëve nga aspekti i fuqisë, besnikërisë, drejtësisë dhe pastërtisë.

Nuk jam aq naiv që të thërras në një shoqëri ose në një lëvizje që i tubon të gjithë aktivistët muslimanë nën një ombrellë, nën një udhëheqje, ngase një kërkesë e tillë vështirë realizohet.

Në shumë studime të mia kam theksuar se nuk jam kundër llojllojshmërisë së metodologjisë që ka për qëllim t'i ndihmojë Islamit, por me kusht që mendimet e ndryshme të jenë cilësore dhe profesionale e jo konfrontuese dhe kundërshtuese. Në mesin e shoqërive të tilla duhet të mbizotërojnë bashkëpunimi e harmonia derisa ta komplementojnë njëra-tjetrën, t'i ndihmojnë njëra-tjetrës dhe të mbështeten në çështje të përbashkëta në një rresht sikur të ishin një trup.

Ajo që me të vërtetë më brengos është ekzistimi i atyre që nuk janë seriozë në këto çështje, që shkaktojnë përçarje në çdo rast, që ndezin flakën e mospajtimeve, që nxisin armiqësi e urrejtje e që mbështeten gjithmonë në çështjet që përçajnë e jo në ato që bashkojnë. Njerëzit e tillë gjithmonë janë të kënaqur me mendimet e tyre, përçajnë shoqërinë dhe i akuzojnë të tjerët.

Në të vërtetë, ekzistimi i mendimeve të ndryshme nuk është kurrfarë rreziku, posaçërisht në çështjet e dorës së dytë (furu'e) dhe në disa çështje parësore (burimore) jothelbësore (usul gajru

esasijje), por rreziku kanoset nga përçarja dhe armiqësia për të cilat na e kanë tërhequr vërejtjen All-llahu dhe Pejgamberi i Tij.

Për këtë shkak zgjimi islam dhe lëvizja islame, me të gjitha drejtimet dhe shkollat e veta, kanë patur nevojë për vetëdije të thellë dhe njohuri të plotë për atë që e quajmë "Fikhu i mendimeve të ndryshme". Ky lloj i fikhut është njëri nga pesë llojet për të cilët duhet të kemi përqëndrim të plotë ngase ndiejmë nevojë të madhe për ta. Këto lloje janë:

1. Fikhu i qëllimeve - Ky lloj përqëndrohet në parcialet dhe në termat e Sheri'atit e pastaj kalon në universaliet e të gjitha aspekteve jetësore. Kontribut më të madh në këtë kontekst ka dhënë Imam Shatibiu me veprën e tij *"Muvafakat"*, ku më së shumti mbështetet në qëllimet shoqërore.

2. Fikhu i prioriteteve - dhe gradat e veprave. Rreth kësaj çështjeje kam diskutuar në librin tim *"Rizgjimi islam ndërmjet kundërshtimit dhe ekstremizmit"*, i cili ende ka nevojë për një studim edhe më të thellë, më të hollësishëm e më praktik.

3. Fikhu i ligjeve - Ky lloj ka të bëjë me ligjet kozmike e shoqërore të cilat i krijoi All-llahu për botën tonë në formë të pandryshuar.

4. Fikhu i krahasimit midis të mirave dhe të këqijave - Ky lloj ka të bëjë me fikhun e realitetit dhe me studimin e tij shkencor në bazë të informatave dhe mundësive që ekzistojnë në kohën tonë.

5. Fikhu i mendimeve të ndryshme - Këtë lloj e aplikuan sahabët, tabi'inët dhe imamët gjatë shekujve më të ndritur të ummetit. Mendimet e tilla të ndryshme shkencore nuk i dëmtuan, por ne s'i kuptuam dhe filluam ta sulmojmë njëri-tjetrin për shkak të çështjeve të vogla apo pa kurrfarë shkaku!!

Rreth kësaj çështjeje ka shkruar vëllai ynë i nderuar, prof. dr. Taha Xhabir Ulvani në librin "Kultura e dialogut në Islam"* , i cili është botuar brenda vargut të botimeve "Ummeti". Ky libër ka karakter shkencor dhe pa dyshim është shumë dobiprurës. Në këtë libër ai është mbështetur në metodën historike, kurse ky libër i imi është plotësim dhe shtojcë e tematikës të cilën ai e ka shtjelluar. Në këtë libër unë jam mbështetur në realitetin që e përjeton aktiviteti islam dhe në idetë, rrymat e doktrinat të cilat e përçanë unitetin, e përçanë bashkësinë dhe e shkaktuan armiqësinë midis nesh.

Gati se çdo ditë marr letra nga mbarë bota islame, përmes të cilave i pranoj ndikimet nga vëllezërit të cilët mundohen vetëm të shkaktojnë përçarje e t'i akuzojnë robërit e All-llahut pa i analizuar rrethanat, realitetin, nevojat e obligueshme dhe sprovat.

Për këtë shkak iu falënderova anëtarëve të Lidhjes së Rinisë Islame Arabe, të cilët në kongresin që u mbajt në Amerikë në vitin 1989, kërkuan prej meje të shkruaj rreth kësaj problematike, ngase e kuptoja rëndësinë e zgjimit islam dhe nevojën për lëvizjen islame. Edhe pse kjo tematikë është e vështirë, iu qasa duke u mbështetur në All-llahun e Madhëruar, me shpresë se këto faqe do ta ndriçojnë rrugën e aksionit dhe të vetëdijes islame si dhe zgjimin e vërtetë islam. Gjithashtu shpresoj se nga ky libër do të kenë dobi autori, lexuesi dhe secili që ndihmoi në botimin dhe shpërndarjen e tij.

O Zot!

* p.s. Po ashtu e kemi përkthyer në gjuhën shqipe dhe botuar më 2000 (LOGOS-A)

Na furnizo me dritën që do t'i ndriçojë errësirat, me dalluesin që do të ndihmojë në dallimin ndërmjet gjërave të dyshimta dhe me peshojën që do të na udhëzojë në udhëkryqe..!

"Zoti ynë, vazhdona dritën tonë, falna neve! Vërtet, Ti je i plotfuqishëm për çdo send".

(Tahrimë, 8).

Prof. dr. Jusuf KARDAVI

DOHA

22 Xhumadel-ula 1410 (hixh.)

20 dhjetor 1989

METODOLOGJIA JONË NË KËTË HULUMTIM

Hulumtimi ynë për fikhun e mendimeve të ndryshme mbështetet në baza shkencore e praktika ideologjike e morale si dhe përmban hyrjen, tre kapituj dhe përmbylljen.

Hyrja ka të bëjë me llojet dhe shkaqet e paraqitjes së mendimeve të ndryshme.

Kapitulli i parë ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë titullohet "Bashkimi dhe bashkëpunimi janë obligime fetare", kurse pjesa e dytë: "Përçarja e ummetit nuk është përcaktim hyjnor e as i përhershëm".

Kapitulli i dytë i shtjellon bazat teorike e praktike në të cilat mbështetet fikhu i mendimeve të ndryshme. Ky kapitull ndahet në dhjetë pjesë:

Pjesa e parë: Mendimet e ndryshme në çështjet e dorës së dytë trajtohen si domosdoshmëri, mëshirë e pasuri.

Pjesa e dytë: Ndjekja e programit objektiv (mesatar) dhe largimi nga teprimi në fe.

Pjesa e tretë: Mbështetja në çështjet e qarta e jo në ato të dyshimta.

Pjesa e katërt: Largimi nga qëndrimet kategorike në çështjet e ixhtihadit.

Pjesa e pestë: Domosdoshmëria e të njohurit me mendimet e ndryshme të dijetarëve.

Pjesa e gjashtë: Përkufizimi i koncepcioneve dhe definicioneve.

Pjesa e shtatë: Orientimi i muslimanit në çështjet e madhore të ummetit.

Pjesa e tetë: Bashkëpunimi në çështjet e përbashkëta.

Pjesa e nëntë: Toleranca në çështjet diskutabile.

Pjesa e dhjetë: Mosakuzimi i atij që deklaron se s'ka Zot tjetër përveç All-llahut.

Kapitulli i tretë i shtjellon bazat morale të fikhut të mendimeve të ndryshme dhe ndahet në gjashtë pjesë:

Pjesa e parë: Sinqeriteti dhe të pastruarit nga epshet dhe emocionet.

Pjesa e dytë: Të larguarit nga mbështetjet ekstreme në persona, doktrina e sekte.

Pjesa e tretë: Të menduarit mirë për të tjerët.

Pjesa e katërt: Mosakuzimi i atyre që mendojnë ndryshe.

Pjesa e pestë: Largimi nga qëndrimet kategorike armiqësore në mospajtim.

Pjesa e gjashtë: Zhvillimi i dialogut në formën më të mirë.

Këtu dëshiroj të theksoj se dallimi ndërmjet aspektit intelektual dhe moral nënkupton atë të dukshmen, edhe pse sipas Islamit, një dallim i tillë nga aspekti praktik nuk ekziston fare.

Përmbyllja përmban fjalë të shkurtra për qëllimin e këtij hulumtimi, për lartësimin e Islamit dhe për shpëtimin e ummetit nga kjo gjendje kritike. Ajo mbështetet në shembuj konkretë nga fikhu i mendimeve të ndryshme, gjegjësisht në njeriun që ka vlerë të madhe në përhapjen e thirrjes islame dhe në hapat konkretë islamë, e ky është imami martir, Hasan El-Benna.

HYRJE
LLOJET DHE SHKAQET E MENDIMEVE TË NDRYSHME

Shkaqet e mendimeve të ndryshme janë të shumëllojshme, por në përgjithësi mund të përkufizohen në dy lloje:

1. Në shkaqe morale dhe

2. Në shkaqe intelektuale

1. SHKAQET MORALE

Këto shkaqe janë të njohura për dijetarët dhe pedagogët të cilët i studiojnë shkaqet e ngjarjeve dhe të qëndrimeve në mënyrë thelbësore e jo vetëm sipërfaqësore. Shkaqet e tilla janë:

a. Mendjemadhësia dhe megalomania.

b. Paragjykimet negative ndaj të tjerëve dhe akuzat e shpejtuara e të paargumentuara.

c. Ndikimi i pasioneve si p.sh. vrapimi pas posteve udhëheqëse dhe dashuria ndaj vetvetes.

ç. Qëndrimi fanatik ndaj fjalëve të individëve, doktrinave e sekteve.

d. Fanatizmi ndaj ndonjë vendi, krahine, partie, bashkësie e udhëheqësi.

Të gjitha këto janë anë negative të moralit, ndërsa disa dijetarë i konsiderojnë shkatërruese të zemrave dhe për këtë shkak muslimani obligohet që t'i luftojë, të çlirohet prej tyre, të mos u dorëzohet as atyre e as djallit si dhe të bëjë përpjekje serioze kundër tyre.

Mendimet e tilla të ndryshme që janë rezultat i këtyre tipareve negative e shkatërruese nuk preferohen, ngase shkaktojnë përçarje.

2. SHKAQET INTELEKTUALE

Këto shkaqe kanë të bëjnë me mendime të ndryshme për një çështje, qoftë nga aspekti teorik, si p.sh. mendimet e ndryshme që kanë të bëjnë me çështjet e dorës së dytë të Sheriatit apo me çështjet e besimit që s'kanë të bëjnë me burimet kategorike, ose nga aspekti praktik, si p.sh. mendimet e ndryshme për qëndrimet politike për shkak të botëkuptimeve të nduarduarta, informatave relative, qëndrimeve fraksioniste dhe ndikimit negativ apo pozitiv të rrethit.

Si shembull konkret mund të merret qëndrimi i xhemateve islame në çështjet e shumta politike të kohës sonë, gjegjësisht fushatat parazgjedhore, hyrja në parlamente, hyrja në qeveritë ku në përgjithësi nuk praktikohet Islami, koalicionet me forcat joislame për ta mposhtur ndonjë forcë diktatoriale që ngulfat çdo mendim të lirë e heshtë çdo zë të lirë islam qoftë ai apo joislam, musliman apo jomusliman.

Disa mendime të tilla të ndryshme janë thjesht vetëm politike ngase kanë të bëjnë me fitore apo humbje, disa të tjera janë juridike islame ngase kanë të bëjnë me vendimin sheriatik për lejimin apo ndalimin e ndonjë çështjeje, si p.sh. pjesëmarrja në pushtet, koalicioni në pushtet me jomuslimanët apo me joislamistat, kandidimi i gruas në zgjedhje, kurse disa mendime janë të përfshira në to qëndrimin juridike me atë të interesit dhe atë politik.

Gjithashtu, në këtë kontekst mund të ceken qëndrimet e ndryshme në mesin e muslimanëve për metodat e reformës dhe ndryshimit.

Të fillojmë prej lart apo prej poshtë?

Të preferojmë rrugën e revolucionit dhe dhunës apo rrugën e gradualitetit dhe butësisës?

Të preferohet grusht shteti ushtarak, lufta politike apo formimi edukativ?

Të ketë përparësi puna me masat e gjera apo me të rinjtë?

A lejohet shumësia e lëvizjes aktive islame dhe që çdonjëra nga to të mbulon një fushëveprim apo patjetër duhet q të ketë vetëm një lëvizje komplete gjithëpërfshirëse etj?

Në këtë kontekst gjithashtu bën pjesë edhe përforcimi i njohurive në disa shkenca, si p.sh. në apologjetikë, sufizëm, logjikë, filozofi dhe në fikhun e medhhebeve. Disa kanë qëndrime fanatike në këto shkenca në disa prej tyre dhe i merr tërësisht ato pa zgjedhur në to e disa i refuzojnë ngase i konsiderojnë joislame dhe më tepër të dëmshme se sa të dobishme.

Ndërsa të tretët ndërmjetësojnë mes këtyre dy grupeve duke dhënë mundin të gjykojnë ashtu që marrin dhe lënë, pranojnë dhe refuzojnë nga to.

Në kuadër të mendimeve të ndryshme intelektuale hyjnë edhe qëndrimet ndaj disa ngjarjeve dhe personaliteteve historike. Nga ngjarjet historike veçojmë atë që ndodhi midis disa sahabëve, si p.sh., qëndrimi i Umerit ndaj Halidit, i Uthmanit ndaj Ibën Mes'udit e Ebu Dherrit, i Talhas, Zubejrit dhe Aishes ndaj Aliut, beteja e Siffinit, çështja e gjykimit etj. Nga personalitetet historike mund t'i theksojmë Muavijen me të babain e tij, Amër ibën Asin dhe Ebu Musa Esh'ariun (r.a.).

Nga personalitetet shkencore mund të përmendim disa apologjetë e sufistë, si p.sh. Ebu Hamid Gazaliun, Ebu Abbas ibën Tejmijjen, Muhjiddin ibën Arabin dhe personalitete të tjera të njohura rreth të cilëve njerëzit kanë qëndrime të ndryshme midis hyjnizimit dhe qortimit të tyre.

Dallimet më të mëdha paraqiten në çështjet e dytësore juridike (furuu) dhe në disa çështje akaidologjike jokategorike (gajru kat'i). Shembujt e mosmarrëveshjeve të tilla janë të shumtë, e ne do t'i cekim disa në vijim.

MENDIMET E NDRYSHME FIKHORE (JURIDIKE)

Nga shkaqet më të forta të mospajtimit dhe përçarjes ndërmjet togeve të rizgjimit islam është mospajtimi dhe dallueshmëria në degët e fikhut i cili rrjedh nga llojllojshmëria e burimeve dhe shkallëve në kuptimin e teksteve. E gjithë kjo ka të bëjë me të kuptuarit e tekstit, me induksionin në çështjet që nuk ka tekst, me komentet e gjera apo të thukta, me ekstremizimin apo liberalizimin në qëndrime, me animin nga shkolla tradicionale apo racionale, me aplikimin apo mosaplikimin e medhhebeve për të gjithë njerëzit apo me qëndrimin mesatar i cili i lejon njeriut të rëndomtë pasimin (e ixhtihadit të të tjerëve) pa e obliguar ato me vetëm një medhheb. E në anën tjetër kërkon nga ata që janë hulumtues shkencor t'i plotësojnë mangësitë e tyre shkencore sa të jenë në gjendje të shiqojnë e analizojnë argumentet e të zgjedhin nga to dhe të bëjnë ixhtihad – qoftë edhe të pjesërishëm në çështjet e reja.

Në sferën e pastërtisë bisedohet rreth qëndrimit ndaj detergjenteve të lëngshme dhe shpirtos që përdoren për pastrim, ndaj ujërave rrjedhës kur filtrohen, ndaj abdestit pas ngrënies së mishit të deves, pas prekjes së femrës pas prekjes së organeve gjenitale etj.

Në sferën e namazit shtjellohen qëndrimet e ndryshme ndaj lidhjes së duarve apo lëshimit të tyre, ndaj leximit të "Bismilahit" me zë, pa zë apo mosleximi fare, ndaj ezanit e ikametit, ndaj namazit me xhemat, ndaj uljes duke u mbështetur në duar para gjunjve apo e kundërta, ndaj namazeve që mund të bashkohen...

Në sferën e Zekatit bisedohet rreth asaj se a obligohet apo jo zekati në pemë, perime dhe të mbjella tjera si pambuku?

A lejohet nxjerrja e zekatit në të holla sidomos në zekatulfitr (vitrat) qpo jo? A ipet zekat vjetor për stoli të grave apo jo?

Në sferën e agjërimit bisedohet rreth konfirmimit të kohës së hyrjes së Ramazanit dhe Bajramit të Madh, rreth përcaktimit nga shikimi i një personi , grupi apo me llogari kalendarike...

Në sferën e haxhit bisedohet rreth asaj se a u lejohet haxhilerëve që udhëtojnë me aeroplanë t'i veshin hiramët në Xhidde apo jo, se a lejohet gjuajtja e gurëve para zevalit apo jo...

Në sferën e zbukurimit bisedohet rreth asaj se mjekrra a është vaxhib apo sunnet, a lejohet të rregullohet e të shkurtohet, si trajtohet prerja e mustakëve, a lejohen rrobat e gjata, a duhet muslimania ta mbulojë tërë trupin apo mjafton vetëm zbulimi i fytyrës dhe i duarve, a i lejohet muslimanes zbukurimi i lehtë si p.sh. kehli (pluhur i zi për zbukurimin e syve), unaza në dorë... a lejohet përdorimi i kolonjës me erë, çfarë mendimi i jepet fotografimit, çfarë trajtimi ka fotografimi i gjërave me hije dhe i atyre pa hije, posaçërisht fotografimi i rëndomtë dhe televizioni?

Në sferën e dëfrimit bisedohet rreth asaj se a lejohet dëgjimi i muzikës me instrumente apo pa instrumente, apo ndalohet në përgjithësi, e nëse lejohet atëherë me çfarë kushtesh?

Sa i përket ushqimit, bisedohet rreth asaj se a lejohet kafsha e prerë nga ithtarët e Librit dhe se a konsiderohen evropianët dhe amerikanët ithtarë të Librit?

Në fikhun financiar bisedohet rreth përdorimit të qirave, posaçërisht të vendbanimeve dhe tokave, rreth ndërhyrjes së shtetit në sferën e ekonomisë, rreth komentimit të haditheve që ndalojnë dhënien e tokës me qira, rreth haditheve që thonë se "ai që ka tokë le ta mbjellë ose le t'ia japë vëllait të vet", rreth llojeve të ndryshme të sigurimit dhe rreth punës në institucione bash-këkohore të cilat nuk i zbatojnë të gjitha dispozitat e Islamit.

Në fikhun politik, kushtetues dhe ndërkombëtar shqyrtohen çështjet e atyre që punojnë pa normat hyjnore të zbritura nga Zoti, gjegjësisht a konsiderohen jobesimtarë apo vetëm mëkatarë, rreth përdorimit të forcës për shkatrrimin e udhëheqësve të tillë, rreth personave të cilët përdorin forcën për t'i ndalur të këqijat në përgjithësi, rreth zgjedhjes në bazë të vendimit të njerëzve të autorizuar apo të trupit konsultativ, rreth vendimit të shurasë, rreth përcaktimit të kohës së udhë-heqjes së ndonjë province apo shteti, rreth punësimit të pakicave joislame në shtetin islam, rreth pakicës islame në shtetin joislam, rreth marrëdhënieve të shtetit islam me shtetet tjera a është bazë e tyre paqa apo lufta, rreth xhihadit se a është ai defansiv (mbrojtës) apo ofensiv, apo, me fjalë të tjera, a sulmohen jobesimtarët për shkak të mosbesimit të tyre apo për shkak të armiqësisë së tyre ndaj muslimanëve, rreth territorit të Islamit dhe atij të luftës apo ekziston edhe ndonjë territor tjetër si dhe rreth definimit të këtyre dy territoreve...

Këto ishin vetëm disa çështje rreth të cilave ka mendime të ndryshme dhe fetva e përgjigje të nduarnduarta, për shkak se për dijetarët këto janë çështje diligjensore (ixhtihad) që nuk kanë tekst sheriatik kategorik me domethënie të qartë dhe të prerë.

KAPITULLI I PARË
BASHKIMI ËSHTË OBLIGIM KURSE PËRÇARJA KRIM
PJESA E PARË
BASHKIMI DHE BASHKËPUNIMI
JANË OBLIGIME ISLAME

Për aktivistët dhe thirrësit në Islam qëllime kryesore duhet të jenë bashkimi, bashkëpunimi, bashkimi i zemrave, uniteti i radhëve dhe shmangia nga përçarja e mosmarrëveshja, nga çdo gjë që përçanë shoqërinë ose fjalën, nga armiqësia e dukshme dhe nga urrejtja e padukshme, sepse në të kundërtën, dobësohet feja dhe jeta e ummetit në këtë botë.

Asnjë fe nuk ka bërë thirrje në vëllazërim, bashkim, bashkëpunim, solidaritet e mirëqenie e as që ka tërhequr vërejtjen nga përçarja, mosmarrëveshja e armiqësia ashtu siç ka bërë Islami përmes Kur'anit dhe Sunnetit.

Në këtë kontekst, Kur'ani famëlart thotë:

"O ju që besuat, në qoftë se ju i bindeni një grupi të atyre që u është dhënë libri, ata, pas besimit tuaj, do t'ju kthejnë në mosbesimtarë".

"Si bën të mos besoni, kur juve janë duke ju lexuar (duke ju shpallur) ajetet e All-llahut dhe kur në mesin tuaj gjendet I dërguari i Tij? E kush i përmbahet fesë së All-llahut, ai pa dyshim është i udhëzuar në rrugë të drejtë".

"O ju që besuat, kini frikë All-llahun me një sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni, pos vetëm duke qenë muslimanë (besimtarë)!

Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtoni nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranonit Fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit buzë greminës së xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po, kështu All-llahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur".

"Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillë janë ata të shpëtuarit.E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u patën zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh.Në ditën kur ka fytyra që zbardhohen dhe ka fytyra që nxihen. E për sa u përket atyre që fytyrat u janë nxirë (u thuhet): "A edhe pas besimit tuaj u bëtë pabesimtarë? Vuani pra dënimin, për shkak se ishit që nuk besonit!Ndërsa atyre që fytyrat e tyre u janë zbardhër, ata janë në mëshirën (xhennetin) e All-llahut dhe aty janë përgjithmonë".

(Ali Imran, 100-107)

Kur flet Sujutiu në librin *"Eddurrul-menthur"* për shkakun e zbritjes së përbashkët të këtyre ajeteve, thotë: "Transmeton ibën Is-haku nga ibën Xheriri, nga ibën Mundhiri, nga ibën Ebi Hatimi, nga Ebu Shejhu dhe nga Zejd ibën Eslemi i cili thotë: Shas ibën Kajsi, i cili ishte plakur në xhahilijet, i cili kishte urrejtje të madhe ndaj muslimanëve dhe i cili dallohej si pabesimtar i madh, kur ka kaluar afër një grupi të sahabëve të Pejgamberit a.s. nga fisi Eus dhe Hazrexh, të cilët ishin tubuar së bashku e bisedonin, ka vërejtur dallimin ndërmjet të kaluarës kur ishin armiq dhe ka thënë: "Pasha Zotin, në këtë mënyrë s'mund t'ju bëjmë asgjë", e pastaj ka urdhëruar një djalosh hebre që të shkojë tek ata dhe t'ua rikujtojë ditët e hershme të konfliktit përmes recitimit të poezive, e posaçërisht ditën "Bi'ath" kur u përleshën Eusi e Hazrexhi. Nxitja e tillë ndikoi që dy burra, gjegjësisht Eus ibën Kajdhi nga Eusi dhe Xhebbar ibën Sahër nga Hazrexhi të grinden dhe njëri prej tyre të thotë: "Nëse dëshironi, betohem në Zotin se mund të kthehemi aty ku kemi qenë!"

Në atë rast u hidhëruan të dy grupet dhe thanë: "Të rikthehemi! Armët! Armët! Takohemi në drekë!". Për gjendjen e tillë të acaruar dëgjoi Pejgamberi a.s. dhe së bashku me sahabët muhaxhirë që ishin me të shkoi te ata dhe u tha: "O ju muslimanë, mbështetjuni Zotit! A riktheheni në xhahilijet duke qenë unë në mesin tuaj dhe pasi që ju udhëzoi Zoti në Islam, pasi që ju fisnikëroi me të dhe ju largoi nga xhahilijeti, pasi që ju shpëtoi me të nga mosbesimi dhe ua bashkoi zemrat? A shndërroheni përsëri në jobesimtarë?!"

Kur e kuptuan se ky rast ishte nxitje nga djalli dhe kurth nga armiku i tyre, i shmangën armët anash, qanë dhe u përqafuan. Pastaj shkuan me Pejgamberin a.s., meqë u pengoi veprimi i fshehtë i Shasit i cili ishte armik i Zotit. Në këtë kontekst, Zoti e shpalli ajetin kur'anor për rastin e Shas ibën Kajsit:

"Thuaj: O ithtarë të Librit, përse i mohoni ajetet (argumentet) e All-llahut? E All-llahu mbikëqyr atë që ju veproni. Thuaj: O ithtarë të Librit, përse e pengoni atë që beson nga rruga e All-llahut, duke u angazhuar që ta paraqitni atë të shtrembër, ndërsa vetë ju jeni dëshmues se është e vërtetë! Veprimi juaj nuk mund t'i shmanget mbikëqyrjes së All-llahut".

(Ali Imran, 98-99).

Sa u përket Ejus ibën Kajdhit dhe Xhebbar ibën Sahrit dhe të tjerëve nga fiset e tyre që bënë atë që bënë, Zoti xh.sh. zbriti ajetin:

"O ju që besuat, në qoftë se ju i bindeni një grupi të atyre që u është dhënë Libri, ata, pas besimit tuaj, do t'ju kthejnë në mosbesimtarë".

(Ali Imran, 100).[1]

Ajetet e tilla kur'anore përmbajnë thirrje të qartë për bashkimin e fjalës dhe të radhëve të muslimanëve për hirë të Islamit:

1. Kujdes nga intrigat e jomuslimanëve dhe nga fjalët e tyre nxitëse, ngase, pas besimit vjen vetëm mosbesimi.

2. Besimi është ai që bashkon kurse pabesimi përçan, e kjo vërehet qartë në ajetin: "... pas besimit tuaj, do t'ju kthejnë në mosbesimtarë".

3. Të kapurit për litarin e All-llahut është bazë e unitetit dhe e bashkimit të muslimanëve, e litar i All-llahut është Islami dhe Kur'ani:

[1] *Es-Sujuti, Ed-durrul-menthur*, vëll. 2, f. 278-279.

"Dhe Ai është që i bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur ta shpenzoje gjithë atë që është në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por All-llahu bëri bashkimin e tyre meqë Ai është i gjithëfuqishëm, i urtë".

(Enfalë, 63).

4. Ummetin e bashkon vetëm qëllimi i rëndësishëm dhe mesazhi famëlart, e mesazhi më i lartë i ummetit është thirrja në mirësinë të cilën e ka sjellur Islami. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillë janë ata të shpëtuarit".

(Ali Imran, 104).

5. Historia është regjistrim i këshillave dhe këshilltare e heshtur e njerëzimit. Ajo ka regjistruar se popujt që jetuan para nesh u përçanë në fe dhe u shkatërruan pa patur arsye, ngase u përçanë pasi u erdhi e vërteta dhe argumentet e qarta nga Zoti i tyre. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u patën zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh".

(Ali Imran, 105).

Pra, sipas Kur'anit muslimanët janë një ummet edhe pse kanë shtetësi, ngjyra, shtete, gjuhë e klasa të ndryshme. Ata janë ummeti mesatar të cilët Zoti i ka bërë "dëshmitarë ndaj njerëzve", (Bekare, 143), ndërsa Kur'ani i përshkruan:

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun”.

(Ali Imran, 110).

Kur’ani gjithashtu konfirmon se parimi i vëllazërimit është thelbi i lidhjes së shenjtë ndërmjet muslimanëve dhe argumenti i të vërtetës së besimit:

“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë All-llahun që të jeni të mëshiruar”.

(Huxhuratë, 10).

Pa këtij ajeti erdhën ajetet tjera të cilat theksojnë sjelljet dhe parimet morale të cilat e mbrojnë vëllazërimin nga çdo vepër që mund të ndikojë negativisht në të, si p.sh. nga tallja, përqeshja, thirrja me llagape, paragjykimi, spiunimi, gibeti etj.

“O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke e nënçmuar njëra-tjetrën) dhe mos etiketoni njëri - tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë. O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri - tjetrit, mos përgjoni njëri - tjetrin, a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut e All-llahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin.”

(Huxhuratë, 11-12).

Kur'ani e qorton përçarjen më shumë se çdo gjë tjetër:

"Thuaj: Ai ka fuqi (t'ju shpëtojë, por edhe) t'ju sjellë dënim prej së larti ose prej së poshtmi nën këmbët tuaja, apo t'ju ndajë në grupe e ta luftoni njëri-tjetrin. Shih si i sqarojmë faktet në mënyrë që të kuptojnë"

(En'amë, 65).

Në qoftë se ummeti largohet nga ajo që ua shpalli Zoti njerëzve dhe nga rruga e Tij, atëherë përçarja dhe lufta mes njëri - tjetrit do të jenë dënim për të, ashtu siç e dënoi popullin e Lutit apo ashtu siç e dënoi Karunin:

"Vërtet, ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhammed) nuk ke kurrfarë përgjegjësie. Çështja e tyre është vetëm te All-llahu, Ai do t'i njohë me atë që punuan".

(En'amë, 159).

Sipas Ibën Abbasit, ky ajet ka zbritur për hebrenjtë dhe të krishterët të cilët u grindën dhe u përçanë në fenë e tyre, kurse sipas të tjerëve, ky ajet ka të bëjë me ithtarët e risive, të dyshimit dhe të humbjes.

Ibën Kethiri thotë: "Është e qartë se ky ajet ka kuptim të përgjithshëm për secilin që largohet nga feja e Zotit. Zoti e ka dërguar Pejgamberin e vet për të udhëzuar në fenë e vërtetë e për ta sqaruar fenë. Ka një sheriat që s'pranon kurrfarë mosmarrëveshjesh e përçarjesh, e ata që përçahen janë të humbur".

Zoti e ka pastruar Pejgamberin a.s. nga njerëzit e tillë dhe në këtë kontekst ai thotë:

"Ai u a përcaktoi juve për fe atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka i patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thirrni ata. All-llahu veçon për të (për besim të drejtë) atë që do dhe e udhëzon në të atë që i drejtohet Atij".

(Shura, 13).[2]

Kur'ani i qorton në shumë vende ithtarët e Librit të cilët e përçanë fenë. Këtë çështje do ta zbërthejmë më vonë në këtë libër.

NGA UDHËZIMET E SUNNETIT TË PEJGAMBERIT A.S.

Sunneti pejgamberik e përforcon, zbërthen dhe shtjellon thirrjen e Kur'anit famëlart në bashkim dhe bashkëpunim si dhe largimin nga përçarja e mosmarrëveshja.

Sunneti i Pejgamberit a.s. gjithmonë thërret në bashkim e unitet, vëllazërim e dashuri ndërsa qorton përçarjen, mosmarrëveshjen, armiqësinë dhe urrejtjen.

Lidhur me këtë kemi hadithe të shumta.

Tirmidhiu transmeton nga Ibën Umeri, i cili thotë:

---

[2] *Tefsiri i Ibën Kethirit*, vëll. 2, f. 196, botim i Halebiut

"Umeri na mbajti fjalim në Xhabije dhe na tha: "O ju njerëz, unë e zëvendësoj Pejgamberin a.s. në mesin tuaj, e Ai a.s. thotë: "Ju porosis që t'i pasoni (përcillni) sahabët e mi, pastaj ata që vijnë pas tyre, e pastaj ata që vijnë pas tyre (pas pasardhësve të sahabëve)..! Të jeni të bashkuar (t'i përmbahemi xhematit) dhe të keni kujdes nga përçarja ngase djalli është me njërin kurse më larg prej dy vetave (larg bashkimit). Ai që dëshiron të hyjë në mes të xhennetit, le t'i bashkangjitet bashkësisë (xhematit)".[3]

Ibën Abbasi transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Dora e All-llahut është me xhematin".4

Ndërkaq, Ibën Umeri transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Zoti nuk e bashkon ummetin tim – apo ummetin e Muhammedit - në ndonjë çështje të humbur. Dora e Zotit është me xhematin, e kush largohet do të hyjë në zjarr".[5]

Në dy sahihët thuhet se Pejgamberi a.s. ka thënë:

"Ai që largohet nga xhemati një pëllëmbë dhe vdes, vdes në xhahilijet".[6]

---

[3] Tirmidhiu e transmeton në *"el Fiten"* nën numrin 2166 me thumbim, duke thënë se është transmetuar nga Umeri në formë tjetër. Edhe Hakimi e transmeton sipas kushteve të dy shejhëve *(Buhariut dhe Muslimit)*, kështu mendon edhe Dhehebiu (1/114).

[4] Tirmidhiu e konsideron si *"garib"*. Këtë e transmetojnë edhe Hakimi (1/115) e Ibën Ebi Asimi nga Usame ibën Shurejk, El-Albani e thekson në *Sahihul-Xhami'is-sagir* 8065 duke i përmendur format tjera përforcuese.

[5] Tirmidhiu e konsideron si *"garib"* kurse Hakimi e transmeton në një formë tjetër. Nuk e kanë konsideruar *"sahih"* as Hakimi e as Dhehebiu (1/115).

[6] Transmetim unanim nga Ibën Abbasi.

Sunneti pejgamberik thekson vëllazërimin dhe unitetin e muslimanëve në shumë vende dhe forma të ndryshme, si p.sh.:

"Muslimani është vëlla i muslimanit, Zoti ndihmon atë që ndihmon vëllain e vet".[7]

"Nuk beson ndonjëri prej jush përderisa nuk e dëshiron për vëllain e vet atë që e dëshiron për vete".[8]

"Pasha Atë që e posedon shpirtin tim, nuk do të hyni në xhennet derisa nuk besoni, e nuk do të besoni derisa nuk e duani njëri - tjetrin. A t'ju tregoj diçka që, po qe se e punoni, do ta duani njëri-tjetrin? Përhapni (jepni) selam në mesin tuaj".[9]

"Gjaku i muslimanëve është i bashkuar..."[10]

Hadithet e Pejgamberit a.s. rreptësisht qortojnë urrejtjen, largimin, përçarjen dhe mosmarrëveshjen.

Enes ibën Maliku transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Mos e urreni njëri-tjetrin, mos kini xhelozi ndaj njëri-tjetrit dhe mos vini kurthe ndaj njëri-tjetrit, por bëhuni robër të Zotit dhe vëllezër. Muslimanit nuk i lejohet të largohet nga vëllai i vet (i hidhëruar) më shumë se tri ditë".11

---

[7] Transmetim unanim nga Ibën Umeri.

[8] Transmetim unanim nga Enesi ashtu siç transmetonet në *"El-lu'lu'u vel-merxhan"* (28).

[9] Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre në *"El-Iman"* (93).

[10] Transmetojnë Ebu Davudi dhe Ibën Maxhe nga Ibën Umeri, ndërsa konsiderohet *"hasen"* në *"Sahihul-Xhami'is-sagir"* (6706).

Në transmetimin e Ebu Jusuf El-Ensariut thuhet:

"Nuk i lejohet njeriut të qëndrojë i hidhëruar me vëllain e vet më shumë se tre net, të cilët kur takohen, kthejnë kokën anash. Më i mirë prej tyre është ai që fillon me selam (që përshëndet i pari, përkthyesi).[12]

Nga Ebu Hurejreja transmetohet: "Kini kujdes nga paragjykimi ngase paragjykimi është biseda më e rrejshme; mos përgjoni njëri-tjetrin, mos spiunoni njëri-tjetrin, mos teproni qëllimisht në ankande, mos ndjeni xhelozi ndaj njëri - tjetrit, mos urreni njëri - tjetrin, mos përgatitni kurthe kundër njëri - tjetrit por bëhuni robër të Zotit, vëllezër".[13]

Gjithashtu transmetohet nga Ebu Hurejre: "Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk e dëmton, nuk e tradhton dhe nuk e urren. Devotshmëria është mu këtu (tregon në gjoksin e vet tre herë). I ndalohet muslimanit ta urrejë muslimanin. Gjaku, pasuria dhe nderi i muslimanit janë të ndaluara për muslimanin".14

Ebu Hurejre po ashtu transmeton: "Hapen dyert e xhennetit ditën e hënë dhe ditën e enjte dhe falet çdo rob që s'i ka bërë shirk asgjë Zotit, përveç njeriut që ka patur armiqësi mes tij dhe vëllait

---

[11] Transmeton Buhariu në *"El-Edeb"* dhe Muslimi në *"El-Birru"*. Shiko *"El-lu'lu'u vel-merxhan"* (1658).
[12] Buhariu transmeton në *"El-Edeb"* kurse Muslimi në *"El-Birru", "El-lu'lu'n vel-merxhan",* (1659).
[13] *Po aty*, hadithi 1660.
[14] Transmetim i Muslimit në *El-Birr* (2564) dhe ky është një ndër dyzet hadithet e Neveviut.

të tij, dhe thuhet: "Vononi këta të dy derisa të pajtohen, vononi këta të dy derisa të pajtohen, vononi këta të dy derisa të pajtohen!"15

Nga Ebu Derdaja transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë: "A t'ju informoj për diçka më të vlefshme se namazi, agjërimi e sadakaja?". Ata iu përgjigjën: "Po, o I dërguari i Zotit!" Pastaj tha: "Pajtohuni ngase përçarja shkatërron fenë".[16]

Gjithashtu transmetohet nga Ebu Hurejre: "Kini kujdes nga përçarja sepse ajo vërtetë është shkatërruesja".17

Nga Zubejri transmetohet: "Popujt para jush u shkatërruan nga zilia e urrejtja. Urrejtja është shkatërruesja. Pasha Atë që posedon shpirtin tim, nuk do të hyni në xhennet derisa nuk besoni, e nuk besoni derisa ta duani njëri - tjetrin".18

Nga Ibën Abbasi transmetohet: "Tre personave namazi i tyre nuk u ngritet mbi kokat e tyre as sa një pëllëmbë: personit që udhëheq një popull e ata e urrejnë atë, gruas që fle edhe pse e ka hidhëruar burrin dhe dy vëllezërve që janë të hidhëruar me njëri - tjetrin".19

Nga Ebu Harrash El-Eslemi transmetohet: "Ai që largohet (hidhërohet) nga vëllai i vet një vit, është njëlloj sikur ta ketë vrarë ate".[20]

---

15 *Po aty,* (2565).
16 Transmeton Tirmidhiu në *"Sifetul-Kijameti"* (2511), kurse Ebu Davudi në *"El-Edeb"* (4919).
17 E transmeton Tirmidhiu dhe thotë: *"Sahih* dhe *garib"* (2510).
18 Transmeton Tirmidhiu (2512) kurse disa transmetues nuk e kanë përmendur transmetimin nga Zubejri.
19 Ibën Maxhe (971).

Nga Xhabir ibën Abdullahu transmetohet: "Shejtani është demoralizuar nga shpresa që ai të adhurohet nga falësit e namazit në siujdhesën Arabe, porse atë e mban futja e përçarjes ndërmjet tyre."[21]

ISLAMI URREN PËRÇARJEN

Se Islami urren përçarjen dhe mosmarrëveshjen tregon vetë fakti se Pejgamberi a.s. ka kërkuar që të largohen dhe shpërndahen madje nga leximi i Kur'anit nëse ekziston frika që pas këtij leximi të ndodhë përçarja dhe mosmarrëveshja.

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Xhundub ibën Abdullah se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Lexonie Kur'anin përderisa zemrat tuaja janë të bashkuara në te, e nëse përçaheni, ngritni dhe shpërndahuni nga leximi i tij".[22] Qëllimi i tij ka qenë që të mos shkaktohet përçarja në mesin e muslimanëve.

Edhe pse çdo musliman e di vlerën e leximit të Kur'anit, dhe se lexuesi i tij do t'i ketë dhjetë sevape në çdo shkronjë, nuk preferohet leximi në qoftë se shkakton përçarje e grindje midis njëritjetrit, qoftë mosmarrëveshja në mënyrën e leximit siç ndodhi ndërmjet Umerit e Hishamit apo

---

[20] Ebu Davudi në *"El-Edeb",* (4515).
[21] Muslimi e transmeton në *"Sifatul-munafikin* (2812).
[22] Transmetim unanim (1706).

ndërmjet Ibën Mes'udit e disa sahabëve. Për mosmarrëveshjet e tilla, Ai (a.s.) u ka thënë: "Të dy keni të drejtë!" Zgjidhja e njëjtë vlen edhe për mosmarrëveshjet rreth të kuptuarit të tekstit. Lexoni dhe aplikoni atë që ju bashkon e largohuni nga ajo që ju përçanë. Largohuni nga gjërat e dyshimta që ju shpiejnë në përçarje dhe mbështetuni vetëm në leximin e qartë që i bashkon zemrat tuaja.

Në një hadith tjetër thuhet: "Kur t'i takoni ata të cilët mbështeten në ajetet që mund të kenë më shumë kuptime dhe insistojnë në to, largohuni prej tyre (kini kujdes)".[23]

Kur i komenton Hafidh ibën Haxheri këto hadithe, thotë se insistojnë në bashkim e unitet dhe tërheqin vërejtjen nga mosmarrëveshja e përçarja.[24]

Pse përqëndrohet Islami aq shumë në çështjen e bashkimit dhe unitetit dhe pse qorton mosmarrëveshjen e përçarjen?

Në të vërtetë, bashkimi është faktor pozitiv dhe dobiprurës në jetën e ummetit.

1. Bashkimi i forcon të dobëtit kurse të fortit i bën edhe më të fortë. Një tullë kur është e vetme është e dobët sa do që të jetë ajo e fortë, edhe mijëra tulla të shpërndara dhe të hedhura janët të dobëta dhe po të jenë miliona po ashtu, mirëpo kur janë ato në mur janë forcë që nuk rrëzohet lehtë sepse ato me bashkimin e tyre me të tjera dhe të renditura vërtetë janë frcë jo e lehtë. Lidhur

[23] Transmetim unanim (1705).
[24] *Fet-hul-bari,* vëllimi 9/102,103; botim i Darul-Fikr-it.

me këtë, një hadith i Pejgamberit thotë: "Besimtari për besimtarin është sikur ndërtesa (nga tullat) që shtrëngojnë njëra – tjetrën" (dhe i ka shtrënguar shuplakat e duarve).[25]

Këtë e thekson edhe i Madhëruari në Kur'anin famëlart:

"All-llahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të rreshtuar si të jenë ndërtesë e fortifikuar".
(Es-saff, 4).

Me këtë ka të bëjë edhe tregimi i njohur i babait me fëmijët e tij, prej të cilëve ka kërkuar një herë të thyejnë nga një thupër e të cilën e bënë, e pastaj u ofroi një tubë sosh e ata nuk arritën t'i thejnë dot ato.

2. Bashkimi gjithashtu mbron nga shkatërrimi. Individi mund të humbë e të dështojë ndërsa në bashkësi është i mbrojtur. Kjo i ngjason deles që është e mbrojtur nga ujku në qoftë se është brenda tufës e në qoftë se del jashtë saj, atëherë ujku e mbytë fare lehtë.

Në këtë kontekst, hadidhet e Pejgamberit a.s. thonë:

"Obligoheni në bashkësi (të jetoni të bashkuar në Xhennet) ngase dora e Zotit është me xhematin, e ai që largohet, hyn në zjarr".

"Djalli është ujk i njeriut, e ujku e ha vetëm delen që është e vetmuar".

"Obligoheni në bashkësi (xhemat) ngase djalli është më afër një individi e më larg dy individëve (bashkësisë)".

[25] Transmetim unanim nga Ebu Musa El-Esh'ariu.

Argument më i fortë për rëndësinë e madhe të ruajtjes së njëshmërisë së xhematit është ai që e kam theksuar në librin tim "Bej-jinatul-hal-lil-islamij", e që ka të bëjë me rrëfimin e ngjarjes së Musait a.s. të cilën e regjistron Kur'ani, i cili kishte shkuar për t'iu lutur Zotit dhe kishte qëndruar dyzet netë, e si zëvendës të vetin në popull e kishte lënë vëllaun dhe ndihmësin e tij në shpallje Harunin a.s. Gjatë mungesës së tij, populli kishte filluar ta adhurojë viçin të cilin e kishte përgatitur Samiriu. Kur u kthye Musa, u habit nga devijimi katastrofal që kishte të bëjë me thelbin e besimit për të cilin ishte dërguar Musa a.s. dhe pejgamberët tjerë para e pas tij.

Në atë rast është hidhëruar Musa a.s. i hedhi fletushkat anash dhe e ka kapur vëllain e vet për mjekre e për flokësh dhe i ka thënë:

- Ai (Musai u kthye) tha:

"O Harun, ç'të pengoi ty kur i pa se morën rrugën e gabuar, e ti të mos e vazhdosh rrugën time? A mos e kundërshtove edhe t'i porosinë time?"

(Taha, 92, 93).

Në Kur'an ceket se vëllai i tij Haruni i është përgjigjur:

"Ai (Haruni) tha: "O bir i nënës sime, mos më kap as për mjekre as për flokë, se unë u frikësova se do të thuash: I përçave Beni israilët dhe nuk e ke respektuar porosinë time?"

(Taha, 94).

Në këtë përgjigje vërejmë se I dërguari i Zotit Haruni i ka kërkuar falje vëllait të vet me këto fjalë: "Unë u frikësova se do të thuash: I përçave Beni israilët dhe nuk e ke respektuar porosinë time".

Kjo do të thotë se ai ka heshtur para shirkut të madh dhe adhurimit të viçit me të cilin i nxiste Samiriu, për ta mbrojtur unitetin e popullit, ngase është frikësuar se mos po i përçanë gjatë mungesës së Musait, e pastaj të dy vëllezërit e kanë hartuar planin e përbashkët për ta kapërcyer krizën e tillë.

PJESA E DYTË
PËRÇARJA E UMMETIT NUK ËSHTË PËRCAKTIM HYJNOR E AS I PËRHERSHËM

Disa njerëz deklarojnë se përçarja e ummetit është përcaktim hyjnor prej të cilit s'ka ikje, edhe atë duke u mbështetur në hadithet e Pejgamberit që konfirmojnë se mjerimi i këtij ummeti vjen nga vetë mesi i tij dhe se ummeti do të ndahet në shtatëdhjetë e tri sekte, prej të cilave vetëm njëra do të shpëtojë kurse të tjerat do të hyjnë në zjarr.

1. Sa u përket haditheve që kanë të bëjnë me mjerimin nga vetë mesi i ummetit, ato konsiderohen të vërteta ngase transmetohen nga një numër i sahabëve, si p.sh. nga Sa'd ibën Ebi Vekkasi, Theubani, Xhabir ibën Atiku, Enes ibën Maliku, Hudhejfeja, Mu'adh ibën Xhebeli, Habbab ibën Ereti, Sheddad ibën Eusi, Halid Huzai, Ali ibën Ebi Talibi, Ibën Abbasi dhe Ebu Hurejre.

Hadithet e tilla i ka cekur Hafidh Ibën Kethiri në tefsirin (komentimin)e ajetit kur'anor:

"Thuaj: "Ai ka fuqi (t'ju shpëtojë, por edhe) t'ju sjellë dënim prej së larti ose prej së poshtmi nën këmbët tuaja, apo t'ju ndajë në grupe e ta luftoni njëri - tjetrin. Shih se si i sqarojmë faktet në mënyrë që të kuptojnë".

(En'namë, 65).

Nga këto hadithe do t'i cekim vetëm tri:

1. Ahmedi dhe Muslimi transmetojnë nga Sa'di se Pejgamberi a.s. kur ka zbritur një ditë nga kodrina, ka kaluar pranë xhamisë së Beni Mu'avijes, ka hyrë brenda, i ka falur dy rekate, e edhe ne u falëm bashkë me të, bëri një dua të gjatë pastaj u kthye nga ne dhe tha: "Iu luta Zotit tim për tri gjëra, dy m'i dha e një jo. E luta Zotin tim që të mos shkatërrohet ummeti im me Sunnetin, e Ai pranoi, pastaj e luta që të mos e shkatërrojë ummetin tim me fundosje, e Ai pranoi, e kur e luta që të mos e sjellë mjerimin nga mesi i tyre, nuk pranoi (lutjen time)".26

2. Imam Ahmedi dhe të tjerët transmetojnë nga Habbab ibën Ereti: "E shoqërova Pejgamberin a.s. gjatë një nate në të cilën fali namaz pa ndërpre deri në agim, dhe kur dha selam Pejgamberi i Zotit i thashë: "O I dërguari i Zotit! Je falur sonte ashtu si s'të kam parë asnjëherë më parë!" Pejgamberi a.s. ma ktheu: "Po, ishte namaz i kërkesës dhe i frikës. Iu luta Zotit tim të Madhëruar për tri gjëra prej të cilave dy m'i dha e një jo. E luta Zotin tim të Madh e të Madhëruar që të mos

[26] Muslimi në *"El-Fiten",* hadithi 2890.

na shkatërrojë me atë që i shkatërroi popujt para nesh dhe pranoi, pastaj iu luta që të mos na shkatërrojnë të tjerët, në çka pranoi, e kur e luta që të mos na bëjë fraksione, refuzoi".[27]

3. Muslimi transmeton nga Theubani se Pejgamberi a.s. ka thënë: "All-llahu ma paraqiti tokën dhe i pashë lindjen dhe perëndimin e saj..."[28]

Hadithet të cilat i cekëm dhe ato që nuk i cekëm e që flasin rreth kësaj çështjeje janë shumë të qarta, gjegjësisht argumentojnë se All-llahu e ka siguruar dhe i është përgjigjur Pejgamberit a.s., nga rrespekti ndaj tij, në dy kërkesa të tij në lidhje me ummetin e tij:

I. Të mos e shkatërrojë ummetin me atë që i ka shkatërruar popujt e mëparshëm, si p.sh. shkatërrimi i popullit të Nuhit dhe i Faraonit me ushtarët e tij me fundosje, ose shkatërrimi me uri etj.

II. Të mos shkatërrohen nga të tjerët.

Pejgamberi a.s. e ka lutur Zotin edhe për një gjë tjetër por Ai ka refuzuar. Kjo lutje kishte të bëjë me mospërçarjen e ummetit në sekte e fraksione e të mos shkatërrohen vetvetiu, mirëpo All-llahu i Madhëruar nuk iu përgjigj pozitivisht Pejgamberit a.s. por e la këtë qështje brenda ligjeve kozmike, shoqërore dhe të kauzalitetit. Nga kjo nënkuptohet se ummeti është i lirë në veprat e veta dhe se Zoti nuk e detyron në asgjë. Nëse i përgjigjen pozitivisht thirrjes së Kur'anit dhe unitetit të fjalës e të radhëve, do të lartësohen, do të ngdhnejnë mbi armikun e Zotit dhe të vetin

---

[27] E transmeton Ibën Kethiri në tefsirin e ajetit 65 të sures *"En-amë"*, (2/141) nga Musai, Ibën Hibbani dhe Tirmidhiu.

[28] Muslimi në *"El-fiten"*, hadithi, 2889.

si dhe do ta realizojnë atë që e kërkon Islami, e nëse i përgjigjen ftesës së shejtanit (djallit) dhe pasionit, do të përçahen, do të gjenden nën kthetrat e armiqve të tyre dhe "nga përçarja e copëtimi i radhëve do të shkatërrohen në mes vete".

Hadithi nuk nënkupton fare se përçarja e ummetit dhe armiqësia e brendshme ndaj njëri-tjetrit mund të konsiderohen të përhershme e të përgjithshme për çdo kohë e çdo vend deri në Ditën e Gjykimit, sepse në të kundërtën, nuk do të kishte kurrfarë kuptimi fjala e Zotit të Madhëruar: "Dhe kapuni ju të gjithë për litarin e Zotit dhe mos u përçani". (Ali Imran, 10), e as: "E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u kishin zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh" (Ali Imran, 105), as: "E mos u përçani mes vete e të dobësoheni, e ta humbni fuqinë (luftarake)", (Enfalë, 46), as: "All-llahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij të rreshtuar si të jenë ndërtesë e fortifikuar", (Saff, 4), as: "(Përqëndrohuni në atë fe) të kthyer sinqerisht tek Ai, kini frikë prej Atij dhe falni namazin e mos u bëni nga idhujtarët, të cilët e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ku secili grup i gëzohet idesë së vet". (Er-Rum, 31-32) e as: "Kjo feja juaj është e vetmja fe e Unë jam Zoti juaj, ruajuni dënimit Tim". (Mu'minunë, 52).

Deklarata e tillë nuk përputhet as me hadithet e Pejgamberit a.s.: "Mos u përçani ngase ata që ishin para jush u përçanë dhe u shkatërruan".

"Besimtari me besimtarin është sikur ndërtesa (tjegullat) që shtrëngojnë njëra-tjetrën".

"I sheh besimtarët në dashurinë, mëshirën dhe respektin e ndërsjellë sikur një trup ku në qoftë se një gjymtyrë ankohet, i tërë trupi ndjen temperaturë dhe shqetësim".

"Mos ndjeni zili ndaj njëri - tjetrit, mos përgatitni kurthe ndaj njëri - tjetrit dhe mos urreni njëri-tjetrin por bëhuni robër të Zotit, vëllezër".

Gjithashtu ekzistojnë edhe shumë ajete kur'anore e hadithe të Pejgamberit që udhëzojnë bashkimin e unitetin, që ndalojnë përçarjen e mosmarrëveshjen, që obligojnë një udhëheqës për të gjithë muslimanët, që të mos zgjedhen dy halifë në një kohë të njëjtë dhe që të luftohet secili që dëshiron të shkaktojë përçarje në mesin e muslimanëve etj.

Sikur të ishte përçarja çështje e përcaktuar nga kaderi hyjnor dhe të ishte e përgjithshme dhe e përhershme, atëherë të gjitha këto urdhëra e ndalesa do të ishin të pakuptimta ngase urdhërojnë diçka që s'mund të ndodhë dhe ndalojnë diçka që s'mund të evitohet.

Sa u përket haditheve që kanë të bëjnë me ate se All-llahu nuk e lejon shkatërrimin e këtij ummeti nga jashtë, këto nuk lajmërojnë se një gjë e tillë mund të ndodhë në çdo territor të Islamit në botë dhe në çdo kohë, por konsiderohen si fatkeqësi e sprovë për ummetin sa herë që nuk e mbron vetveten. Një gjë e tillë i ngjason njeriut i cili sëmuret sa herë që nuk e mbron vetveten ose nuk e merr ilaçin përkatës. Sprovat e tilla mund të ndodhin në ndonjë vend të posaçëm, në ndonjë kohë të posaçme apo në ndonjë popull të posaçëm dhe mendoj se kjo mjafton sa për ta vërtetuar lajmërimin pejgamberik.

Ajo që kanë tërhjekur vërejtjen hadithet që kanë të bëjnë me shkatërrimin vetvetiu, mund të mendohet me atë që ka ndodhur në kohët e kaluara, si p.sh. në kohën e sahabëve, në periudhën umevite e abaside, të cilat i hapën rrugën kryqëzatave nga Perëndimi e tatarëve nga Lindja të depërtojnë në Botën Islame dhe të pushtojnë disa territore të saj për një kohë të caktuar.

Hadithet tjera përgëzojnë me paralajmërime se Islami do të triumfojë, se përsëri do të depërtojë në Evropë edhe pse është dëbuar dy herë, se do të çlirohet Roma ashtu siç është çliruar më parë Konstantinopoja dhe se në çdo pjesë të tokës do të depërtojë kjo fe e Zotit.

Është e qartë se asgjë nga kjo nuk mund të realizohet përderisa ummeti është i përçarë dhe përderisa muslimanët sulmojnë njëri - tjetrin. Një gjë e tillë do të ndodhë atëherë kur të bashkohet fjala në Islam e të qëndrojë ummeti nën flamurin e Imanit (besimit).

HADITHI I PËRÇARJES SË UMMETIT NË 73 FRAKSIONE

Sa i përket hadithit për përçarjen e ummetit në 73 fraksione dhe se vetëm njëri prej tyre do të shpëtojë kurse të tjerët do të hyjnë në zjarr, ekzistojnë versione të ndryshme lidhur me autenticitetin e tij.

A. Së pari duhet të dihet se ky hadith nuk ceket në ndonjërin prej dy sahihëve. Edhe pse ka domethënie të rëndësishme, shihet se nuk u është përshtatur kushteve që parashihen në këto dy sahihe.

Është e vërtetë thënia se këto dy sahihe nuk i kanë përmbledhur të gjitha hadithet "sahih", mirëpo gjithashtu dihet se ata dy (Buhariu dhe Muslimi) kanë qenë të kujdesshëm që mos të lënë kapitull të rëndësishëm shkencor pa e evidentuar qoftë edhe me vetëm një hadith.

B. Disa transmetime nuk kanë theksuar se të gjitha fraksionet do të hyjnë në zjarr përveç njërit por vetëm ndarjen dhe numrin e fraksioneve. Këtë hadith e kanë transmetuar nga Ebu Hurejre, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibën Maxhe, Ibën Hibbani dhe El-Hakimi.

Në këtë transmetim thuhet: "Çifutët janë ndarë në 71 - ose 72 - fraksione, të krishterët janë ndarë në 71 - ose 72 - fraksione kurse ummeti im do të ndahet në 73 fraksione."[29]

Edhe pse sipas Tirmidhiut ky hadith është "hasen sahih" e sipas Ibën Hibbanit e Hakimit "sahih", qarkullon te Muhammed ibën Amr ibën Alkame ibën Vekkas El-Lejthij, e ai që e lexon jetëshkrimin e tij në "Tehdhibut - tehdhib", do të vërejë se ai është i kritikuar në Hifdh (mbamendje), madje të gjithë e kanë kritikuar saqë Hafidhi në "Et-takrib" thotë: "I sinqertë por me iluzione". Vetëm termi "i sinqertë" pa i'u bashkangjitë edhe termi i përpiktë këtu nuk mjafton në disiplinën e Hadithit e ku më të pranohet edhe me termin "iluzione"?!

Dihet se Tirmidhiu, Ibën Hibbani dhe Hakimi janë më tolerantë në çështjen e "sahihit", madje Hakeimi përshkruhet si tepër tolerant në kushtin e "tas-hihit".

Ai këtu e bën "sahih" hadithin në bazë të kushtit të Muslimit ngase Muslimi argumenton me Muhamed ibën Amrin, kurse Dhehebiu e refuzon këtë dhe thotë se Muslimi nuk e ka pranuar të vetëm transmetimin e tij por duke e ka përforcuar me të tjerë.[30]

---

[29] Ebu Davudi në *"Sunen"* (4596), Tirmidhiu në *"Iman"* (2642) dhe thotë se është *"hasen sahih",* Ibën Maxhe të rezymuar në *"El-Fiten"* (3991), Ibën Hibbani në *"El-Mevarid"* (1843) dhe Hakimi (1/6) i cili e konsideron sahih sipas kushtit të Muslimit por kërë e refuzon Dhehebiu.

Pastaj në transmetimin e Ebu Hurejres nuk ekziston shtojca "të gjitha fraksionet do të hyjnë në zjarr përveç njërit", e rreth kësaj zhvillohet e tërë problematika.

Ky hadithë është transmetuar me këtë shtojcë edhe nga ana e disa sahabëve, si p.sh. nga Abdullah ibën Amri, Muavija, Auf ibën Maliku dhe Enesi por me *"sened"* të dobët por e kanë forcuar duke i bashkuar transmetimet njëra me tjetrën. Përforcimi i hadithit përmes transmetimeve tjera nuk është kategorik ngase ka shumë hadithe të tilla të cilat konsiderohen të dobëta, siç vërehet kjo në Kutubu Tahrixh dhe në Kutubu ilel..! Hadithet e tilla pranohen në qoftë se nuk kundërshtohen dhe në qoftë se nuk ka ndonjë problem në domethënien e tyre. Problemi në këtë (hadith) qëndron në ndarjen e ummetit në më shumë fraksione se ndarja e çifutëve dhe të krishterëve në një anë dhe në atë se të gjitha fraksionet do të hyjnë në zjarr përpos njërit, gjë që i nxit fraksionet të mendojnë se çdonjëri për vete është ai i shpëtuari dhe se fraksionet tjera janë në devijim. Pikërisht arsyetimet e tilla relative e përçajnë ummetin dhe kritikojnë njëri-tjetrin, gjë që e dobëson unitetin dhe e forcon e armikun dhe e nxit atë kundër ummetit. Për këtë shkak dijetari i madh Ibën Veziri në *"El-Avasim"* e ka denoncuar këtë hadith në përgjithësi e këtë shtojcën në veçanti duke u përqëndruar në kujdesin ndaj akuzimit të të tjerëve: "Ki kujdes nga mashtrimi me "Të gjitha fraksionet devijojnë përveç njërit", ngase kjo është shtojcë që s'ka bazë të shëndoshë dhe s'është larg trillimeve të pabesimtarëve".

---

[30] Hakimi 1/6, në një vend tjetër në 1/128 të cilin e pranon Dhehebiu. Edhe Buhariu e ka pranuar Muhamed ibën Amrin por të përforcuar me të tjerë.

Ai gjithashtu thotë: "Nga Ibën Hazmi: "Ai është i trilluar "mevduu", nuk është "meukuf" e as "merfu'ë", dhe se çdo gjë (transmetim) që i kritikon kaderitët, murxhiët dhe esh'aritët është hadith i dobët dhe jo i fortë".[31]

Qoftë në të kaluarën ose në të tashmen, ekziston një numër i dijetarëve të cilët e kanë kritikuar këtë hadith në *"sened"* e disa në *"metën"* apo në *"kuptim"*.[32]

Ebu Muhammed Ibën Hazmi i kritikon ata që i akuzojnë të tjerët për kufër për shkak të qëndrimeve. Në sferën e akuzimeve për kufër përdoren dy hadithe të Pejgamberit a.s. dhe

---

[31] El-Avasim vel-kavasim 1/186.

[32] *"Metni"* i këtij hadithi është problematik ngase, edhe pse Zoti e konsideron ummetin islam si dëshmitar mbi njerëzit dhe se është ummeti më i mirë nga mbarë njerëzimi, sipas këtij hadithi, ky ummet konsiderohet më i keq se hebrenjtë dhe të krishterët nga aspekti i përçarjes dhe i copëtimit ngase numri i fraksioneve është më i madh se i çifutëve apo i krishterëve. Kur flitet në Kur'an për çifutët, thuhet: "Ne ndërmjet tyre hodhëm armiqësi e urrejtje që do të vazhdojnë deri në Ditën e Kijametit, (Maide, 64), ndërsa për të krishterët thuhet: "Ne e morëm zotimin edhe të atyre që thanë: "Ne jemi nesara", e edhe ata e harruan një pjesë të asaj me të cilën ishin udhëzuar, andaj ne kemi ndërsyer armiqësinë e urrejtjen ndërmjet tyre deri në Ditën e Kijametit. E më vonë All-llahu do t'i njoftojë ata me atë që bënë", (Maide, 14). Në Kur'an nuk përmendet një përçarje e tillë në lidhje me ummetin islam.. Por rreziku nga përçarja ashtu siç u përçanë popujt e mëparshëm. Ky hadith i gjykon gjitha fraksionet – me përjashtim të njërit – se do të jenë nga banorët e zjarrit e në anën tjetër kemi transmetimet (e vërteta) që flasin për vlerat e këtij ummeti si ummet i mëshiruar dhe se ai përbën një të tretën apo gjysmën e xhenetlinjëve Pastaj, nuk dihet se numri i fraksioneve të çifutëve dhe të krishterëve ka qenë aq i madh, posaçërisht tek çifutët.

përmend nga këto çështje në të cilat argumentojnë ata për kufrin e tyre se ata i cekin dy hadithe të cilat i llogarisin se janë nga Pejgamberi a.s., e ato janë:

1. Kaderitët dhe murxhitët janë zjarrputistët e këtij ummeti."

2. "Ky ummet do të përçahet në shtatëdhjetë e ca fraksione, të gjitha do të jenë në zjarr me përjashtim të njërës, ajo do të jetë në xhennet".

Ebu Muhammedi thotë: "Në thelb, këto dy hadithe nuk kanë "isnad" autentik, një gjë e tillë nuk pranohet nga ata që e pranojnë transmetimin nga një person, e si të pranohet nga ata që refuzojnë transmetimin e tillë?!"[33]

Muhammed Ibën Ibrahim El-Veziri (840), imam jemenas e muxhtehid mbrojtës i Sunnetit dhe harmonizues midis racionalizmit e tradicionalizmit, në veprën e tij "El-Avasim we El-Kavasim", kur flet për hadithet e transmetuara nga Mu'avija r.a., e hadithi i tetë ishte ai i përçarjes së ummetit në shtatëdhjetë e ca fraksione, thotë: "Në senedin e tij është Nasibiu, prej të cilit nuk pranohet (ky transmetim)". Një gjë të tillë e ka transmetuar edhe Tirmidhiu nga Abdullah ibën Amri ibën Asi por ka thënë "hadith garib". Këtë e ka cekur në "El-iman" nga afrikani i quajtur Abdurrahman ibën Zijad e ky nga Abdullah ibën Jezid, e ky nga Abdullah ibën Amri.

Një gjë të tillë po ashtu e hasim edhe në transmetimin e Ibën Maxhes nga Auf ibën Maliki dhe Enesi.

---

[33] Ibën Hazmi *"El-Fasl fil-mileli ven-nihal"*, 3/292, botim i Shtëpisë botuese *"Ukadh"* në Xhidde. Shejh Albani thotë se e ka kërkuar thënien e tillë të Ibën Hazmit në *"El-Fasl"* por nuk e ka gjetur, (*Es-sahihatu,* Nr. 204).

Ai thotë: (Nuk ka gjë nga kushti i "sahihit" dhe për këtë shkak nuk e kanë theksuar të dy shejhët (Buhariu dhe Muslimi). Tirmidhiu e ka bërë "sahih" hadithin e Ebu Hurejres nga transmetimi i Muhamed ibën Amr ibën Alkames por s'ka në të: "Të gjitha do të hyjnë në zjarr përveç njërës". Ibën Hazmi thotë: "Kjo shtojcë është e trilluar dhe këtë gjë e ka theksuar autori i "El-Bedrul-munir".[34]

Në komentimin e ajetit kur'anor: "Ai ka fuqi (t'ju shpëtojë por edhe) t'ju sjellë dënim prej së larti ose prej së poshtmi nën këmbët tuaja apo t'ju ndajë në grupe e ta luftoni njëri - tjetrin", (En'namë, 65), Hafidh Ibën Kethiri thotë: "Është transmetuar në forma (të ndryshme) se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Ky ummet do të ndahet në 73 fraksione dhe të gjitha do të hyjnë në zjarr përveç njërit".[35] Ai këtu nuk ka shtuar diç tjetër, nuk e ka përshkruar as si "sahih" e as si "hasen", edhe pse ka bërë komentim të gjerë me shumë hadithe përkatëse.

Edhe pse disa dijetarë e konsiderojnë hadith *"hasen"* si Hafidh ibën Haxheri, e disa të tjerë *"sahih"* në bazë të përforcimeve tjera, si shejhul-islami Ibën Tejmijje, kjo nuk do të thotë se përçarja e tillë do të vazhdojë deri në Ditën e Gjykimit por, për ta vërtetuar autenticitetin e hadithit, mund të ndodhë në një kohë të caktuar.

Formohen fraksione të tilla por ndërkohë ngadhnjen e vërteta mbi të pavërtetën dhe kështu zhduken përgjithmonë. Në të vërtetë, shumë fraksione të devijuara janë formuar por disa prej tyre janë zhdukur njëherë e përgjithmonë.

---

[34] *El-Avasim vel-Kavasim* i Ibën Vezirit, në verifikim të Shejh Shu'ajb Arnautit, 3/170-172.
[35] *Tefsiri i Ibën Kethirit,* 2/143, botim i Isa Halebiut.

Pas kësaj, hadithi thekson se të gjitha këto fraksione janë pjesë e ummetit të Pejgamberit a.s., gjë që vërehet qartë nga pjesa e hadithit: "...do të përçahet ummeti im...", e që nënkupton se edhe pse konsiderohen risi, ato nuk kanë dalur nga feja dhe nuk janë ndarë nga trupi i ummetit islam.

Nocioni "në zjarr" nuk nënkupton dënimin e tyre të përhershëm si të pabesimtarëve por do të hyjnë si mëkatarët monoteistë, për të cilët ndodhë të bëjnë "shefatë" pejgamberët, engjëjt apo ndokush prej besimtarëve, ose vet ata mund të kenë vepra të mira (bamirësi), sprova dhe fatkeqësi që u kanë ndodhur e që janë nga fshirëset e mëkateve e t'i mbrojnë ata nga dënimi ose do të mëshirohen nga rahmeti i Zotit, posaçërisht nëse kanë bërë përpjekje që ta njohin të vërtetën por pa arritur te kjo kanë gabuar rrugën. Dihet mirëfilli se All-llahu i Madhëruar e ka ngritë nga ummeti (nuk llogaritë) gabimin, harresën dhe që veprojnë nën presion.

KAPITULLI I DYTË
BAZAT TEORIKE E PRAKTIKE TË FIKHUT TË MENDIMEVE TË NDRYSHME

PJESA E PARË
DALLUESHMËRIA NË ÇËSHTJET E DORËS SË DYTË TRAJTOHET SI DOMOSDOSHMËRI, MËSHIRË E GJERËSI
1. DALLUESHMËRIA DHE DOMOSDOSHMËRIA

Ata të cilët dëshirojnë t'i bashkojnë njerëzit në një mendim për çështjet e ibadeteve, të marrëdhënieve të përditshme dhe të çështjeve tjera dytësore në fe, duhet të dijnë se kërkojnë një gjë absurde që nuk mund të ndodhë dhe se një tendencë e tillë do ta zgjerojë edhe më shumë rrethin e mosmarrëveshjes. Një ide e tillë është naive ngase mendimet e ndryshme në kuptimin e dispozitave fetare jothelbësore konsiderohen domosdoshmëri. Këtë domosdoshmëri e obligon natyra e fesë, e gjuhës, e njerëzve, e gjithësisë dhe e jetës.

NATYRA E FESË

Sa i përket natyrës së fesë, All-llahu i Madhëruar ka dëshiruar që në Kur'anin famëlart të ketë tekste të qarta e të paqarta, në të cilat do të përdoren ixhtihadi dhe induksioni. Aty ku nuk ka vend për ixhtihad apo për induksion, atëherë vjen në shprehje besimi në të padukshmen e në të vërtetën, me qëllim që të sprovohet njeriu nga ana e Krijuesit të tij:

"Ne e krijuam njeriun prej një uji të bashkëdyzuar për ta sprovuar atë..."

(Insan, 2).

Sikur të kishte dashur All-llahu i Madhëruar, do ta kishte bërë fenë në atë formë që të mos ketë nevojë për ixhtihad, por nuk e ka bërë një gjë të këtillë me qëllim që ta harmonizojë natyrën e fesë me natyrën e gjuhës dhe atë të njerëzve.

Po sikur të dëshironte Zoti i Madhëruar që muslimanët të kenë një mendim të përbashkët për çdo çështje, pa ide e mendime të ndryshme mbi çështjet dytësore ose mbi ato thelbësore jo aq të rëndësishme, atëherë do ta shpallte Kur'anin të tërin me ajete të qarta dhe kategorike, në të cilat nuk do të ketë komentime dhe kuptime të ndryshme. Dëshira e Tij ishte që në Kur'an të ketë ajete të qarta e të paqarta (të qartat janë më të shumta në numër se të paqartat), me qëllim të sprovës në një anë dhe përdorimit të mendjes për ixhtihad në anën tjetër. Në këtë kontekst Zoti i Madhëruar thotë:

"Ai është që ta zbriti librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjera që nuk janë krejtësisht të qarta (muteshabih). E ata që në zemrat e tyre anojnë nga e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është tërësisht e qartë për të shkaktuar huti e kinse kërkojnë komentin e

tyre. Po, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: "Ne u kemi besuar atyre që janë të paqarta, të gjitha janë nga Zoti ynë! Por, këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes".

(Ali Imran, 7).

Përpos aspektit të të kuptuarit dhe komenteve, vërejmë se edhe leximet janë të ndryshme, të cilat arrijnë deri në shtatë, madje edhe në dhjetë e të cilat i ka pranuar ummeti. Asnjë dijetar nuk ka parë ndonjë gjë të keqe në to ngase të gjitha rrjedhin nga Pejgamberi a.s.

Buhariu transmeton se Ibën Mes'udi ka thënë: "Dëgjova një njeri duke e lexuar një ajet kur'anor ndryshe nga leximi të cilin e kisha dëgjuar prej Pejgamberit a.s., dhe kur e lajmërova Atë (a.s.) për këtë, vërejta hidhërim në fytyrën e tij e më tha: "Të dy keni të drejtë e mos u përçani ngase paraardhësit tuaj u përçanë dhe u shkatërruan".[36]

Muhaddithinët gjithashtu kanë transmetuar një gjë të tillë nga Umer ibën Hattabi (r.a.) në çështjen e tij me Hisham ibën Hakimin.[37]

Kur dijetari Ibën El-Veziri e komentoi këtë çështje, tha: "Ky është mospajtimi që Pejgamberi a.s. e ka ndaluar, ky që shpie në shkatërrim, ky pra është ai që ka armiqësi në te. Ndërsa mospajtimi në të cilin nuk ka armiqësi ai e ka aprovuar a nuk e shet se i thotë Ibën Mesudit: "Që të dy keni të drejtë" kur ata dy nuk u pajtuan në mënyrën e leximit? Pas dakordimit me leximet e tyre, ua ka tërhequr vërejtjen nga mosmarrëveshja e cila shkakton urrejtjen, armiqësinë dhe përgënjeshtrimin

[36] Buhariu transmeton në Sahihin e tij në librin e tefsirit dhe në librin e vlerave të Kur'anit.
[37] Transmetim unanim sipas "El-Luëluu vel-merxhan fima, ittefeka alejhi shejhan", hadithi (468).

e njëri - tjetrit si dhe e dobëson Islamin dhe ua mundëson armiqve dominimin. Preferohet që të veprohet varësisht nga dija që posedohet pa shkaktuar armiqësi e fyerje."

Ai gjithashtu vazhdon dhe thotë: "Në këtë rrugë kanë ecur selefi nga ehlul-bejti, sahabët dhe tabi'inët."[38]

NATYRA E GJUHËS

Sa i përket natyrës së gjuhës, s'ka dyshim se burime kryesore të fesë janë Kur'ani dhe Sunneti:

Brenda këtij konteksti Zoti i Madhëruar thotë:

"Kur All-llahu ka vendosur për një çështje ose I dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetërfare. E kush kundërshton All-llahun dhe Të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg të vërtetës".

(Ahzabë, 36).

Si Kur'ani famëlart ashtu edhe Sunneti pejgamberik përbëhen nga fjalët që shprehen e lexohen dhe në të cilat mund të aplikohet ajo që aplikohet në tekstet gjuhësore për t'u kuptuar e komentuar, ngase përputhen me atë që e kërkon natyra e gjuhës. Në to ka tekste që përmbajnë

[38] Itharul-hakki alel-halki, f. 375, botim i Darul-kutubil-ilmijje, Bejrut, Liban

më shumë kuptime, që kanë alegori apo jo... Aty ka tekste që kuptohen nga leximi e nga të kuptuarit, që kanë kuptim të përgjithshëm apo të posaçëm, që përmbajnë domethënie të qartë apo të paqartë dhe që kanë natyrën e animit nga njëri apo të mosanimit nga tjetri. Merreni si shembull konkret ajetin e pastërtisë nga sureja El-Maide:

"O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri te dy nyjat. Nëse jeni xhynybë, atëherë pastrohuni (lahuni)! Në qoftë se jeni të sëmurë apo në ndonjë udhëtim, ose nëse ndonjëri prej jush vjen prej tualetit, nëse keni kontaktuar me gratë dhe nuk gjeni ujë, atëherë mësyne (merrni tejemum) dheun e pastër dhe me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja. All-llahu nuk dëshiron (me obligimin për abdest e larje) t'ju shkaktojë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastrojë (prej mëkateve), t'ua plotësojë të mirën e Tij ndaj jush e që t'i falënderoheni".

(Maide, 6).

Mendimet dhe komentimet e dijetarëve muslimanë rreth këtij ajeti janë të shumta dhe më së shumti mbështeten në çështjet gjuhësore.

A konsiderohet farz apo jo sistematizimi i këtyre katër gjymtyrëve? A hyjnë dy bërrylat dhe dy nyjat e këmbëve apo jo?

Shkronja "B" në "Bi-ru'usikum" nënkupton fërkimin e plotë të kokës të një pjese apo ajo është e tepërt?

Si komentohet leximi i "Erxhulikum" me "i"?

Ç'nënkuptohet me fjalën e Zotit të Madhëruar: "Eu lamestamun-nisa'e", prekja e lëkurës apo, siç thotë Ibën Abbasi, marrëdhënia gjinore?

Ç'nënkupton termi "*bisaid"* në "tejemmum"? A nënkupton vetëm dheun apo çdo gjë që është nga lloji i dheut?

Ç'nënkuptohet me "duart" në "...dhe me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja"? Vetëm duart apo ajo që bëhet për abdestin deri në bërryla?

Ç'nënkuptohet me "...dhe nuk gjeni ujë"? A ka për qëllim mungesën e ujit në parim apo në realitet apo edhe kur të ketë nevojë për pije, gatim ose zierje?

Në këtë mënyrë kanë vepruar imamët e shkollave juridike.

NATYRA E NJERËZVE

Gjithashtu edhe natyrën e njerëzve Zoti e ka krijuar të ndryshme. Çdo njeri ka personalitetin e vet të pavarur, intelektin e posaçëm dhe karakterin individual. Sikur që dallohet çdo njeri me fytyrë, zë dhe maje të gishtit të posaçëm gjithashtu dallohet edhe me mendimet, parimet, shijet dhe qëndrimet ndaj gjërave, njerëzve, veprave e vështrimeve. Përpjekjet që njerëzit të mendojnë njësoj janë të kota ngase në këtë mënyrë formohet një kopje e përsëritur, fshihen të gjitha mendimet e ndryshme. Një përpjekje e tillë është absurde ngase në këtë mënyrë kundërshtohet instinkti të

cilin e krijoi Zoti te njerëzit. Instinkti nuk mund të ndryshohet dhe ai që largohet prej tij menjëherë dënohet.

Mendimet e tilla të ndryshme nënkuptojnë çështjen e llojllojshmërisë e jo të armiqësisë. Llojllojshmëria e mendimeve gjithmonë është e begatshme dhe frytdhënëse si dhe është simbol nga simbolet e All-llahut i cili vërteton madhërinë, fuqinë dhe urtësinë e Zotit:

"Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për të diturit".

(Er-Rrum, 22).

Kjo llojllojshmëri në krijimin e njerëzve i ngjason llojllojshmërisë së bimëve, pemëve e perimeve:

"E në tokë ka copa sipërfaqesh të ngjitura njëra me tjetrën, kopshte të hardhisë, të mbjella (të llojllojshme) dhe hurma (bimë këto) që janë të degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuara (nga një filiz) e të gjitha ujiten nga një ujë, dhe Ne shijen në ngrënien e frutave të tyre e kemi dalluar njërën prej tjetrës. Edhe kjo dëshmon me argumente për njerëzit e mençur".

(Er-Ra'd, 4).

Disa njerëz anojnë nga parimet e rrepta e disa nga ato të lehtat, disa mbështeten në formën sipërfaqësore të Kur'anit e disa në atë të brendshmen dhe shpirtëroren e tij, disa pyesin për gjërat e mira e disa për të këqijat nga frika që mos të bien në to, disa kanë fytyrë të buzëqeshur e disa të tjerë të mërrolur.

S'ka dyshim se kjo llojllojshmëri në cilësitë dhe në karakteret psikike të njerëzve rezulton edhe dallimin ndërmjet tyre në gjykim ndaj gjërave, në qëndrimet dheveprat. Kjo gjë është evidente në

sferën e fikhut e të politikës, ashtu siç është evidente në sjelljet e përditshme e të rëndomta të njerëzve. Një dallim i tillë më i dukshëm mund të vërehet te dy sahabët e mirënjohur, Abdullah ibën Umeri dhe Abdullah ibën Abbasi r.a. Ibën Umeri i largonte fëmijët nga frika se mos po e përlyejnë ndërsa Ibën Abbasi i afronte pranë vetes.

Sipas Ibën Umerit, prekja e gruas e prish abdestin kurse sipas Ibën Abbasit, jo.

Sipas Ibën Umerit, nga dispozitat e Haxhit qëndrimi në Muhassab konsiderohet sunnet kurse sipas Ibën Abbasit, jo.

Gjithashtu kishte dallime midis këtyre dyve edhe në Gurin e Zi, ku Ibën Umeri shtyhej derisa ta prekte atë kurse Ibën Abbasi e urrente shtyerjen duke thënë: "As nuk dëmton e as nuk dëmtohet!"[39]

Para Ibën Umerit dhe Ibën Abbasit qëndrime të ndryshme kishte edhe midis dy shejhave Ebu Bekrit e Umerit (r.a.). Ebu Bekri ishte i butë e i mëshirshëm kurse Umeri i ashpër dhe i vrazhdë, dhe nga natyra e tillë e të dyve gjykoheshin edhe gjërat. Qëndrimet e tyre dallohen qartazi në çështjen e robërve të Bedrit.

Në ajetin kur'anor thuhet:

"Për asnjë pejgamber nuk qe me vend të ketë robër derisa të ketë dërrmuar me luftë (armikun) në tokë. Ju keni për qëllim përjetimet e kësaj bote, ndërsa All-llahu dëshiron për ju Ahiretin. All-llahu mbizotëron çdo gjë, di çka është mirë për robtë. Po të mos ishte dispozita e hershme e

[39] *El-Fet-hu*, 3/475-476.

caktuar prej All-llahut (që të mos dënohet ai që përpiqet, po nuk e qëllon), juve do t'ju kishte goditur një dënim i madh për atë që e morët. Pra, (është lejuar plaçka e luftës) hani atë që e fituat me luftë, si të lejuar dhe të mirë, përmbajuni dispozitave të All-llahut se All-llahu është Ai që falë dhe që mëshiron".

(Enfalë, 67-69).

Në komentimin e këtij ajeti, Hafidh ibën Kethiri i thekson të dy qëndrimet e tyre ndaj robërve të luftës. Umeri kërkon të vriten kurse Ebu Bekri propozon të lirohen me kompensim. Pejgamberi a.s. pranon propozimin e Ebu Bekrit dhe në atë rast shpallet ajeti: "Po të mos ishte dispozita e hershme e caktuar prej All-llahut (që të mos dënohet ai që përpiqet, po nuk e qëllon), juve do t'ju kishte goditur një dënim i madh për atë që morët".

Transmetohet se Pejgamberi a.s. i ka thënë Ebu Bekrit:

"Ti, o Ebu Bekër, je si Ibrahimi a.s.:

"(Zoti im! Ata vërtet i shmangin (nga rruga e drejtë shumë njerëz). E kush më respekton mua, ai është i imi (në fe), e kush më kundërshton mua, atëherë Ti je ai që falë dhe që mëshiron".

(Ibrahim, 36).

Ti, o Ebu Bekër je si Isa a.s.:

"Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robër Tu, e nëse u falë atyre, Ti je i gjithfuqishmi, i urti"

(El-Maide, 118).

Në këtë kontekst, Umerit i ka thënë:

"Ti, o Umer, je si Musa a.s.:

"Zoti ynë, zhduke pasurinë e tyre, shtrëngoi zemrat e tyre, e të mos besojnë derisa ta shijojnë dënimin e hidhur".

(Junus, 88).

Ti, o Umer, je si Nuhi a.s.:

"O Zoti im, mos lë mbi tokë asnjë nga jobesimtarët".

(Nuh, 26)

Pra, natyrat dhe shijet e njerëzve që janë të ndryshme e të llojllojshme gjithashtu ndikojnë edhe në qëndrimet e tyre, madje, dallimet e tilla janë të dukshme edhe midis dy vëllezërve, si p.sh. midis pejgamberëve Musës dhe Harunit a.s. dhe midis sahabëve Hasanit dhe Husejnit r.a.

NATYRA E GJITHËSISË DHE E JETËS

Gjithashtu edhe në gjithësi, gjegjësisht në pjesën ku jetojmë, Zoti i Madhëruar ka krijuar lloje, forma e ngjyra të ndryshme. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"A nuk e sheh se All-llahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilëve është e ndryshme, e edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme.

Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka, është mëkatfalës.

(Fatir, 27-28).

Kjo llojllojshmëri që përmendet në Kur'an nuk nënkupton kundërshtime dhe konflikte por dallim llojesh, dhe për këtë shprehja "ngjyra të ndryshme" përsëritet në shumë sure dhe në shumë raste.

Vetë Kur'ani mohon kundërshtimin dhe konfliktin në gjithësi:

"Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje?",

(Mulk, 3).

Gjithashtu edhe natyra e jetës ndryshon varësisht nga faktorët e kohës dhe të vendit.

B. EKZISTIMI I MENDIMEVE TË NDRYSHME ËSHTË MËSHIRË

Ekzistimi i mendimeve të ndryshme gjithashtu është edhe mëshirë për ummetin. Këtë e vërejmë qartazi në hadithin që përdoret shumë, e që nuk ka *"sened"* të njohur përveç autenticitetit në

kuptim e që e përdori Sujuti në veprën e tij *"El-Xhami us-sagir"*: "Ekzistimi i mendimeve të ndryshme në ummetin tim konsiderohet mëshirë".40

Këtë hadith e përforcon transmetimi i Darekutnit dhe i Neveviut në "El-Erbe'inë": "Zoti i Madhëruar ka caktuar përkufizime, pra mos i tejkaloni; ka obliguar farze, pra mos i humbni; ka ndaluar gjëra, pra mos i bëni (mos i shkelni ndalesat e Tij); ka heshtur gjëra nga mëshira ndaj jush e jo nga harresa, pra, mos hulumtoni në to!"

Gjërat e heshtura zakonisht janë nga shkaqet që shkaktojnë mospajtimin sepse ajo mbetet një fushë e zbrazët legjislative e të cilën çdo jurist orvatet ta plotësoj në bazë të parimeve që i përcjell dhe të shkollës të cilës i përket. I pari mbështetet në "kijas", i dyti në "istihsan", i treti në "istisllah", i katërti në "urf" etj.

Është me rëndësi të ceket se të heshturit nga disa gjëra nuk nënkupton hutinë ose harresën e Zotit por mëshirën dhe lehtësimin për ummetin. Edhe pse ky hadith ka "sened" të dobët, ekziston hadithi tjetër që e përforcon. Në këtë hadith të transmetuar nga Ebu Derdaja, Pejgamberi a.s. thotë:

---

40 Dijetari El-Munavi, në librin e vet *"Fejdul-kadir*, 1/212" thotë: "Subkiu thotë se ky (hadith) nuk është i njohur te muhaddithët, nuk kam pasë "sened" të tij as autentik, as të dobët e as të trilluar. Sujuti thotë se ndoshta është transmetuar në literaturën e cila nuk ka arritur te ne. Bejhekiu në *"El-Med-hal"* dhe Dejlemiu në *"Musnedul-firdeus"* e transmetojnë nga Ibën Abbasi në formën *"merfu'ë":* "Ekzistimi i mendimeve të ndryshme te sahabët e mi është mëshirë". Pra, termi "sahabët" nënkupton edhe "ummetin". Hafidh Irakiu e konsideron hadith me sened të dobët kurse Adem ibën Ebi Ijasi e konsideron "mursel" të dobët"...

"Atë që e ka lejuar All-llahu në Librin e Tij konsiderohet hallall; atë që e ka ndaluar, haram; atë që e ka heshtur, mëshirë, pra pranoni prej All-llahut Mëshirën e Tij ngase All-llahu nuk harron gjë". Pastaj ka lexuar: "Zoti yt nuk harron..." (Merjem, 64)."[41]

Edhe në këtë hadith heshtja në disa gjëra konfirmon mëshirën dhe lehtësimin për këtë ummet. Nga kjo nënkuptohen dy gjëra.

E para: Heshtja në disa gjëra ua mundëson dijetarëve muslimanë hulumtimin për t'i kuptuar dhe

E dyta: Teksti mund të ketë kuptime të ndryshme dhe kështu përfitohen mendime dhe ide të nduarnduarta.

Kështu pra, shumë sahabë kanë patur mendime të ndryshme për çështjet parciale e të vogla pa u ngushtuar nga to fare. Ja, edhe halifi i drejtë, Umer ibën Abdulazizi, kur flet për sahabët, thotë: "Nuk do të gëzohesha sikur sahabët e Pejgamberit të Zotit të kishin një mendim të përgjithshëm, ngase sikur të mos kishin mendime të ndryshme, ne nuk do të kishim lehtësim (ruhsa)."[42] Nga kjo nënkuptohet se mendimet e tyre të ndryshme na mundësojnë alternativa dhe lehtësime të ndryshme. Përveç kësaj, ato na e mësojnë hulumtimin në çështjet ku mund të bëhet "ixhtihad" dhe të mbetemi vëllezër e dashamirë.

---

[41] Transmeton Hakimi dhe me te pajtohet edhe Dhehebiu 2/2375; Hejthemiu në *"Mexhme'uz - Zevaid"* 1/171, dhe thotë: e transmeton Bezari dhe Taberaniu në *"El-Kebir"*.

[42] Transmetim i Bejhekiut në *"El-Med-hal"* sipas *"Fejdul-kadir"* 1/209, dhe Ibën Abdul-birrit në *"Xhami'u bejanil-ilmi*, 2/80, botim i *"El-Munirijje"*.

Transmetohet nga Kasim ibën Muhammedi i cili ishte njëri ndër shtatë fukahatë më të njohur në kohën e tabi'inëve në Medine, se kur është pyetur për leximin e Kur'anit pas imamit që nuk lexon me zë, ka thënë: "Nëse lexon, ke shembull nga sahabët e Pejgamberit të Zotit e nëse nuk lexon, përsëri ke shembull nga sahabët e Pejgamberit të Zotit".

Transmeton Ibën Abdul - Birri En-Nemri nga Jahja ibën Seidi se ka thënë: "Dhënësit e fetfave gjithmonë japin fetva, njëri lejon e tjetri ndalon. Ndaluesi nuk e sheh se lejuesi shkatërrohet nga lejimi i tij, e as lejuesi nuk e sheh se ndaluesi shkatërrohet nga ndalimi i tij."[43]

Ixhtihadi është i lejuar kurse ekzistimi i mendimeve të ndryshme është çështje e nevojshme. Sheriati nuk e privon nga shpërblimi atë që gabon, gjë që nënkupton mëshirën dhe lehtësimin. Kjo nuk do të thotë se të gjitha mendimet janë të sakta meqë vetëm njëri prej tyre është i saktë, mirëpo të gjithë kanë mirënjohje dhe shpërblehen. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"E Sulejmanit Ne ia mësuam atë (përgjigjen e saktë), po secilit (prej tyre) i patëm dhënë urtësi e dije".

(Enbija, 79).

Duke u mbështetur në këtë, brezat e kaluar dhe të mëvonshëm formuan maksimën: "Ekzistimi i mendimeve të ndryshme konsiderohet lehtësim dhe mëshirë".

Imam Hitabiu (vdiq në vitin 340 hixhri) e përmend hadithin dhe thotë se llojllojshmëria e mendimeve te ummeti është mëshirë, dhe më tej vazhdon e thotë: "Këtë hadith e kanë kritikuar dy

[43] Xhemi'u bejanil-ilmi, 2/80.

njerëz. Njëri prej tyre ishte i ahengut kurse tjetri pabesimtar, dhe që të dy kanë thënë: "Nëse llojllojshmëria e mendimeve konsiderohet mëshirë, atëherë fjala e përbashkët do të ishte dënim! Pastaj janë kritikuar thëniet e tyre".[44]

Ndër brezat e mëvonshëm gjejmë autorin që shkroi veprën me titull "Mëshira e ummetit nga mendimet e ndryshme të imamëve (dijetarëve)".[45]

Dijetari Shejh Mer'a El-Hanbeli thotë: "Ekzistimi i medhhebeve të ndryshme në këtë popull është mëshirë e madhe dhe vlerë e madhe. Këtu ka një fshehtësi të bukur të cilën e kuptojnë dijetarët kurse injorantët jo. Ekzistimi i llojllojshmërisë së mendimeve është karakteristikë e këtij ummeti dhe lehtësim në këtë Sheriat tolerant dhe të lehtë".

KUNDËRSHTIM DHE MBROJTJE

Në një kongres të rinisë bëra përpjekje që ta sqaroj këtë mëshirë të tillë, mirëpo njëri nga të pranishmit më kundërshtoi duke cituar fjalën e Zotit:

---

[44] "Kefshul-Hafa ve muzilul-ilbasi" nga autori El-Axhluni, 1/65.

[45] Autor është Ibën Abdullah Muhammed Ibën Abdurahman Ed-Dimeshki, Esh-Shafi'ij, nga dijetarët e shekullit të tetë hixhri. Këtë vepër e ka botuar Idaretu Ihja'it - turathil-islamij në Katar në vitin 1401 hixhri.

"Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit të një feje (por nuk dëshiroi, Ai e di pse). Ata vazhdimisht janë në kundërshtim (mes vete), përveç atij që e mëshiroi Zoti yt. Po për këtë edhe i krijoi ata".

(Hudë, 118-119).

I thashë atij se ajetin që e lexove e konsideroj si argument timin ngase ekzistimi i mendimeve të ndryshme është dëshirë e Zotit të Madhëruar dhe rrjedh nga urtësia e Tij. Kjo vërteton se kjo çështje është realitet, e dëshirën e Zotit nuk mund ta kundërshtojë askush.

Ai tha se përjashton nga ata që nuk pajtohen vetëm ata që i ka mëshiruar All-llahu, e kjo len të kuptohet se mospajtimi mohon mëshirën.

I thashë se kjo është e vërtetë por ka të bëjë me ata që kundërshtojnë njëri-tjetrin në çështjet thelbësore e të besimit, si p.sh. hebrenjtë, të krishterët dhe ata që u takojnë feve tjera, të cilët akuzojnë njëri-tjetrin për herezi, mirëpo kur bisedohet për kundërshtimet në çështje që nuk janë definitivisht të qarta, e që kanë të bëjnë me çështjet e dorës së dytë, atëherë ndryshon situata.

MENDIMET E NDRYSHME NË ÇËSHTJET E DORËS SË DYTË KONSIDEROHEN MËSHIRË

Në librin "El-i'ëtisam", Imam Shatibiu ka shkruar një tekst rreth kësaj çështjeje. Edhe pse më parë e kam përkufizuar, mendoj se këtu është më së miri që ta theksoj në tërësi:

"Ndonjëherë, në mesin e të dakorduarve lindin mospajtime nga qëllimi i dytë e jo nga qëllimi i parë, ngase Zoti i Madhëruar me urtësinë e Tij ka përcaktuar që çështjet e dorës së dytë të jenë diskutabile. Sipas teoricientëve, teoritë nuk mund të jenë kompakte ngase ka shumë vend për diskutime në çështjet teorike, gjegjësisht në sekondaret e jo në parësoret, në pjesërishmet e jo të përgjithshmet, dhe për këtë shkak, këto kundërshtime nuk janë të dëmshme.

Komentuesit e këtij ajeti transmetojnë se Hasani ka thënë: "Të mëshiruarit nga Zoti nuk kanë kundërshtime që dëmtojnë, ngase ato zhvillohen në çështjet e padefinuara kategorikisht" meqë Ligjdhënësi e ka ditur se do të paraqiten kundërshtime të tilla. Ai e thekson edhe mbështetjen në këto raste:

"Nëse konfrontoheni në ndonjë çështje, atëherë mbështetuni në All-llahun dhe në Pejgamberin".

Pra, në çdo mosmarrëveshje të tillë, urtësia e Zotit përcakton që mbështetja të jetë tek Ai (në Kur'an) dhe te Pejgamberi i Tij, gjegjësisht te Pejgamberi në qoftë se është i gjallë apo në Sunnetin e tij pas vdekjes së tij. Kështu edhe vepruan dijetarët (r.a.).

Nëse ndokush shtron pyetjen se a përfshihen këta në fjalën e Zotit: "Ata vazhdimisht janë në kundërshtim (mes vete)", përgjigjem se nuk përfshihen për disa shkaqe:

1. Ajeti i thekson kundërshtarët që janë jashtë mëshirës së Zotit: "Ata vazhdimisht janë në kundërshtim (mes vete) përveç atij që e mëshiroi Zoti yt". Këtu ekzistojnë dy grupe: grupi i kundërshtarëve dhe ai i të mëshiruarve, dhe nga teksti vërehet qartë se të mëshiruarit nuk janë pjesë e kundërshtarëve sepse, në të kundërtën, përjashtimi nuk do të ishte i drejtë.

2. Pastaj shihet qartë se kundërshtimet e tilla janë të domosdoshme, gjë që vërehet qartë nga përdorimi i termit në participim aktiv, kurse të mëshiruarit janë të pastër nga kundërshtimet e tilla.

Mëshira kundërshton kundërshtimet e përhershme. Në qoftë se ndonjëri prej të mëshiruarve kundërshton, ai hulumton qëllimin hyjnor, e kur ta kuptojë gabimin, atëherë distancohet.

3. Ekzistimi i mendimeve të ndryshme në çështjet e ixhtihadit është i rëndomtë dhe mëshirë e pastër. Në këtë kontekst hyjnë sahabët dhe tabi'inët, gjë që nuk është në rregull që t'i radhisim në mesin e kundërshtarëve. Sikur të ishin nga kundërshtarët atëherë nuk do të mund t'i konsideronim të mëshiruar. Këtë e ka ndaluar i tërë ehlu-sunneti.

4. Sipas selefit, ekzistimi i mendimeve të ndryshme në mesin e ummetit për çështjet dytësore konsiderohet një lloj mëshire dhe për këtë shkak, mendimtarët e ndryshëm nuk mund të jenë jashtë grupit të të mëshiruarve.

Për ta vërtetuar një gjë të tillë, do ta theksoj transmetimin e Kasim ibën Muhamedit, i cili ka thënë: "Zoti ka caktuar dobi në punë nga mendimet e ndryshme të sahabëve të Pejgamberit të Zotit. Secili që ka punuar sipas tyre, ka vërejtur se është në mirësi". Damre ibën Rexha'i transmeton se Umer ibën Abdulazizi dhe Kasim ibën Muhamedi ishin tubuar dhe e kishin përsëritur hadithin. Umeri kishte cekur diçka që e kundërshtonte Kasimin, dhe kur ishte nervozuar Kasimi, Umeri i kishte thënë: "Mos vepro ashtu! (Mos u nervozo!)". Ibën Vehebi transmeton se Kasimi ka thënë: "Më pëlqeu fjala e Umer ibën Abdulazizit. Sikur të ishin të gjithë të një fjale, njerëzit do të jetonin në vështirësi..."

Kjo nënkupton të vërtetën se ata (brezat e parë) i hapën dyert e ixhtihadit dhe lejuan ekzistimin e mendimeve të ndryshme ngase në të kundërtën, muxhtehidët do të përjetonin vështirësi të mëdha. Muxhtehidi ndjek mendimin e vet e sikur ta pranonte atë që nuk e bindë, atëherë kjo do të ishte një ngarkesë e madhe për të dhe për këtë shkak, mendimet e ndryshme në çështjet dytësore konsiderohen mëshirë e Zotit për ummetin. Meqë kjo është edhe hapje e derës së mëshirës, atëherë si të mos bëjnë pjesë në grupin "përveç atij që e mëshiroi Zoti yt". Kundërshtimet (mospajtimet) e tyre në çështjet dytësore trajtohen sikur edhe pëlqimi i tyre në to.

Falënderimi i takon All-llahut![46]

EKZISTIMI I MENDIMEVE TË NDRYSHME ËSHTË PASURI

Llojllojshmëria e mendimeve nuk është vetëm e domosdoshme dhe mëshirë por edhe pasuri.

Përmes mendimeve të ndryshme pasurohet fikhu (jurisprudenca islame), zhvillohet dhe zgjerohet ngase çdo mendim mbështetet në argumente. Aty punojnë njerëz me intelekt të zhvilluar të cilët bëjnë ixhtihad, induktojnë, analizojnë, preferojnë, balancojnë, përcaktojnë parime, definojnë rregulla. Kështu, pra, zhvillohen degëzimet dhe çështjet...

[46] *El-I'ëtisam,* Shatibi, 2/168-171 me komentimet e Sejjid Reshid Ridasë.

Në bazë të këtyre mendimeve të ndryshme pasurohet sfera juridike-legjislative nga shkolla tradicionale e hadithit në shkollë racionale dhe mandej në shkollë objektive e cila zgjedh çdo gjë më të mirë nga të gjitha shkollat, duke u larguar nga çdo dobësi dhe anim ndaj këtij apo atij imami (themeluesve). Pra, në këtë mënyrë përfitohet pasuri aq e madhe saqë vlerën e saj mund ta kuptojë vetëm dijetari dhe hulumtuesi i vërtetë. Kjo pasuri e tillë është theksuar në simpoziume e konferenca ndërkombëtare në kohën tonë, si p.sh. në Konferencën e Lahait për të Drejtën Krahasimore që u mbajt në vitin 1936 dhe Konferencën e Parisit në vitin 1951. Këtë e ka vlerësuar edhe Akademia Juridike-Islame e Ligës Botërore Islame në mbledhjen e dhjetë të mbajtur në vitin 1408 hixhri për dallimet ndërmjet shkollave juridike islame dhe fanatizmin medhhebor të disa pasuesve të tyre.

Në vazhdim vijon teksti:

"Falënderimi i takon vetëm All-llahut dhe mëshira e paqja qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhammedin a.s. dhe mbi as-habët e tij".

Në mbledhjen e dhjetë të mbajtur në Mekke prej të shtunës së 17.10.1987 (24 sefer 1408) deri të mërkurën e 21.10.1987 (28 sefer 1408), Këshilli i Akademisë Juridike-Islame i ka shtjelluar mendimet ndërmedhhebore dhe ekstremizmin e disa ithtarëve, të cilët largohen nga vija objektive dhe të cilët i fyejnë ithtarët dhe dijetarët e medhhebeve tjera.

Këshilli i ka paraqitur problematikat që mbizotërojnë në mendjet dhe në konceptet e brezit bashkëkohor për mendimet, gjë që gjithashtu ndërmedhhebore shtron pyetjen se, pasi që Sheriati islam është një dhe pasi që burimet e tij rrjedhin nga Kur'ani famëlart e Sunneti pejgamberik,

atëherë pse të ketë mendime të ndryshme medhhebore? Pse nuk bashkohen të gjithë muslimanët në një medhheb dhe në një mënyrë të të kuptuarit të parimeve të Sheriatit?

Këshilli gjithashtu e ka paraqitur edhe fanatizmin sektar dhe problemet që lindin nga ky fenomen, posaçërisht nga ithtarët e disa rrymave bashkëkohore, të cilët thërrasin në forma të reja të ixhtihadit duke i kritikuar medhhebet ekzistuese që i ka trashëguar ummeti që nga kohët më të hershme islame, i kritikojnë imamët juristë, i akuzojnë disa prej tyre për devijim e humbje dhe shkaktojnë huti e fitne midis njerëzve.

Duke e patur parasysh këtë problematikë, Akademia Juridike-Islame vendosi që t'ua dërgojë këto të dhëna akuzuesve dhe ekstremistëve, me qëllim që t'ua tërheq vërejtjen dhe t'i kuptojnë gjërat.

I. MENDIMET E NDRYSHME MEDHHEBORE

Mendimet e ndryshme medhhebore në vendet islame ndahen në dy lloje:

1. Në medhhebe të besimit dhe

2. Në medhhebe të fikhut (të jurisprudencës islame)

MEDHHEBET E BESIMIT

Ky lloj i medhheb ka të bëjë me mospajtime në çështjet e besimit dhe, në realitet, ka shkaktuar tragjedi të mëdha në vendet islame, i ka përçarë radhët e muslimanëve, e ka ndarë fjalën e tyre, në vend që të bashkohet ummeti në Medhhebin e ehlu-sunet vel-xhema'a, i cili përfaqëson mendimin e shëndoshë islam të kohës së Pejgamberit a.s. dhe të Hulefai Rashidinëve, për të cilët Pejgamberi a.s. ka thënë: "Mbështetuni në Sunnetin tim dhe në Hulefai-Rashidinëve pas meje..."

MEDHHEBET E FIKHUT

Ky lloj i smedhhebeve ka të bëjë me mospajtimet në disa çështje ndërmjet medhhebeve juridike islame për shkaqe shkencore. Ai tregon Urtësinë e madhe të Zotit ngase vërtetohet mëshira e Tij mbi robërit e Vet, mundësohet induksioni i parimeve nga Kur'ani e Sunneti dhe përfitohet pasuri e madhe juridike-legjislative që hap horizonte të tjera në çështjet e fesë dhe të Sheriatit.

Ky lloj ofron mundësinë e alternativave tjera. Në qoftë se një medhheb nuk mjafton për zbërthimin e problemeve të një kohe apo të një vendi, atëherë merren parasysh zbërthimet e medhhebeve tjera me qëllim lehtësimi, qoftë nga sfera e ibadeteve e mu'amelateve apo nga sfera e familjes, gjykatës e burimeve në bazë të argumenteve të Sheriatit.

Pra, ky lloj i dytë i mospajtimeve medhhebore ka të bëjë me çështjet e Fikhut (Jurisprudencës islame) dhe nuk nënkupton mangësi ose kontradiktë në fenë tonë. Asnjë popull tjetër nuk posedon pasuri të madhe juridike e legjislative ashtu siç posedon ummeti islam.

Ekzistimi i mendimeve të ndryshme është realitet, ngase tekstet burimore në shumë raste kanë më tepër se një domethënie dhe se teksti nuk mund t'i përmbledhë të gjitha ngjarjet për shkak se horizontet e ngjarjeve janë të pakufizuara. Duke e marrë parasysh fenomenin e horizonteve të pakufizuara, një grup dijetarësh (Zoti i mëshiroftë) obligojnë mbështetjen në Kijas (analogji) për t'i zbërthyer motivet, qëllimet dhe synimet e Ligjdhënësit dhe të Sheriatit. Dijetarët marrin qëndrime të ndryshme në raste e ndodhi të reja, me qëllim që të marrin vendime të sakta për ta arritur të vërtetën. Ai që e qëllon ka dy shpërblime, e ai që gabon ka vetëm një.

Nisur nga ky fakt, atëherë si mund të mendohet për mangësinë? Ekzistimi i mendimeve të ndryshme medhhebore është mirësi, mëshirë, begati dhe pasuri e Zotit për robërit e tij besimtarë. Në të njëjtën kohë, ky fenomen gjithashtu konsiderohet edhe pasuri e madhe legjislative me të cilën mund të mburret ummeti islam.

Të huajt i shfrytëzojnë njohuritë e dobëta islame të rinisë muslimane sidomos të atyre që studiojnë jashtë, ua paraqesin mendimet e ndryshme të shkollave juridike islame si mospajtime në besim, me qëllim që t'ua konfirmojnë kundërshtitë në Sheriat pa bërë fare dallim ndërmjet llojit të parë e të dytë.

Në sqarimin tonë të medhhebeve juridike të imamëve juristë dhe të karakteristikave të tyre, ekzistojnë argumente të cilat duhet ta bindin grupin që thërret në braktisjen e medhhebeve dhe të largohet nga idetë e tilla ngase krijojnë huti midis njerëzve, i copëtojnë radhët e tyre dhe e

përçajnë fjalën e tyre në kohën kur më së shumti kemi nevojë për unitet kundër armiqve të rrezikshëm të Islamit.

Zoti e Mëshiroftë pejgamberin tonë, Muhammedin dhe familjen e tij, paqja qoftë mbi të dhe falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botëve".[47]

EKZISTIMI I MENDIMEVE TË NDRYSHME NË SHEKUJT MË TË MIRË TË UMMETIT

Fenomeni i mendimeve të ndryshme ka ekzistuar edhe në kohën e imamëve të mëdhenj, në kohën e Ebu Hanifes, Malikit, Shafisë , Ahmedit, Theurit, Euza'it etj. Të gjithë këta nuk shihnin ndonjë të keqe në fenomenin e tillë dhe asnjëri nuk është orvatur që t'i bindë të tjerët me forcë e as që e kanë akuzuar apo ofenduar njëri-tjetrin për diçka.

Kur është pyetur Imam Ahmedi për faljen namazit pas imamit që i ka rrjedhur gjak nga ndonjë plagë pa e ripërsëritur abdestin (edhe pse Ahmedi e ka refuzuar namazin e tillë), ka thënë: "Si të mos falem pas Malikit dhe Se'id ibën Musejjebit?" (Këta të dy e lejonin namazin e tillë).

Para Imam Ahmedit gjithashtu është shënuar qëndrimi historik i Malikit pas përpilimit të veprës "El-Muvat-ta". Halifi abasid, Ebu Xha'fer Mensuri, kishte kërkuar prej Malikut që të përpilojë një

[47] Revista e Akademisë Juridike-Islame, viti i dytë, Nr. 3, f. 173.

libër që do të jetë ligj i përgjithshëm për shtetin e halifatit dhe që do t'i shfuqizojë të gjitha mendimet dhe ixhtihadet tjera. Kërkesës së halifit abasid ai i është përgjigjur kështu:

"O prijës i besimtarëve, mos vepro kështu ngase paraprakisht njerëzit kanë dëgjuar thënie e hadithe dhe kanë transmetuar transmetime të shumta, kështu që shumë kanë marrë nga të parët dhe janë transformuar në shoqëri të ndryshme. Pra, lejoi njerëzit dhe atë që e kanë zgjedhur për vetvete!"

Gjithashtu transmetohet se Harun Rashidi ka kërkuar prej Malikut që ta vejë "Muvat'ta'in" në Kabe e t'i obligojë njerëzit me të, mirëpo ai ka reaguar dhe i ka thënë: "Sahabët e Pejgamberit a.s. kanë patur mendime të ndryshme në çështjet dytësore dhe me kalimin e viteve janë shpërndarë në vende të ndryshme!" Kur e dëgjon Harun Rashidi këtë reagim, i thotë: "Zoti të mëshiroftë o Ebu Abdullah!" (Këtë e ka rrëfyer Sujuti).[48]

Ky fenomen gjithashtu ka ekzistuar edhe në kohën e tabi'inëve, të cilët ishin nxënës të sahabëve, madje edhe në kohën e vetë sahabëve gjatë komentimit të teksteve, varësisht nga konstrukti i tyre psikik të cilin e përmendëm më parë.

Unë them se fenomeni ka ekzistuar edhe në kohën e Pejgamberit a.s., si p.sh. në çështjen e namazit të ikindisë në Beni Kurejdha etj.

Në librin "El-huxh-xhetul-baligatu", dijetari musliman Dehlevi thotë: "Dallimet midis fukahave më së shumti janë zhvilluar rreth çështjeve për të cilat ka patur argumente nga sahabët r.a., si p.sh.

[48] Huxh-xhetull-llahi el-baligatu, 1/145.

tekbire gjatë namazit të dy bajrameve apo mosleximi me zë i "bismilahit" apo i "amin-it" etj. Kjo ka të bëjë me preferimin e njërit mendim mbi tjetrin e kurrsesi se njëri është i pranuar e tjetri jo".

Selefi nuk ka diskutuar rreth burimit të vendimeve por rreth përparësisë së çështjeve, si p.sh. rreth mënyrave të leximit kur dihet se rreth kësaj çështjeje ekzistojnë mendime të ndryshme nga sahabët r.a., të cilat në përgjithësi janë në rregull.

Për këtë shkak vërejmë se dijetarët i lejojnë fetvatë e muftinjve në çështjet e ixhtihadit, pranojnë gjykimin e gjykatësve dhe në disa raste veprojnë kundër parimeve të medhhebeve të tyre. Imamët e medhhebeve i paraqesin mendimet e ndryshme duke thënë: "Ky mendim propozohet ose ky mendim është më i pranuar, ose anoj më tepër nga ky mendim...!"

Shumë deklarata të tilla i gjejmë në El-Mebsutë dhe poashtu theksohen në Athar (gjurmët) e Muhammedit (ibën Shejbanit) dhe në fjalët e Shafi'iut (Zoti i mëshiroftë).

Pas kalimit të një kohe të caktuar, dolën në skenë njerëzit që mbështeteshin vetëm në medhhebin apo në imamin e tyre të zgjedhur. Ajo që transmetohet nga selefi për respektimin e domosdoshëm të medhhebit, ndodh nga fakti se individi punon ashtu siç dikton shoqëria madje edhe në veshje dhe ushqim ose nga ndonjë arsye tjetër. Edhe pse disa mendojnë se rastet e tilla shpiejnë në ekstremizëm, realiteti është krejtësisht ndryshe.

Disa sahabë, tabiinë dhe të tjerë pas tyre e kanë lexuar "bismilahin" (në namaz) e disa jo, kurse disa e kanë lexuar me zë e disa pa zë. Ka patur prej tyre që e kanë lexuar "kunutin" në namazin e mëngjesit e disa jo. Disa prej tyre kanë menduar se të prekurit e organeve gjenitale apo i grave me epsh e prishë abdestin kurse sipas disa të tjerëve, abdesti në raste të tilla nuk prishet.

Edhe pse kanë ekzistuar dallime të tilla, vërejmë se disa prej tyre janë falur edhe pas të tjerëve, si p.sh. Ebu Hanifja, shokët e tij dhe Shafiu janë falur pas imamëve malikitë në Medine, pa marrë parasysh se nuk e lexonin bismilahin as me zë e as pa zë.

Kur është pyetur Ahmed ibën Hanbeli për namazin pas atij që i ka rrjedhur gjak nga trupi, ka thënë: "Si të mos falem pas Imam Malikit dhe Se'id ibën Musejjebit?"

Transmetohet se Ebu Jusufi dhe Muhamedi i kanë bërë tekbiret në dy bajramet ashtu siç i bënte Ibën Abbasi ngase Harun Rrashidi e donte mënyrën e tekbireve të gjyshit të vet.

Kur e ka falur Shafiu namazin e mëngjesit afër varrit të Ebu Hanifes (Zoti e mëshiroftë), nuk e ka bërë kunutin nga respekti ndaj tij Ai gjithashtu ka thënë: "Ndoshta kemi hyrë në medhhebin e banorëve të Irakut!"

Kështu ka vepruar edhe Maliku me Mensurin e Harun Rrashidin, ashtu siç theksuam më parë.

Transmetohet se Ebu Jusufi, imami i dytë, e ka falur namazin e xhumasë me abdest nga uji i banjës. Kur është informuar pas faljes së namazit se një mi i ngordhur paska qenë në pusin e banjës, ka thënë: "Pra, të veprojmë sipas vëllezërve tanë nga Medineja."

Kur është pyetur Imam Huxhnedi (Zoti e mëshiroftë) se në qoftë se një ithtar i Medhhebit shafi'it nuk ka falur namaz një ose dy vjet, e pastaj është kthyer në Medhhebin hanefit, atëherë sipas cilit medhheb duhet të falë kada, ai është përgjigjur:

"Sipas medhhebit që dëshiron!"

Në qoftë se gjykatësi (kadija) vendos diçka që nuk përputhet me parimet e ndonjë medhhebi, gjegjësisht me medhhebin e palës, atëherë ai do të veprojë sipas vendimit të gjykatësit. Në këtë kontekst Muhammedi (Zoti e mëshiroftë) thotë se, në qoftë se gjykatësi gjykon ndryshe nga fetvatë e fukahave për diçka të lejuar apo të ndaluar, atëherë pranohet vendimi i gjykatësit dhe lihen fetvatë e fukahave".[49]

MENDIMET E NDRYSHME KANË EKZISTUAR EDHE NDËRMJET MELEQVE

Kur'ani famëlart thekson se edhe meleqtë kanë patur dallim mendimesh, madje se edhe kanë zhvilluar polemika. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

Thuaj: "... Unë nuk kam pasur kurrfarë dije për elitën e lartë (meleqtë) kur ata bënë polemikë (rreth Ademit)".

(Sad, 69).

[49] Huxh-xhetull-llahi el-baligatu, 1/159-160.

EDHE NDËRMJET PEJGAMBERËVE PATI MENDIME TË NDRYSHME

Musa a.s. zhvilloi polemikë me vëllain e vet Harunin a.s., përderisa Musa e ka kapur vëllain e vet për mjekre dhe shumë e ka qortuar pas adhurimit të Beni Israilëve që i bënë viçit që e kishte punuar Samiriju:

"Ai (Musai u kthye e) tha: "O Harun, ç'të pengoi ty kur i pa se morën rrugën e gabuar, e ti të mos e vazhdosh rrugën time? A mos e kundërshtove edhe ti porosinë time?"

"Ai (Haruni) tha: "O bir i nënës sime, mos më kap as për mjekre e as për flokë, se unë u frikësova se do të thuash: "I përçave Beni israilët dhe nuk e ke respektuar porosinë time?"

(Ta-ha, 92-94).

Në një sure tjetër, ai i thotë:

"Mos i kënaq me mua armiqtë".

(A'rafë, 150).

Gjithashtu u zhvillua polemikë edhe midis Musait a.s. dhe Hidrit a.s. për tri gjëra, të cilat edhe e shkaktuan ndarjen e tyre.

"Tash është koha e ndarjes mes meje dhe mes teje, e unë do të tregoj për domethënien e asaj që nuk munde të keshë durim".

(Kehf, 78).

Më gjerësisht lexoi ajetet 65-78 në suren Kehf.

Polemikë u zhvillua edhe ndërmjet Davudit dhe djalit të tij Sulejmanit a.s. për dhentë. Kur'ani tregon se e vërteta ka qenë me djalin mirëpo i lavdëron që të dy:

"E Sulejmanit Ne ia mësuam atë (përgjigjen e saktë), po secilit (prej tyre) u patëm dhënë urtësi e dije".

(Enbija, 79).

Në një hadith theksohet polemika ndërmjet meleqve të mëshirës dhe atyre të dënimit për një njeri i cili kishte vrarë 100 njerëz, por më vonë ishte penduar dhe kishte vdekur në rrugë për në fshatin e të mirëve. Pra, a të dënohet në bazë të jetës së kaluar në fshatin e të këqijve apo në bazë të fshatit në të cilin ishte nisur? Shkurt thënë, a të dënohet sipas veprave apo sipas qëllimit. Në një polemikë të tillë, Zoti dërgon një melek i cili gjykon në favor të meleqve të mëshirës.

Gjithashtu është zhvilluar polemikë ndërmjet Ademit e Musait rreth shkakut të daljes nga xhenneti dhe zbritjes në tokë. (Transmetim unanim).

Në hadith gjithashtu theksohet polemika ndërmjet Davudit dhe Sulejmanit rreth dy grave të cilat janë kacafytur për shkak të një fëmije. Kjo ngjarje transmetohet në të dy sahihët. (Transmetim unanim).

Meqë kanë ekzistuar mendime të ndryshme ndërmjet krijesave më fisnike të cilat i krijoi Zoti i Madhëruar, gjegjësisht ndërmjet meleqve e pejgamberëve të cilët kishin dituri të gjerë, atëherë si të shpresojmë në anulimin e fenomenit të tillë nga njerëzit?

POLEMIKA E URREJTUR

Nëse polemika (mospajtimi) në dytësore dhe në disa parësore qenka domosdoshmëri, mëshirë dhe gjerësi, atëherë çka mund të jetë polemik e urrejtur?

Përgjigjja është kjo:

1. Në qoftë se shkak i saj është e keqja dhe epshi, për çfarë Zoti i ka qortuar hebrenjtë dhe të krishterët nga pasuesit e Librit por edhe të tjerët të cilët dashuria për këtë botë dhe pëlqimi i vetes i ka shtyrë në mospajtim (polemikë) të urrejtur përkundër argumenteve të qarta:

"Njerëzit ishin një popull (të fesë së natyrshme islame), e (kur u përçanë) All-llahu dërgoi pejgamberët përgëzues dhe qortues dhe atyre Ai ua zbriti edhe librin me fakte të sakta për të gjykuar në atë që u kundërshtuan ndërmjet veti".

(Bekare, 213).

"Feja e pranueshme te All-llahu është Islami, e atyre që u është dhënë libri, pasi mësuan për të vërtetën, vetëm nga zilia mes vete kundërshtuan".

(Ali Imran, 19).

"Ne u patëm dhënë Beni israilëve librin dhe pejgamberllëkun dhe aftësi për të gjykuar midis njerëzve, i patëm furnizuar ata me të mira dhe i patëm dalluar nga njerëzit tjerë.U patëm dhënë edhe fakte të qarta për çështjen e fesë. Mirëpo, për shkak të zilisë që kishin ndërmjet vete, ata u përçanë vetëm atëherë kur u erdhi dija që ta kuptojnë se s'ka dyshim se Zoti yt në Ditën e Kijametit do të gjykojë midis tyre për shkaqet e përçarjes së tyre".

(Xhathije, 16-17).

2. Polemika e urrejtur poashtu është edhe ajo e cila e përçanë unitetin, shkakton armiqësi brenda ummetit dhe inicon fraksione të cilat luftojnë njëra – tjetrën. Kur'ani famëlart dhe Sunneti i pastër e kritikojnë ashpër këtë lloj të polemikës. Në këtë kontekst, Kur'ani thotë:

"Dhe kapuni për litarin e All-llahut e mos u përçani! Përkujtoni nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranonit Fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit buzë greminës së xhehennemit e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu All-llahu ua sqaron juve argumentet e veta që të gjeni të vërtetën e lumtur".

(Ali Imran, 103).

Gjithashtu Kur'ani tërheq vërejtjen nga përçarja të cilën e përjetuan njerëzit e mëparshëm, për të mos na goditur ajo që i goditi ata:

"E mos u bëni si ata që u përçanë e u ndanë pasi patën zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh".

(Ali Imran, 105).

Në një vend tjetër gjithashtu thuhet:

"Dhe respektone All-llahun e Të dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake). Të jeni të durueshëm se All-llahu është me të durueshmit".

(Enfalë, 46).

Kur'ani i qorton idhujtarët dhe ata që devijuan nga ithtarët e librit, të cilët e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe:

"Vërtet, ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhammed) nuk ke kurrfarë përgjegjësie".

(En'namë, 159).

Në një sure tjetër gjithashtu thuhet:

"Përqëndrohu në vetveten tënde sinqerisht në fenë, i larguar prej çdo kohe, (e ajo fe), feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga All-llahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Përqëndrohuni në atë fe) Të kthyerit sinqerisht tek Ai, kini frikë prej Tij dhe falne namazin e mos u bëni nga idhujtarët të cilët e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ku secili grup i gëzohet idesë së vet".

(Errum, 30-32).

PJESA E DYTË
MBËSHTETJA NË METODËN MESATARE DHE LARGIMI NGA HOLLËSITË E TEPËRTA NË FE

Për t'i bashkuar radhët kemi nevojë për aplikimin e metodës moderniste larg teprimit e ekstremizmit. Ky ummet në përgjithësi është mesatar ashtu siç është edhe feja e Zotit.

Aliu r.a. thotë: "Obligoheni që ta (aplikoni) mesataren".

Pra, mesi është pika qendrore tek e cila kthehen palët e larguara nga e majta dhe e djathta. Në këtë rrugë (siratal mustekim) na udhëzon Zoti i Madhëruar sa herë që e lexojmë suren "Fatiha" gjatë namazeve tona të përditshme ose jashtë tyre:

"Na udhëzo në rrugë të drejtë!"

(Fatiha, 5).

E njëjta gjë thuhet edhe në ajetin:

"Kjo është rruga e Zotit tënd, është e drejtë".

(En'amë, 126).

Përmes porosisë së tillë, Zoti i Madhëruar kërkon prej nesh që të bashkohemi dhe të mos shkojmë rrugës në të cilën ftojnë djajtë e njerëzve dhe exhineve nga Perëndimi e Lindja. Në fund të dhjetë porosive që theksohen në suren *"En'amë"*, Zoti i Madhëruar thotë:

"Dhe se kjo është rruga (feja) ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij".

(En'amë, 153).

Imam Ahmedi transmeton nga Ibën Mes'udi se Pejgamberi a.s. e ka vizatuar me dorë një vijë e pastaj ka thënë: "Kjo është rruga e Zotit, është e drejtë". Pastaj përsëri ka vizatuar në anën e djathtë e të majtë edhe dy vija tjera dhe ka thënë: "Në këto rrugë thërret vetëm djalli (shejtani)".

Pastaj e ka lexuar. "Dhe se kjo është rruga (feja) ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj e mos ndiqni rrugë të tjera..."[50]

Sipas një transmetimi tjetër të Ahmedit e Ibën Maxhes nga Xhabiri, thuhet se Pejgamberi a.s. e ka vënduar dorën në vijën e mesme dhe e ka lexuar ajetin e lartpërmendur.[51]

Në komentimin e ajeteve: "Mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij..." dhe "(Ju porositëm) ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të" (Esh-Shura, 13).

Ibën Kethiri transmeton nga Ibën Abbasi dhe thotë: "Zoti i urdhëron besimtarët të jetojnë në xhemat (bashkësi) dhe ua ndalon përçarjen e copëtimin. Ai gjithashtu i lajmëron se janë shkatërruar ata që janë konfrontuar në fenë e Zotit".[52]

---

[50] Këtë hadith Ahmedi e ka transmetuar në dy vende në *Musnedin* e tij, edhe atë nën numrat 4142 dhe 4437. Sipas Shejh Shakirit, ky hadith ka *"sened sahih"*. Këtë gjithashtu e ka transmetuar Hakimi në *Mustedrek* në dy forma 32/239. Mendimin e Hakimit e ka pranuar Dhehebiu 2/318. Sipas Ibën Kethirit, këtë hadith e ka transmetuar edhe Nesaiu.

[51] Ibën Kethiri, 2/190.

[52] Tefsiri i Ibën Kethirit, 2/190.

SHKATËRRIMI I EKSTREMISTËVE

Kur flitet për metodën mesatare, vlen të theksohet se faktor i rëndësishëm për bashkimin e muslimanëve është edhe largimi nga ekstremizmi në fe. Nga Ibën Mes'udi transmetohet se Pejgamberi a.s. ua ka tërhequr vërejtjen sahabëve në këtë, duke u thënë: "Janë shkatërruar ekstremistët, janë shkatërruar ekstremistët, janë shkatërruar ekstremistët".[53]

Sipas Imam Neveviut, ekstremistë janë ata që e teprojnë dhe që e kapërcejnë kufirin në fjalë e në vepra.[54]

Sipas Ibën Ethirit, termi "Mete'a" nënkupton thellësinë e fytit, ndërsa konkretisht këtu nënkupton thellimin e tepërt në fjalë e në vepra.

Në një transmetim të Ibën Mes'udit, thuhet: "Kini kujdes nga ekstremizmi dhe përçarja..."[55]

Sipas disa të tjerëve, "ekstremizmi" nënkupton teprimin në adhurim ngase kapërcehen kufijtë e rregullave të Sheriatit për shkak të rënies nën ndikimin e nxitjeve të djallit (shejtanit).

Sipas disa të tjerëve, ky term nënkupton thellimin në çështjet të cilat rrallëherë ndodhin, posaçërisht në çështjet që s'përmenden as në Kur'an, as në Sunnet e as në Ixhma (konsensus) e që ndodhin rrallëherë dhe e tërë koha harxhohet në këto çështje e jo në ato që ndodhin shpeshherë.

---

[53] Transmetim i Muslimit në *Sahih - kapitulli i diturisë* nën numrin 2670.
[54] Komentimi i Neveviut mbi Muslimin, 5/525, botim i Shtëpisë botuese *"Esh-sha'b", Kajro.*
[55] *En-nihaje*, 5/74, botimi i Isa El-Halebiut, verifikimi i Tannahit.

Në këtë kontekst, çështja më e vështirë është hulumtimi i gjërave për të cilat Sheriati kërkon vetëm të besohen, si p.sh. Dita e Gjykimit, shpirti, afati i ummetit... Në këtë çështje kërkohet besim pa hulumtim.

Sipas disa të tjerëve, "ektremizmi" nënkupton pyetjet e shumta të cilat pengojnë lejimin dhe shkaktojnë ndalimin,[56] ngase Zoti i Madhëruar i ka dhënë kësaj feje natyrë të lehtë dhe përgëzim e jo të vështirë e dëbim.

Nga Ibën Abbasi transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kini kujdes nga ekstremizmi në fe, ngase janë shkatërruar ata që jetuan para jush nga teprimi në fe".[57]

S'ka dyshim se ekstremizmi dhe teprimi shkaktojnë thellimin në çështjet e vogla e pastaj vijon përçarja, ndërsa toleranca dhe lehtësimi i bashkojnë njerëzit. Fryma e lehtësimit dhe e tolerancës ka ndikuar te sahabët e Pejgamberit a.s. që të mos konfrontohen në çështjet dytësore e të pjesërishme, madje e kanë kritikuar atë që ka punuar të kundërtën ngase në këtë mënyrë pason vetëm vështirësimi i çështjeve.

Në këtë kontekst, Kur'ani tërheq vërejtjen dhe thotë:

"O ju që besuat, mos pyetni për sende që, nëse u thuhet ajo (pyetja) haptazi, ju vjen keq juve, e nëse pyetni për to gjatë kohës kur zbritej Kur'ani, do t'ju dalë në shesh (dhe do ta ngarkoni veten pa nevojë). All-llahu ua fali atë (pyetjet që i bëtë më herët); All-llahu falë shumë, është i butë".

---

[56] Fejdul-kadir, 6/355.

[57] Transmetim i Ahmedit, Nisai'ut, Ibën Maxhes, Hakimit, Ibën Huzejmes dhe Ibën Hibbanit nga Ibën Abbasi. Shiko në *"Sahihul-xhami'is-sagir",* 2680.

(Maide, 101).

Pejgamberi a.s. tërheq vërejtjen nga shtrimi i pyetjeve të shumta të cilat shkaktojnë vështirësi për muslimanët. Në këtë kontekst, ai thotë:

"Gabimi më i madh i muslimanëve është kur ndalohet ndonjë gjë e lejuar për shkak të shtruarjes së pyetjes nga ndonjëri prej tyre".[58]

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë: "Mos më ngarkoni me atë që ua kam lejuar, ngase ata që jetuan para jush u shkatërruan për shkak të pyetjeve të shumta dhe polemikave mbi pejgamberët e tyre. Kur t'ua ndaloj një gjë, largohuni, e kur t'ua lejoj (kur t'a urdhëroj), veproni sipas mundësisë. Kur t'ua ndaloj një gjë, largohuni!"59

Këtu ai i thekson Beni israilët dhe teprimin e tyre me Musain a.s. në çështjen e prerjes së lopës, të cilët, sikur të mos kishin shtruar pyetje të shumta, nuk do të hasnin në vështirësi.

Transmetohet nga Enesi se Pejgamberit a.s. i kanë shtruar pyetje të shumta derisa e kanë tepruar, dhe në atë rast ai është hidhëruar, ka hipur në minber dhe ka thënë: "Nuk do të më pyetni sot për asnjë send pos se do t'u përgjigjem dhe argumentoj!" Enesi thotë se: "Pastaj fillova të shikoj djathtas e majtas dhe pashë se secili e kishte ulur kokën dhe qante...! Në atë rast është ngritur

---

[58] Transmetim i Buhariut në *"I'tisam"* dhe i Muslimit në *"El-Fedail"* nga Sa'd ibën Ebi Vekkasi. Shiko *"El-lu-lu'u vel - merxhan",* hadithi numër 1521.

[59] Transmetim i Ahmedit, i dy shejhëve, i Nesa'iut dhe i Ibën Maxhes nga Ebu Hurejreja. Shiko *"El-lu-lu'u vel-merxhan"* (846) dhe *"Sahihul-xhami's-sagir"* (3430).

Umeri dhe ka thënë: "E kemi pranuar All-llahun si Zot, Islamin si fe dhe Muhammedin si pejgamber. Mbështetemi në mbrojtjen e Zotit nga fitnet".[60]

Ky ishte një mësim i mirë për sahabët ngase prej atëherë filluan të pyesin vetëm për çështjet e nevojshme edhe atë pa e tepruar fare.

Kjo shihet edhe në atë që ka regjistruar Kur'ani nga pyetjet që ata i'a kishin drejtuar të Dërguarit fisnik numri i të cilave nuk e kalon trembëdhjetëshin dhe shumica e tyre kishin të bëjnë me çështje praktike.

Sahabët përgjigjeshin vetëm për atë që i pyetnin, i lehtësonin gjërat e nuk i vështirësonin, i përgëzonin (njerëzit) e nuk i dëbonin. Pra, ata vepronin ashtu siç i kishte urdhëruar Pejgamberi a.s.

Metoda e përgjithshme e sahabëve (r.a.) kishte të bëjë me lehtësimin e gjërave, me tolerancën në çështjet e dorës së dytë, me largimin nga thellimi i tepërt për të mos kaluar prej lehtësimit në vështirësim ngaqë një gjë e tillë është e ndaluar në fenë e Zotit. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"Dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi...".

(El-Haxhxh, 78).

Buhariu transmeton se Jusuf ibën Mahiki ka thënë:

"Isha te nëna e besimtarëve, Aisheja r.a. dhe ja, erdhi një irakian dhe e pyeti: "Cili qefin është më i miri?" Ajo iu përgjigj: "Zoti të mëshiroftë, po çfarë dëmi ke?" Ai përsëri i tha: "Oj nëna e besi-

[60] Transmetim unanim. Shiko në *"El-lu'lu'u vel-merxhan",* (1523).

mtarëve, ma trego mus-hafin tënd!" Ajo e pyeti "Pse?", e ai iu përgjigj: "Ndoshta e sistematizoj Kur'anin sipas tij ngase (i imi) nuk është i sistematizuar!" Ajo i tha: "E çfarë dëmi ke prej atij që e ke lexuar më parë?"[61]

Në veprën "El-Fet-hu", Hafidhi thotë: "Ndoshta ky irakian e ka dëgjuar hadithin "merfu'ë" të transmetuar nga Semra e që thotë: "Vishni teshat tuaja të bardha dhe mbështillni me to të vdekurit tuaj ngaqë janë më të pastra dhe më të mira".

Këtë hadith te Tirmidhiu e gjejmë të vërtetuar "sahih", madje e transmeton edhe nga Ibën Abbasi. Irakiani ndoshta e ka dëgjuar këtë hadith dhe ka dashur ta vërtetojë nga Aisheja r.a. Meqë irakianët në përgjithësi kanë qenë të njohur me pyetjet e tepërta, Aisheja i përgjigjet: "Ç'të dëmton ty", gjegjësisht lejohet çfarëdo lloj qefini.

Poashtu e njohur është edhe thënja e Ibën Umerit në rastin e mushkonjës është e njohur. Në këtë rast ai thotë: "Shikoni irakianët, pyesin për gjakun e mushkonjës, e e kanë vrarë djalin e të bijës së Pejgamberit a.s.".[62]

Sa i përket kërkesës së tij që Nëna e Besimtarëve t'ia japë mus'hafin për ta sistematizuar mus'hafin e vet sipas tij, siç duket, vërehet qartë se mus'hafi i tij nuk ka qenë i sistematizuar si ai i

[61] Transmetim i Buhariut në librin mbi vlerat e Kur'anit, kapitulli *"Te'lifyl-Kur'an"* (4933) dhe *"El-Fet-hu"*, 9/38,39, botim i Darul-fikri.

[62] Fet-hul-bari, 9/39.

Uthmanit por ndoshta sipas Ibën Mes'udit. Aisheja nuk ka vërejtur ndonjë rrezik të madh nga mus'hafi i tij dhe për këtë shkak i ka thënë: "E ç'dëm ke nga leximi i mëparshëm?"[63]

Dijetari Dehlevi e përshkruan gjendjen e tolerancës dhe lehtësimit gjatë kohës së Pejgamberit dhe sahabëve në librin e tij "Huxh-xhetull-llahi el-baliga". Ai tregon se të kuptuarit e fesë ka qenë shumë i lehtë dhe larg thellimeve të tepërta, të ndërlikuara e ekstreme, edhe atë ndryshe nga kohët e mëvonshme. Në këtë kontekst, ai thotë: "Kur merrte abdest Pejgamberi a.s. edhe sahabët merrnin sikur ai pa u thelluar në hollësi, falnin namazin ashtu siç e falte Ai (a.s.) dhe e bënin haxhxhin ashtu siç e bënte Ai (a.s.). Ai nuk tregonte se farzet e abdestit janë katër apo gjashtë... Sahabët shumë pak e pyetnin për gjëra të tilla.

Nga Ibën Abbasi (r.a.) transmetohet se ka thënë: "Nuk kam parë njerëz më të mirë se sahabët e Pejgamberit a.s. Ata e kanë pyetur vetëm për 13 çështje të cilat gjenden në Kur'an, si p.sh. për luftën në Muajin e shenjtë, për të përmuajshmet te gratë etj. Ata pyetnin vetëm për çështjet që ishin në dobi të tyre.

Ibën Umeri thotë: "Mos pyet për atë që s'ka ndodhur sepse e kam dëgjuar Umer ibën Hattabin duke e mallkuar atë që pyet për atë që s'ka ndodhur".

Kasimi ka thënë: "Ju pyetni për gjërat për të cilat ne nuk i pyetnim dhe thelloheni në gjërat në të cilat ne nuk thelloheshim. Pyetni për gjërat të cilat ne nuk i dimë çfarë janë ato, e sikur t'i dinim nuk do t'i fshehnim".

---

[63] *Po aty*, 9/40.

Transmetohet se Umer ibën Is-haku ka thënë: "Numri i sahabëve të Pejgamberit a.s. të cilët i arrita është më i madh se ata të cilët kanë kaluar, dhe nuk pashë njerëz të cilët kishin qëndrime më tolerante dhe më të lehta se ata".

Transmetohet se kur është pyetur Ubbade ibën Jusër El-Kindi për një grua e cila ka vdekur në mesin e njerëzve ku nuk ka qenë përkujdesësi i saj, është përgjigjur. "Kam jetuar me njerëz që nuk ishin aq të rreptë sa ju e as që pyetnin për atë që pyetni ju".

Thëniet e tilla i transmeton Darimiu.[64]

PJESA E TRETË
MBËSHTETJA NË ÇËSHTJET E QARTA E JO NË TË DYSHIMTAT

Faktori i cili mbron bashkësinë e unitetin dhe eliminon përçarjen e shkapërderdhjen është të mbështeturit në çështjet e qarta dhe të larguarit nga ato të dyshimtat. Sipas Kur'anit, çështjet e qarta janë më të shumta dhe njëherit konsiderohen bazë e Librit (Kur'anit).

Dijetarët mbështeten në çështjet e qarta kurse ata që anojnë nga e shtrembëta, mbështeten në të paqartat.

Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

[64] Huxhxhetull-llah el-baliga, 1/140,141.

"Ai është që ta zbriti Librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjera që nuk janë krejtësisht të qarta (muteshabih). E ata që në zemrat e tyre kanë anim nga e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar huti e kinse kërkojnë komentin e tyre.Po, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thanë: "Ne i kemi besuar atij (atyre që janë të paqarta), të gjitha janë nga Zoti ynë! Por, këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes".

(Ali Imran, 7).

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Aisheja r.a. se kur e ka lexuar Pejgamberi a.s. këtë ajet, ka thënë: "Kur t'i shihni ata që mbështeten në ato të dyshimtat (përkujtoni), se ata janë ata të cilët i përmend All-llahu (Kur'ani), pra kini kujdes prej tyre!"[65]

Në qoftë se largoheni nga të qartat, atëherë hapen dyert e armiqësisë dhe të konfrontimeve, posaçërisht kur bisedohet për çështjet precize të cilat gjithmonë kanë qenë problematike, gjegjësisht si më parë ashtu edhe sot.

Pejgamberi a.s. pastaj i kritikon edhe më ashpër ata të cilët në rastet e paqarta nuk mbështeten në të qartat.

Transmetohet se Abdullah Ibën Umeri ka thënë: "Del Pejgamberi a.s. te sahabët e tij dhe kur vëren se polemizojnë rreth kaderit (determinizmit dhe indeterminizmit), hidhërohet aq shumë saqë

[65] El-lu'lu'u vel-merxhan, hadithi,1705.

ju thotë: "A për këtë jeni të urdhëruar? A për këtë jeni krijuar? Për këtë janë shkatërruar popujt para jush".[66]

Nga ky transmetim kuptohet se Pejgamberi a.s. është hidhëruar aq shumë saqë edhe fytyra e tij është skuqur. Pejgamberi a.s. ua ka bërë me dije që të mos humbin kohën e tyre në këtë problematikë të pafund e jo frytdhënëse, ngase Zoti nuk i ka krijuar për këtë gjë e as që i ka urdhëruar të merren me një problematikë të tillë, por i ka krijuar ata dhe tërë botën që t'i sprovojë se kush do të punojë vepra më të mira. Zoti i Madhëruar e ka shpallur Kur'anin ashtu që çdo pjesë e tij plotëson dhe sqaron pjesën tjetër e jo për të shkaktuar kundërthënie:

"Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie".
(Nisaë, 82).

Si zakonisht, ndodh që mbështetësit në të paqartat të mos kërkojnë zbërthimin nga të qartat. Sikur të ishin të sinqertë, nuk do të shkaktohej grindje.

Pra, kështu ndodhi me sahabët të cilët zhvillonin polemikë rreth një çështjeje shumë enigmatike e precize, gjegjësisht rreth kaderit.

---

[66] Transmetim i Ibën Maxhes në hyrjen e kapitullit mbi kaderin, hadithi 85. Sipas verifikimit të librit *"Zevaid"*, ky hadith është sahih, transmetohet nga njerëzit e besueshëm dhe gjendet edhe në Musnedin e Ahmedit (6741).

PJESA E KATËRT
LARGIMI NGA QËNDRIMET KATEGORIKE NË ÇËSHTJET E IXHTIHADIT

Radhët e muslimanëve gjithashtu mund të bashkohen në qoftë se largohen nga qëndrimet kategorike në çështjet e ixhtihadit, të cilat ngërthejnë në vete më shumë se një domethënie. Për këtë shkak, dijetarët tanë kanë vendosur se s'ka qëndrim kategorik në çështjet e ixhtihadit.

Kur është pyetur shejhul islami, Ibën Tejmijje, për ata që i imitojnë disa dijetarë në çështjet e ixhtihadit, gjegjësisht për atë se a t'i kundërshtojnë apo t'i braktisin, ai përgjigjet: "I falënderohem Zotit! Kush vepron sipas mendimeve të disa dijetarëve në çështjet e ixhtihadit, nuk kundërshtohet e as nuk braktiset. Në qoftë se zgjedh njërin nga dy mendimet, nuk kundërshtohet.

Në qoftë se njeriu ballafaqohet me dy mendime, pranon njërin mendim nga i cili anon ose pranon mendimin të cilin e jepnin disa dijetarë. Zoti është më i dituri!"[67]

Në një vend tjetër është pyetur për një çështje të cilën e refuzon Shafiu ndërsa e pranojnë tre imamët tjerë, gjegjësisht për ndalimin apo lejimin e njerëzve në aplikimin e saj, me ç'rast ai përgjigjet se nuk duhet penguar njerëzit.

[67] Mexhmu'ul - fetava, 20/207.

Gjithashtu edhe udhëheqësi nuk duhet ta refuzojë vendimin e tjetrit në çështje të tilla, ashtu siç nuk i lejohet dijetarit apo muftiut t'i obligojnë të tjerët që t'i imitojnë në çështjet e tilla.

Kur e ka pyetur (Harun) Rashidi, Malikin për t'i obliguar njerëzit në aplikimin e librit të tij "Muvat-ta", Maliki e ka refuzuar kërkesën e tij duke i thënë: "Sahabët e Pejgamberit a.s. janë shpërndarë në vende të ndryshme dhe secili popull ka marrë atë dituri që e ka pranuar prej tyre".

Një njeri e ka përpiluar një libër me titull "Libri i dallimeve në mendime", e Ahmedi i ka thënë: "Mos e titullo ashtu por titulloje "Libri i Sunnetit".

Për këtë shkak, disa dijetarë thonin: "Ixhmai (konsensusi) i tyre është argument kategorik kurse divergjenca e tyre është mëshirë e gjerë".

Umer ibën Adbulazizi thoshte: "Më gëzon fakti se sahabët e Pejgamberit të Zotit nuk përçaheshin ngase secili që largohej nga mendimi unanim i tyre, humbej. Ekzistimi i mendimeve të ndryshme në mesin e tyre konsiderohej mëshirë".

Përveç Malikut, imamët tjerë thoshin: "Nuk i lejohet fakihit (juristit musliman) që t'i detyrojë njerëzit në medhhebin e tij".

Sipas ithtarëve të Shafiut dhe të tjerëve, këto çështje të ixhtihadit nuk obligohen me dorë (me forcë), ngase askujt nuk i lejohet t'i detyrojë të tjerët që ta ndjekin. Këtu merret parasysh fjala e argumentit dhe ai që bindet në njërin mendim, e pranon, e ai që pranon mendimin tjetër, nuk duhet të sulmohet.

Këtë natyrë e kanë shumë çështje, e disa prej tyre i theksuam më parë, si p.sh. disa çështje rreth abdestit, leximit të bismilahit me zë apo pa zë, tejemmumit, pranimit të dëshmisë së rezidentëve jomuslimanë etj.[68]

Në vazhdim vijon qëndrimi i sahabëve ndaj çështjeve të tilla të ixhtihadit.

Transmetohet se Umeri r.a. një herë e ka ndaluar ndarjen e barabartë të trashëgimisë midis vëllezërve të vërtetë dhe vëllezërve nga nëna, e herën tjetër e ka lejuar. Kur e kanë kritikuar se më parë e ka ndaluar, është përgjigjur: "Ashtu kemi gjykuar atëherë, e sot gjykojmë kështu."

Kur e komenton Ibën Kajjimi fjalën e Umerit në letrën dërguar Ebu Musa Esh'ariut, thotë: "Mos të të pengojë gjykimi i sotëm, në të cilin e korrigjon mendimin tënd. Në qoftë se je i udhëzuar, trego të vërtetën ngase e vërteta është e përhershme dhe s'mund ta prishë asgjë. Korrigjimi për të vërtetën është më i mirë se të thelluarit në gabim".[69]

Transmetohet se Umeri e ka takuar një njeri dhe e ka pyetur: "Ç'bëre me çështjen tënde?" Kur i përgjigjet se Aliu dhe Zejdi kanë vendosur kështu, Umeri i thotë: "Sikur të isha unë, do të vendossha ndryshe!" Kur e pyeti pse nuk vepron ashtu siç mendon, Umeri i përgjigjet: "Sikur të bëhej fjalë për Librin e Zotit dhe për Sunnetin e Pejgamberit të Tij do të veproja kështu, mirëpo çështja ka të bëjë me mendimin e lirë, e mendimi i lirë është i përbashkët".[70]

---

[68] Mexhmu'ul - fetava, Ibën Tejmijje, 30/79-81.
[69] I'ëlamul - muweki'inë, 3/99 - 130.
[70] *Po aty*, 1/74.

PJESA E PESTË
NJOHURITË E OBLIGUESHME MBI MENDIMET E NDRYSHME TË DIJETARËVE

Ajo që ndihmon tolerancën dhe zemërgjerësinë është njohuria mbi mendimet e ndryshme të dijetarëve, mbi medhhebet e ndryshme ngase secili mbështetet në argumentet specifike të cilat i nxjerrin nga deti i Sheriatit. Për këtë shkak, sipas dijetarëve tanë, njohuria mbi mendimet e ndryshme të fukahave (juristëve muslimanë) dhe mbi mendimet e tyre kompakte konsiderohet e obligueshme ngase divergjenca e tyre në mendime është mëshirë ndërsa kompaktësia e tyre, argument.

Nisur nga ky fakt, thuhet se ai që nuk i njeh mendimet e ndryshme të dijetarëve nuk mund të konsiderohet dijetar, kurse ai që nuk i njeh mendimet e ndryshme të fukahave (juristëve muslimanë), nuk mund ta shijojë shijen e Fikhut (jurisprudencës islame).

Shumica e njerëzve njohin vetëm një mendim e një ide, kanë mësuar nga një shejh (alim) ose janë përfshirë në një shkollë dhe kështu nuk kanë patur mundësi të dëgjojnë mendime të tjera, të diskutojnë për qëndrime tjera apo të fitojnë njohuri për mendimet e shkollave tjera.

Është për t'u habitur nga fakti se ata që i imitojnë disa dijetarë bashkëkohorë refuzojnë imitimin e dijetarëve të vjetër dhe kështu, në realitet, ata vetë janë imitatorë. Edhe pse i mohojnë

medhhebet, në thelb, ata vetë kanë formuar medhheb të pestë, i refuzojnë mendimet tjera dhe i mohojnë mendimet e atyre që mendojnë ndryshe.

Edhe pse i mohojnë diskutimet dhe polemikat klasike apologjetike, në thelb ata vetë kanë formuar apologjetikë të re, e cila s'ka të bëjë me besimin në zemër por me dashurinë ndaj diskutimeve boshe rreth çështjeve të besimit. Këta u ngjajnë atyre që janë të verbër e që shohin vetëm atë që e prekin me dorë.

Sikur ta zgjeronin edhe më tepër horizontin e tyre, do të binden se realiteti është krejtësisht ndryshe dhe se mendimet e ndryshme mund të përjetojnë kohë kooperuese. Pa marrë parasysh konfliktet ndërmjet mendimeve, me rëndësi është të mbizotërojnë drejtësia, largimi nga fanatizmi, të dëgjuarit e të tjerëve të cilët mund të kenë fjalë më të sakta dhe kuptim më të përpiktë. Të shumtë janë studiuesit të cilët janë larguar nga mendimet e veta kur kanë dëgjuar mendime tjera nga dijetarë tjerë të njohur. Merr si shembull konkret çështjen e hedhjes së guralecave në haxhxh, për të cilën disa kanë thënë se ai që hedh para perëndimit të diellit, nuk bën haxhxh ngase e kundërshton Sunnetin.

Xhabiri thotë se Pejgamberi a.s. ka gjuajtur në Ditën e kurbanit në mëngjes, kurse herën tjetër pas perëndimit të diellit.[71]

---

[71] Buhariu e transmeton në kapitullin *"Remjul-xhimar"* të librit *"El-haxhxhu",* kurse Muslimi, Ibën Huzejme dhe Ibën Hibbani nga Ibën Xhurejxhi! (*El-Fet-hu*, 3/579).

Vebereja transmeton se e ka pyetur Ibën Umerin r.a. për kohën e gjuajtjes së guralecave, e ai i ka thënë: "Kur të gjuajë udhëheqësi yt, gjuaj!" Kur ia përsërita pyetjen ai tha se përpara kishim kohë të caktuar, gjegjësisht gjuanim kur perëndonte dielli".[72]

Ata'i dhe Tavusi e kundërshtojnë duke thënë se lejohet absolutisht edhe para perëndimit, kurse hanefitët bëjnë lehtësim në gjuajtjen para perëndimit vetëm në ditën e prerjes, gjegjësisht në ditën e zbritjes në Mine. Kështu është transmetuar edhe nga Is-haku.[73]

Rreth kësaj çështjeje, shejhu Abdullah ibën Zejd El-Mahmudi është konfrontuar me dijetarët e Rijadit më shumë se 30 vjet, madje ka shkruar edhe një broshurë me titull *"Jusrul-islam",* të cilën e kanë kritikuar shumë dijetarë.

Nga përgjigjja e Ibën Umerit vërehet lehtësimi në këtë çështje dhe se mjafton për muslimanin që ta përcjell udhëheqësin e haxhilerëve.

Fukahatë kanë mendime të ndryshme në vetë parimin e gjuajtjes. Sipas *"xhumhurit"*, gjuajtja është *"vaxhib"* kurse braktisja kompensohet me gjak (kurban). Sipas malikitëve, kjo është sunnet i fortë. Në mesin e tyre kalkulon thënia: "Gjuajtja e guralecave në Akabe është kusht pa të cilin nuk ka haxhxh, ndërsa sipas disa të tjerëve gjuajtja është e obliguar për ta mbrojtur tekbirin, e ai që e lë, bën tekbir". Këtë e rrëfen Ibën Xheriri nga Aisheja dhe të tjerët.[74]

---

[72] Te Buhariu nën numër 746.
[73] *Ek-Fet-hu*, 3/580.
[74] *Po aty*, 3/579.

Disa vëllezër thonë se mendimi i një dijetari apo i dy dijetarëve që nuk përputhet me xhumhurin e ummetit, nuk duhet të pranohet.

Disa të tjerë thonë se mendimi që nuk përputhet me katër medhhebet të cilat i ka pranuar ummeti, duhet të refuzohet dhe të mos pranohet.

Realisht thënë, e gjithë kjo s'ka kurrfarë mbështetje në Kur'an apo në Sunnet.

Ixhma'i (konsensusi), i cili është argument, nënkupton kompaktësinë e të gjithë muxhtehidëve rreth ndonjë çështjeje të Sheriatit, e askush nuk ka thënë se nënkupton kompaktësinë e shumicës apo të *"xhumhurit"*. Kjo çështje nuk ka të bëjë me numrin e votave. Është e vërtetë se mendimi i xhumhurit ka peshë mbi mendimet tjera, por në asnjë mënyrë nuk nënkupton se është i mbrojtur. Sa sahabë ka që janë vetmuar në mendim (qëndrim) të cilin e kanë kundërshtuar të gjithë të tjerët dhe kjo fare nuk e ka dëmtuar atë!!!

Sa fukaha tabi'inë kanë menduar ndryshe nga të tjerët!

Çështja ka të bëjë me argumentin e jo me shumicën!

E njëjta gjë ndodhi edhe me katër imamët e njohur...

Medhhebi i Amed ibën Hanbelit, i cili është i njohur me mbështetjen në traditë, njihet me mendime të posaçme të cilat lexuesi shpeshherë i lexon me maksimën "Ky është mendim nga mendimet e posaçme të medhhebit".

Katër medhhebet nuk konsiderohen argument në fenë e Zotit por argument që mbështetet në faktet tradicionale apo racionale të Sheriatit.

Për atë që thuhet se disa mendime janë të posaçme, të braktisura apo të dobëta, ato nuk mund të kenë statusin kategorik e të përgjithshëm ngase shumë mendime të braktisura janë shndërruar në aktive dhe se shumë fjalë të dobëta, me paraqitjen e argumenteve të mëvonshme kanë përfituar status tjetër, madje edhe janë shndërruar në shtylla të fetvave.

Këtu mjafton t'i theksojmë mendimet e shejhul-islamit, Ibën Tejmijje, i cili përjetoi atë që përjetoi, por pas shumë shekujsh nga vdekja e tij, sot konsiderohen si ide që mund t'i shpëtojnë muslimanët nga shkatërrimi e zhdukja.

Ekzistojnë *"neodhahiritët"* (neoekzoteristët), të cilët mendojnë se mund ta anulojnë dallimin në çështjet sheriative ixhtihadore parësore apo dytësore, duke i bashkuar njerëzit në atë që mendojnë se është e vërtetë dhe e saktë dhe duke i refuzuar mendimet tjera.

Këta harrojnë se mahnitja me vetveten konsiderohet si njëri ndër faktorët e shkatërrimit. Gjëja më e keqe e njeriut është që ta nënçmojë vëllain e vet musliman duke ia nënçmuar mendimin.

Turp është për neodhahiritët të mendojnë se ata e mbrojnë Hadithin pejgamberik, duke u nisur nga deklarata e tyre se ai që i kundërshton ata, e kundërshton Hadithin.

Këta gabojnë për shkaqe të shumta:

1. Ata mbështeten në korrigjimin e Hadithit duke i imituar disa dijetarë të mëparshëm ose bash-këkohorë që punojnë në lëmin e Hadithit, kurse disa të tjerë i refuzojnë, e kjo çështje është e njohur në mesin e dijetarëve të njohur klasikë të ummetit dhe të fukahave të selefit. Njëri e korrigjon kurse tjetri e thumbon dhe e bën të dobët, ngase pranon kushte që nuk pranohen tek të

tjerët. Duke u mbështetur në kriteriume të ndryshme në lëmin e Hadithit, disa pranojnë ndonjë transmetim e disa jo.

2. Ndonjëri e përforcon Hadithin përmes mënyrave të ndryshme të dobëta me të cilat transmetohet, ndërsa të tjerët nuk e pranojnë.

3. Disa e pranojnë argumentimin me kategorinë *"mursel"* kurse disa të tjerë, jo...

Shikoi hadithet që kanë të bëjnë me ndalimin e arit për gratë. Disa dijetarë i pranojnë si të sakta e disa jo, edhe pse ixhmai i ummetit ka qëndrim unanim për lejimin e arit për gratë.

4. Disa e refuzojnë autenticitetin e Hadithit që e pranojnë ata duke u nisur nga ajo se Hadithi nuk ka të bëjë me çështjet e Sheriatit por me çështjet e kësaj bote, si p.sh., bartja e shkopit në hytbe apo ngrënia me dorë ose në tokë. Në një hadith Pejgamberi a.s. thotë: "Porositeni që ta përdorni antimonin ngase e pastron syrin...", e në qoftë se muslimani nuk vepron sipas këtij urdhri por sipas porosisë së mjekut specialist, atëherë ai nuk e kundërshton hadithin.

Kjo i ngjason edhe asaj që përmendet në hadithin e Pejgamberit: "Porositeni ta përdorni qumështin e lopëve ngase qumështi i tyre është ilaq (bari) e mishi i tyre është sëmundje". Mirëpo kontrolli ushqimor, shëndetësor dhe mjekësor ka vërtetuar se s'ka gjë të keqe në mishin e lopëve, përkundrazi është më i dobishëm se mishi i deveve dhe i deles, atëherë ai që e han mishin e lopëve në bazë të një analize të tillë nuk e refuzon hadithin e as s'e braktisë Sunnetin.

5. Ndonjëherë hadithi ka të bëjë me ndonjë çështje të Sheriatit që është e përgjithshme dhe e përhershme por dallimi i mendimeve shkaktohet në hukmin e tij, si p.sh. hadithi që ka të bëjë me ur-

dhëresë apo ndalesë, gjegjësisht a ka të bëjë çështja me vaxhib (obligim) apo me preferim apo me udhëzim? Ndalohet për shkak se është haram apo e urrejtur?

Të gjitha këto supozime janë fjalë dhe mendime të dijetarëve të Usuli-fikhut (shkenca mbi bazat e jurisprudencës islame, M.M) mbi lejimin e ndalimin dhe se çdo dijetar mbështetet në argumentet e veta.

Si në argumentin e urdhërimit ashtu edhe në atë të ndalimit ekzistojnë shtatë thënje që i kanë përmendur usulijjunët.

Pamë se sahabët kanë dëgjuar urdhëra nga Pejgamberi a.s. por gjithashtu kanë bërë edhe lehtësim nga bindja se nuk kanë qenë kategorike. Ata menjëherë i aplikonin hadithet që kishin domethënie kategorike.

Sahabët e agjëronin Ramazanin gjatë një udhëtimi për në luftë. Kur i urdhëroi Pejgamberi a.s. që ta prishin agjërimin, disa e prishën e disa e vazhduan, duke u nisur nga komenti se obligimi i tillë nuk ka patur karakter kategorik mirëpo kur afrohen afër armikut, i urdhëron edhe ata që ta prishin agjërimin. Kur ka qenë urdhëri kategorik, ata e kanë respektuar.

Në hadithin: "Hebrenjtë dhe të krishterët nuk ngjyrosen, pra, dallohuni prej tyre dhe ngjyrosuni", nënkuptohet se ka të bëjë me udhëzim ose preferim dhe për këtë disa e kanë praktikuar e disa jo, apo disa kanë përdorë kanë e disa ngjyrë të zezë.

Edhe pse në hadithin e Pejgamberit a.s. thuhet:

"Mos e emërto fëmijën tënd me emrin Nafi, Jesar apo Rebah...", ku përsëri vërejmë se janë emërtuar me emra të tillë, si p.sh. tabi'inët Nafi Meula ibën Umer, Sulejman ibën Jesar, Ata ibën Rebah etj...

Kështu vërejmë edhe Ibën Tejmijjen, i cili hadithin e Pejgamberit a.s. "Ai që prek organin gjenital, le të marrë abdest", e konsideron si hadith që ka të bëjë me preferimin.

Ibën Tejmijje gjithashtu mendon se abdesti (përtrirja e tij) i ngrënësit të mishit të deves është i preferuar e jo i obligueshëm (vaxhib).

Në të dy çështjet e theksuara, Ibën Tejmijje kundërshton medhhebin e imamit të tij, Ahmedit..

PJESA E GJASHTË
PËRKUFIZIMI I KONCEPTEVE DHE TERMINOLOGJISË

Gjithashtu si faktor i rëndësishëm për bashkimin e muslimanëve konsiderohet edhe përkufizimi i koncepteve diskutabile, me qëllim që të saktësohen, të qartësohen dhe të anulohen paqartësia e dyshimi.

Shpeshherë konflikti fillon nga një koncept apo term dhe sikur të mbizotërojë ndonjë koment apo sqarim i qartë, atëherë do të pranohej mesatarja. Në mesin e dijetarëve apo të dy grupeve

shpeshherë lindte ndonjë konflikt gjatë zhvillimit të polemikave e diskutimeve, mirëpo më vonë vërehej qartë se dallimi ka qenë vetëm gjuhësor e terminologjik pa kurrfarë fryti nga aspekti praktik.

Edhe harixhitët, të cilët i akuzonin muslimanët për kufër dhe lejonin vrasjen e atyre që nuk i pranonin mendimet e tyre, kishin rënë në kurth të tillë ngase nuk kishin definicione të qarta për konceptet dhe termat e shumta të tyre, të cilat keqkomentoheshin. Në raste të tilla, ata jepnin komente të lira larg asaj që dëshironte Zoti i Madhëruar në ajetet kur'anore, dhe kështu, jo vetëm që humbën vetë por i humbën edhe të tjerët.

Si shembull konkret mund t'i përmendim konceptet e imanit, kufrit, idhujtarisë, dyfytyrësisë, injorancës... Këta nuk i kanë marrë parasysh kuptimet konkrete dhe ato alegorike të cilat i përmend Zoti i Madhëruar.

Në Kur'an dhe në Sunnet shpeshherë termi "iman" nënkupton besimin e përkryer e jo besimin e plotë pa të cilin dilet në kufër. Kjo gjë është e qartë në ajetet e Kur'anit famëlart dhe në hadithet praktike autentike:

Zoti i Madhëruar thotë:

"E besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre.Dhe të cilët falin (rregullisht) namazin dhe nga ajo, me çka Ne i furnizuam, ata japin.Të tillët janë besimtarë të vërtetë dhe për këtë kanë vende të larta te Zoti i tyre, kanë "falje dhe kanë furnizim në mënyrë të ndershme".

(Enfalë, 2-4).

Këtu flitet për besimtarët që kanë iman (besim) të përkryer dhe nuk nënkuptohet se ai që nuk i rrënqethet zemra nga dhikri i Zotit apo nuk mbështetet në Zotin, konsiderohet pabesimtar dhe jashtë imanit.

Kështu është edhe me ajetin e Kur'anit.

"Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët:Ata të cilët janë të përulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit,Dhe ata të cilët i shmangen të kotës (fjalë a punë),Dhe ata të cilët rregullisht e japin zeqatin,Dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime), Me përjashtim ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre (robëreshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuar,E kush kërkon përtej tyre (dëfrim nga të ndaluarat), të tillët janë ata që i kanë shkelë normat e caktuara,Dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë,Dhe ata të cilët i kushtojnë kujdes kohës së namazit të tyre,Të tillët janë pikërisht ata trashëgimtarët,Të cilët e trashëgojnë Firdeusin dhe aty ata janë përgjithmonë".

(Mu'minunë, 1-11).

Këtu nënkuptohen besimtarët që kanë besim të përkryer dhe nuk nënkuptohet se ai që nuk ka frikë në namaz konsiderohet kafir, pabesimtar por besimtar me iman (besim) të mangët.

Është e qartë se vetëm një mëkat nuk e largon imanin nga zemra, ngase dashuria ndaj Zotit dhe Pejgamberit të Tij ende ekziston në të. Hadithet që flasin për një gjë të tillë janë të shumta si p.sh.

"Nuk beson ndokush prej jush përderisa nuk e dëshiron për vëllain e vet atë që e dëshiron për vete".[75]

"Pasha Atë që ka në dorë shpirtin tim, nuk do të hyni në xhennet derisa nuk besoni dhe nuk do të besoni derisa nuk e duani njëri-tjetrin."[76]

"Pasha Zotin nuk beson, pasha Zotin nuk beson, pasha Zotin nuk beson ai që nuk i siguron fqiut ushqim".[77]

"Nuk beson në Mua ai që fle i ngopur ndërkaq di se fqiu i afërt i tij është i uritur".[78]

Në kornizë të kësaj hyn edhe "shirku" (idhujtaria), i cili ndahet në dy lloje:

1. Shirku i madh që nënkupton shoqërimin e All-llahut me ndonjë zot tjetër, si p.sh. në ajetin kur'anor thuhet:

"S'ka dyshim se All-llahu nuk falë (mëkatin) t'i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujtdo. Kush i përshkruan All-llahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh".

(Nisaë, 48).

---

[75] Transmetim unanim nga Enesi i cili transmeton nga Ebu Hurejreja.
[76] Muslimi e transmeton nga Ebu Hurejreja.
[77] Transmetim i Buhariut.
[78] Transmetim i Bezzarit dhe i Taberaniut nga Enesi si dhe në "Sahihul-xhami'is-sugir".

"Është e vërtetë se All-llahu nuk falë (mëkatin) t'i bëhet Atij shok, e pos këtij (mëkati), të tjerat i falë atij që dëshiron. Ai që i përshkruan shok All-llahut, ai ka humbur dhe ka bërë një largim të madh (prej të vërtetës)".

(Nisaë, 116).

Këtu vërehet qartë se flitet për idhujtarinë e dukshme, konkrete e të vërtetë.

2.Shirku i vogël që nënkupton disa mëkate të cilat kundërshtojnë monoteizmin e plotë. Këtë e vërejmë qartë në disa hadithe të Pejgamberit a.s.:

"Ai që betohet në diçka tjetër përveç Zotit, bën shirk".[79]

"Ai që mban hajmali, bën shirk".[80]

Kështu qëndron edhe kufri: kemi kufër të madh, qoftë thelbësor apo aksidental. Kufër thelbësor bëjnë ateistët dhe natyralistët që mohojnë ekzistimin e Zotit të Madhëruar, ata të cilët e pranojnë Islamin por jo edhe pejgamberllëkun e mesazhin hyjnor dhe ata të cilët besojnë në disa pejgamberë e në disa jo.

Në këtë kontekst, në Kur'anin famëlart thuhet:

"Kush nuk i beson All-llahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg".

(Nisaë, 136).

---

[79] Transmetim i Ahmedit, Tirmidhiut, i Hakimit nga Ibën Umeri si dhe në *"Sahihul-xhami-'is-sagir"*.
[80] Transmetim i Ahmedit dhe i Hakimit nga Ukbe ibën Amir. Burimi i njëjtë.

"S'ka dyshim se ata që nuk besojnë All-llahun dhe Të dërguarin e Tij, dëshirojnë të bëjnë dallim midis All-llahut dhe të dërguarve të Tij e thonë: "Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë", e mes këtij duan të marrin një rrugë.Të tillët janë jobesimtarët e vërtetë; e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët".

(Nisaë, 150-151).

"Bënë kufër (mohuan të vërtetën) ata që thanë: "All-llah është ai, Mesihu, bir i Merjemes". E vetë Mesihu (Isai) tha: "O Beni israilë, adhurone All-llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, All-llahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij xhennetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës".

Gjithashtu bënë kufër ata që thanë: "All-llahu është i treti i treve". S'ka në gjithësi tjetër pos një All-llah, e nëse nuk pushojnë nga ajo që thanë (tre zotëra), do t'i kapë dënim i dhembshëm ata që nuk besuan prej tyre".

(Maide, 72-73).

Kufër aksidental është ai i murtedëve (apostatëve) të cilët dalin tërësisht nga Islami dhe veprojnë plotësisht në kundërshtim me parimet e tij. Për ata thuhet: "E kanë ndërruar fenë e tyre".

Kufri i vogël për të cilin thuhet: "kufër që i ngjason kufrit", nënkupton mëkatarin që mund të bëjë kufër. Ky lloj është alegorik, si p.sh. "Mëkatari është afër kufrit apo u ngjason veprave të pabesimtarëve... Këtu nënkuptohet mohimi i të mirave.

Në këtë kontekst, në Kur'an thuhet:

"E kush nuk gjykon me atë që zbriti, ata janë mohues".

(Maide, 44).

Në hadithet e Pejgamberit a.s. thuhet:

"Sharja e muslimanit është mëkat kurse të luftuarit kundër tij është kufër".[81]

"Pas meje mos u shndërroni në pabesimtarë e të vritni njëri - tjetrin!"[82]

"Mes njeriut dhe mes shirkut e kufrit është lënia e namazit".[83]

"Dallimi midis nesh dhe atyre është namazi dhe ai që e lë (namazin), bën kufër".[84]

"Mos i refuzoni etërit tuaj, e ai që refuzon të jatin e vet, bën kufër".[85]

Kjo që u tha për kufrin mund të thuhet edhe për dyfytyrësinë, e cila gjithashtu ndahet në dy lloje: dyfytyrësia e madhe që ka të bëjë me besimin dhe dyfytyrësia e vogël që ka të bëjë me veprat.

Dyfytyrësia në besim nënkupton deklarimin e besimit me gojë dhe me disa vepra praktike, ndërsa në brendi fshihet pabesimi në Zot dhe në Të dërguarin e Tij.

Në suren "El-Bekare" thuhet:

---

[81] Transmetim unanim nga Ibën Mes'udi.
[82] Transmetim unanim nga Ibën Umeri dhe Xheriri.
[83] E transmeton Muslimi në *"Kitabul-iman"* nga Xhabir ibën Abdullahi.
[84] Transmetim i Ahmedit, Tirmidhiut, Nesaiut, Ibën Hibbanit dhe Hakimit nga Burejdeja.
[85] Transmetim unanim nga Ebu Hurejreja.

"Ka disa njerëz që thonë: "Ne i kemi besuar All-llahut dhe jetës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë.Ata përpiqen ta mashtrojnë All-llahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë".

(Bekare, 8-9).

Në fillim të sures *"Munafikunë"* thuhet:

"Kur të erdhën ty hipokritët, të thanë: "Ne dëshmojmë se vërtet ti je I dërguari i All-llahut! (E, All-llahu e di se ti je I dërguar i Tij, por All-llahu dëshmon se hipokritët janë gënjeshtarë (kur thonë ashtu). Ata betimin e tyre e bëjnë për t'u mbrojtur, andaj ata penguan nga rruga e All-llahut. Veprimi që bënë ata është shumë i keq,Ngase ata besuan (me gojë) e pastaj mohuan, andaj zemrat e tyre u mbyllën dhe ata nuk kuptojnë".

(El-Munafikunë, 1-3).

Për njerëzit e tillë Zoti premton dënim shumë të ashpër:

"S'ka dyshim, munafikët do të jenë në shtresën më të ulët (në fund) të zjarrit dhe për ta nuk do të gjeshë mbrojtës".

(Nisaë, 145).

Dyfytyrësia në vepra nënkupton sjelljen praktike të hipokritëve por në zemër besohet në Zotin, në Pejgamberin e Tij dhe në botën tjetër. Rreth kësaj çështjeje ka shumë hadithe autentike, si p.sh.

"Shenjat e hipokritit janë tri: kur flet, gënjen; kur premton, nuk realizon, kur i besohet diçka, tradhton".[86]

Kështu nënkuptohet edhe koncepti i xhahilijetit, i cili në qoftë se ka të bëjë me thelbin e besimit, atëherë nënkupton kufrin e madh. Ky koncept ndonjëherë ka të bëjë edhe me mëkatet e vogla, si p.sh. Pejgamberi a.s. kur i thotë sahabiut të njohur Ebu Dherres: "Ti je njeri në të cilin ka xhahilijet".[87]

Kështu pra, konceptet dhe terminologjitë duhet të definohen në formë të qartë, që të mos krijohet huti midis njerëzve dhe në parime.

Këtu vlen të theksohet koncepti të cilin njerëzit e kanë keqkuptuar, gjegjësisht koncepti që ka të bëjë me "lartësinë" e Tij xh.sh., e për të cilën flasin selefët. Disa prej njerëzve mendojnë se ata i përshkruajnë Zotit të Madhëruar qenie materiale dhe për këtë i akuzojnë për antropomorfizëm, ngase nga ky lloj i të kuptuarit nënkuptohet koncepcioni fizik konkret.

Realitetin e këtij medhhebi e ka sqaruar Imam Imaduddin Vasiti (i vdekur në vitin 711/H), i cili njihet si dijetar selefist, sufist dhe shafi'it dhe të cilin Ibën Tejmijje e quan "Xhunejdi i kohës së tij" kurse Hafidh Dhehebiu e quan "Shejhu ynë shëmbëlltyrë". Vasiti në veprën e tij "Nasiha" thotë: "All-llahu i Madhëruar ka qenë, e s'ka ekzistu as vend, as arsh, as ujë, as gjithësi, as ajër, as zbrazëtirë e as atmosferë të mbushur.

---

[86] Transmetim unanim nga Ebu Hurejreja.
[87] Transmetim unanim nga Ibën Umeri dhe Ibën Amër bin Asi.

Ai gjithmonë ka qenë I vetëm, I vetëm në vetminë e Tij, i Madhëruar është Ai në atë vetmi të Tij nuk thuhet se Ai është mbi këtë ngase s'ka gjë përveç Tij. Ai është para asaj nën dhe mbi ngase këto të dyja janë anë përbërëse të botës, Zoti i Madhëruar në atë vetmi apsolute është i pastër nga të gjitha gjërat e krijuara.

Kur vendosi "dëshira hyjnore" që t'i krijojë gjërat e krijuara me të gjitha elementet fizike, krijoi gjithësinë me anët që ka nën dhe mbi. I Madhëruari është i pastër nga cilësitë e krijuara! Ai krijoi anët "lartë" dhe "poshtë".

Urtësia hyjnore vendosi që gjithësia të jetë poshtë ngase është e krijuar, kurse madhëria hyjnore dikton që Ai të jetë mbi gjithësinë. Gjithësia është e krijuar kur Ai është i pastër nga bota ku ka mbi dhe nën. Zoti i Madhëruar gjithmonë ka ekzistuar dhe gjithmonë do të ekzistojë dhe kështu, në Të asgjë nuk është krijuar, as në qenien e Tij e as në atributet e Tij. Ai është ashtu siç ka qenë më parë!

Kur u krijuan krijesat, anët, zbrazëtira, atmosfera e mbushur, mbi-ja dhe nën-ja, është aksiomatike se Madhëria hyjnore do të jetë mbi të gjitha këto, ngase ajo që është nën të është e krijuar dhe pason pas Krijuesit.

Atij nuk mund t'i drejtohet ndokush nga poshtë, nga e djathta apo nga e majta, as nga "nën" e as nga "mbi". T'i drejtohesh ndokujt duhet të nisesh nga gjithësia, krijimi dhe vendi. Zotit nuk i takojnë gjërat e krijuara ngase Ai është krijues i tyre.

"Istiva'ja" pra, në këtë kontekst nënkupton cilësinë e Tij të përhershme por është shfaqur atëherë kur e ka krijuar Arshin, ashtu siç është "llogaria" cilësi e Tij e përhershme, por do të shfaqet në botën e Ahiretit.

Në qoftë se kuptohet kjo, atëherë ne do të largohemi më shumë se ata që e komentuan "mbi-në" si shkallë më të lartë dhe "istiva-në" me epërsi. Zoti është i pastër nga gjërat që e kufizojnë dhe për këtë ne as që e përshkruajmë në këtë mënyrë. Përshkrimi ynë e dallon nga krijesat...

Ai gjithmonë ka qenë i pastër nga cilësitë e krijuara. Në eternalitet nuk ekziston as "mbi" e as "nën". Ai që kufizohet me "nën" e njeh krijuesin e vet me "mbi", dhe kështu "Arshi" shndërrohet në realitet racional dhe anët përfundojnë tek "Arshi", kurse atë që ekziston pas Arshit nuk mund ta kuptojë mendja, ashtu siç nuk mund ta parafytyrojë edhe imagjinata. Në rast të tillë, mjafton vetëm konfirmimi pa kurrfarë "si" dhe "kur".[88]

Në tefsirin "El-Menar", dijetari Reshid Rida i komenton fjalët e Vasitiut dhe thotë:

(Them: "Edhe profesori i tij Ibën Tejmijje ka fjalë të ngjashme për Zotin i cili është mbi robërit e vet dhe që është në qiell. Kjo nuk nënkupton se Ai është i kufizuar me hapësirën qiellore, me Arshin ose me anën që është mbi kokat tona. Ibën Tejmijje, Ibën Kajjimi dhe të tjerët deklarojnë se "mbi" është njësoj sikur e majta dhe e djathta, të cilat janë çështje relative që në vete nuk kanë ndonjë të vërtetë, por komentohen ashtu siç janë mësuar...)![89]

[88] Traktati i Vasitiut "En-nesiha", botim i dytë *El-Mektebul-islamij", Bejrut.*
[89] *Tefsirul - Menar,* 3/207, botimi i tretë.

Përkufizimi i koncepteve, sqarimi i terminologjisë dhe shpjegimet e përpikta do t'i afrojnë dallimet dhe do t'i anulojnë mosmarrëveshjet por, me kusht që qëllimet (nijeti) të jenë të pastra.

PJESA E SHTATË
ORIENTIMI I MUSLIMANËVE NGA ÇËSHTJET E RËNDËSISHME TË UMMETIT

Njëri ndër faktorët që shkaktojnë përçarje në shoqëri është largimi i njerëzve nga çështjet e rëndësishme, nga ëndrrat e mëdha dhe nga shpresat e gjera për t'u përqëndruar në çështje të vogla e të imëta, dhe shpeshherë bien në konflikt për kurrgjë.

Njerëzit më së shumti i bashkojnë problemet e përbashkëta dhe konfrontimi me armikun e njëjtë. Ka të drejtë Ahmed Sheuki kur thotë: "Problemet i bashkojnë njerëzit me probleme!"

Tradhti e ummetit tonë është që sot të thellohemi në detin e polemikave për çështjet dytësore të fikhut ose për çështjet margjinale të besimit, në të cilat janë ndarë të parët, për të cilat ranë në konflikt të mëvonshmit dhe për të cilat s'ka shpresë se mund të bashkohen bashkëkohanikët.

Ndërkohë i harrojmë problemet dhe vuajtjet për të cilat ndoshta ne jemi shkaktarë të drejtëpërdrejtë ose të pjesërishëm për atë që kanë ndodhur.

Kur është pyetur Ibën Umeri r.a. nga një irakian për gjakun e mushkonjave në rastin e ihrameve, e ka kritikuar për shkak të thellimit të tepërt në kohën kur luftohej kundër Husejnit r.a. derisa e vranë e ra shehid. Në këtë rast, Ibën Umeri ka thënë:

"Ata pyesin për gjakun e mushkonjës ndërkaq e kanë derdhur gjakun e nipit të Pejgamberit a.s.".

Tradhti është që të përdoren ofendime të ashpra dhe nënçmime të rënda për çështjet që mund të komentohen në disa mënyra, e që kanë të bëjnë me ixhtihadin dhe që i konfirmojnë horizontet e gjera të kësaj feje. Ai që e qëllon shpërblehet e ai që gabon i falet, madje sipas një hadithi, edhe ai shpërblehet.

Për këtë, dijetarët dhe mendimtarët muslimanë kanë qenë të obliguar që ta drejtojnë masën e gjerë islame nga problemet e mëdha të ummetit, në këto pika të përqëndrohen dhe secili të marrë një pjesë të barrës mbi vete, kështu që përgjegjësia të ndahet në një numër më të gjerë dhe të lehtësohet pak më tepër.

Fëmijët e muslimanëve në shumë vende vdesin fizikisht nga uria e sëmurja kurse intelektualisht nga injoranca, padituria e narkomania. Atyre u kërcënohet rreziku nga krishterimi, kufri e humbja. Kur merret parasysh e gjithë kjo, atëherë si mos të interesohemi për çështjet e tyre, kur dihet mirë se ai që nuk interesohet për çështjet e muslimanëve nuk është prej tyre?!..

Ummeti islam nuk punon në rregullimin e fuqisë, nuk prodhon armë të cilat do t'i shfrytëzojë për mbrojtjen e vetvetes dhe do t'i krijojë vetvetes prestigj e vend të merituar në botë. E tërë bota islame bën pjesë brenda botës së tretë, dhe sikur të kishte edhe botë të katërt, me siguri do të bënin pjesë edhe aty.

Shpeshherë Islami akuzohet si faktor i prapambeturisë ndërkaq dihet fare mirë se kur aplikohej në jetë, ummeti islam udhëhiqte në botë dhe shënonte përparim të lartë në të gjitha sferat.

Kam shkruar një studim që është botuar në librin "Zgjimi islam dhe problemet e vatanit arab dhe islam", dhe në të konfirmoj se zgjimi (islam) nuk është jashtë problemeve aktuale të territorit islam por është i thelluar në to me shpirt e me zemër dhe kryesisht përqëndrohet në faktorët dhe në metodat e shpëtimit. Në këtë punim jam përqëndruar posaçërisht në rrymën e "objektivitetit islam", e cila e kupton Islamin me kuptim universal dhe pozitivë, i harmonizon tradicionalizmin dhe reformizmin dhe e drejtpeshon botën e ndryshimeve dhe të atyre që nuk ndryshojnë dhe po ashtu të kaluarën me planifikim për të ardhmën.

Aty i kam shqyrtuar hollësisht shtatë probleme themelore si vijojnë:

1. Prapambeturinë shkencore ose teknologjike e qytetëruese
2. Padrejtësinë shoqërore e ekonomike
3. Diktatorizmin dhe despotizmin politik
4. Uesternizmin dhe luftën intelektuale e kulturore
5. Armiqësinë dhe okupimin cionist
6. Përçarjen dhe ndarjen e botës arabe-islame
7. Devijimin dhe shkatërrimin e moralit

Nëse dëshirojmë mund të shtojmë edhe shumë probleme të tjera, si p.sh. luftërat e brendshme, konfliktet provinciale, urinë vdekjeprurëse, sulmet e ashpra nga misionarizmi krishter etj...

Para një muaji isha në Kuvajt në një konferencë të Shoqatës Humanitare Bamirëse Botërore dhe në mbledhjen përfundimtare një anëtar (dr. Abdullah Azzami) filloi të flasë për xhihadin afgan dhe për veprimtaritë e fshehta kundër tij; një tjetër filloi të flasë për revolucionin e xhamive, për trimat e gurëve dhe të tokës së shenjtë dhe për vështirësitë që i përjetojnë nga hebrenjtë, për heshtjen e arabëve dhe për paaftësinë e muslimanëve që jetojnë rreth tyre; i treti filloi të flasë për vuajtjet e Libanit dhe për shkatërrimet dhe derdhjen e gjakut gjatë një periudhe shtatëmbëdh-jetëvjeçare nga konflikti i brendshëm dhe i jashtëm si dhe për paaftësinë arabe; i katërti filloi të flasë për Pakistanin dhe depërtimin e shekullarizmit në të, të prezentuar nga një grua e mbështetur nga Perëndimi e Lindja, gjegjësisht nga kryqtarët dhe idhujtarët; i pesti filloi të diskutojë për konfliktin ndërmjet Mauritanisë dhe Senegalit, të cilat janë dy shtete fqinje e islame; i gjashti filloi ta sqarojë konspiracionin e Xhon Garangut në Sudanin Jugor; i shtati filloi të flasë për gjendjen aktuale të muslimanëve në Somali; i teti diskutoi për Eritrenë dhe invazionin marksist në të, tjetri foli për xhihadin e muslimanëve në Filipine kurse një tjetër për vuajtjet e muslimanëve në Birmani e Bullgari.

Si vendet e vogla ashtu edhe vendet e mëdha u nënshtrohen kërcënimeve dhe vuajtjeve të njëjta. Dyert e Indonezisë, që është shteti më i madh islam në Azi dhe të Nigerisë, që është shteti më imadh islam në Afrikë, janë të hapura për invazionet e misionarizmit të krishterë.

Si mendoni, muslimani i tillë që interesohet për çështjet e mëdha të ummetit të vet, a do të zhvillojë polemika për çështje të vogla e të pjesërishme që s'janë të rëndësishme e as të

nevojshme por janë vetëm pjesë e sferës së gjërave më të mira dhe më të përkryera? Në raste të tilla, a do të nxisë përleshje e përçarje?

Bota që jeton rreth nesh i harron problemet thelbësore dhe bashkohet. Këtë afrim të tillë botëror e vërejmë në shumë lëmenj të ndryshëm, edhe pse ekziston dallimi fetar, ideologjik, kombëtar, gjuhësor, shtetëror e politik.

Gjithashtu vërejmë se edhe fraksionet e krishtera bashkohen dhe ndihmojnë njëri-tjetrin, madje edhe pse ekzistojnë mosmarrëveshje të thella historike midis Hebraizmit dhe Krishterimit, vërejmë se bashkëpunojnë në lëmenj të ndryshëm saqë para disa viteve Vatikani nxori dokument me të cilin i pastron hebrenjtë nga gjaku i Isait.

Edhe në aspektin ideologjik midis dy shteteve të mëdha botërore, Amerikës dhe ish-Bashkimit Sovjetik, vërejmë bashkëpunim politik që fillon prej Deklaratës për paqe deri në politikën e bash-këpunimit.

Gjithashtu janë afruar edhe Amerika dhe Kina.

Evropa, të cilën e ndanë luftëra, konflikte e grindje kombëtare, rajonale, politike e ideologjike, sot është në afrim e sipër, madje së shpejti do të bëhet një shtet i vetëm pa kufij.

Është për t'u habitur se edhe perdja që ka ekzistuar midis Evropës Perëndimore dhe Evropës Lindore ka filluar të ngrihet. Politikani i njohur Ahmed Behauddin thotë: "Kur e përdorte De Goli frazën "Evropa prej Atlantikut deri në Ural" ballafaqohej me sarkazëm e nënçmim ngaqë Urali shtrihet midis Rusisë e Siberisë, e që nënkupton Evropën e bashkuar prej Lindjes deri në Perëndim, prej Rusisë deri në Francë e Spanjë. Ai këtë e thoshte kur luftërat e ashpra e kishin

ndarë Evropën në Lindje e Perëndim, kur e kishin ndërtuar Murin e Berlinit dhe i kishin shpejtuar garat në armatim.

De Goli vërente se historikisht bota ndahet në kombe e jo në ideologji. Gjeografia është më e rëndësishme se çdo sistem politik në histori. Franca, Gjermania dhe Rusia zbatojnë sisteme të ndryshme politike si p.sh. mbretërore ose republikane, apo kapitaliste ose komuniste, mirëpo në thelb vlen përkatësia kombëtare ngase pas të gjitha këtyre çështjeve, Franca përsëri do të mbetet Francë e Gjermania Gjermani.

Edhe pse Rusia një herë ka qenë cariste e pastaj komuniste, ajo përsëri mbeti Rusi, madje edhe Evropë. Oqeani Atlantik e ndanë Amerikën nga Evropa. Të vërtetat nacionale dhe gjeografike janë më të forta se ajo që quhet "Pakt i Varshavës" apo "Pakti Atlantik". De Goli përpiqej ta zvogëlonte ndikimin e Amerikës në Evropë. Ai gjithashtu mendonte se sistemi komunist është në mbarim e sipër.

Mendimet e tilla të tij ishin politike e jo një politikë e thjeshtë.

Si mendimtar, studiues i filozofisë së historisë dhe përsiatës mbi ndryshimet në qytetërim, De Goli kishte vizione më të thella se të tjerët. Ai ishte ekspert i asaj që ndodhte në Evropën Lindore, posaçërisht në Gjermani. Parashikimet e De Golit janë duke u realizuar pa luftë botërore, pa raketa e pa bomba bërthamore.

Gorbaçovi, i cili mendonte më ndryshe se De Goli dhe përkrahte idenë e "internacionales", e cila ishte në kundërshtim me aspektin kombëtar ngase përqëndrohej në bashkimin e klasës punëtore (proletariatit), para disa kohësh përdori frazën "Shtëpia e Madhe Evropiane", e cila e tronditi

botën e para së gjithash Evropën dhe Gjermaninë, e cila ishte e ndarë në Lindore dhe Perëndimore.

Askush s'pati mundësi të paramendojë se "logjika degoliane" do të zhvillohet në histori me shpejtësi kaq të madhe dhe aq lehtë."[90]

Habia bëhet edhe më e madhe atëherë kur u takua përfaqësuesi i materializmit dialektit Gorbaçovi me Papën e Kishës Katolike në selinë e Vatikanit. Një takim i tillë nuk është realizuar që nga Revolucioni bolshevik rus më 1917.

Kështu pra, nuk duhet t'i preokupojmë njerëzit me çështje dytësore, të pjesërishme e diskutabile e t'i largojmë nga ato vendimtare.

Kjo nënkupton se duhet të largohemi nga ato çështje të cilat nuk janë frytdhënëse dhe të cilat kanë qenë të vlefshme për intelektin islam kohë më parë por jo edhe sot, si p.sh. problemi i "krijimit të Kur'anit", i cili ka marrë shumë vend të gjerë në literaturën e mendimit islam shekuj me radhë, dhe ka shkaktuar konflikt midis mu'tezilitëve dhe të tjerëve, madje mu'tezilitët patën sukses që edhe pushtetin ta involvojnë në këtë problem dhe ta lëvizin kundër masës dhe dijetarëve muslimanë, posaçërisht kundër imamit durimtar Ahmed ibën Hanbelit. Ata e nxitën pushtetin që të përdorë masa të ndryshme për t'i detyruar të tjerët që t'i pranojnë mendimet e tyre. Kjo ishte një fitne e errët dhe sprovë e rëndë që doli nga njerëzit të cilët deklaronin se ishin ithtarë të lirisë së të menduarit.

---

[90] *El-Ahram*, 13.11.1989.

Sidoqoftë, kjo situatë kishte kohën dhe rrethanat e veta por s'ka kurrfarë nevoje që përsëri të ringjallet në këtë kohë. Habitem nga ata që diskutojnë rreth këtij problemi te zejditët apo ibaditët, me qëllim të riaktivizimit të kësaj teorie.

Problemi ynë sot nuk është me ata që deklarojnë se Kur'ani është fjalë e Zotit dhe i krijuar, por me ata që deklarojnë se Kur'ani nuk është shpallur nga Zoti por nga Muhammedi. Pra, ne ballafaqohemi me njerëzit që deklarojnë se Kur'ani është vepër e njeriut.

Pastaj, problemi ynë ka të bëjë me ata të cilët besojnë në shpalljen hyjnore të Kur'anit, por nuk e pranojnë si metodë jete e as si kushtetutë shteti apo shoqërie.

PJESA E TETË
BASHKËPUNIMI NË ÇËSHTJET E PËRBASHKËTA

Koncentrimi më i madh i aktivitetit islam përqëndrohet në çështjet diskutabile, si që bisedohet rreth tyre ditën e ëndërrohen natën. Këto çështje hulumtohen, diskutohen dhe rreth tyre zhvillohen polemika të ashpra.

Unë nuk e urrej hulumtimin e njerëzve në çështjet e tilla në formë shkencore për ti krahasuar mendimet, në qoftë se me to merren ekspertë që kanë aftësi e potencial për hulumtime të tilla, që posedojnë arsye të shëndoshë e që janë të devotshëm dhe të sinqertë.

Përkundrazi, unë e urrej përqëndrimin e plotë në këto probleme që na largon nga çështjet të cilat kanë rëndësi më të madhe, dhe që e harxhojnë tërë fuqinë tonë intelektuale e cila mund të shfrytëzohet në formimin e qenies sonë fetare, kulturore e qytetëruese.

Dëshira ime është që të gjithë muslimanët të kenë mjekra e të largohen prej diskutimeve dhe polemikave që janë zhvilluar midis imamëve juristë, dhe t'i shpëtojnë ata që e shfrytëzojnë këtë fenomen për t'i akuzuar të tjerët!

Unë nuk dëshiroj që ta preokupojmë popullin me çështje të tilla ngase shkaktojnë probleme të mëdha. Më ka ardhur shumë keq kur dëgjova nga disa të rinj se një njohës i çështjeve diskutabile ka zhvilluar nëntë ligjërata për çështjen e lëshimit apo të moslëshimit të mjekrës, madje disa të tjerë kanë përpiluar edhe libra për aspektet formale të namazit të cilat janë diskutabile.

Secili që i hedh një shikim sot ummetit islam, do të bindet se problemi i shoqërisë islame nuk qëndron në preferimin e mendimeve që janë diskutabile dhe rezultat i ixhtihadit apo imitimit (taklidit), por në zhdukjen e çështjeve që janë të përbashkëta për të gjitha medhhebet dhe shkollat juridike islame.

Problemi i muslimanëve nuk qëndron mbi ata të cilët i komentojnë ajetet dhe hadithet për cilësitë hyjnore, por mbi ata të cilët i mohojnë të gjitha cilësitë hyjnore e që janë robër të mendimit të importuar nga Perëndimi apo Lindja.

Problemi i muslimanëve nuk është në ata të cilët e komentojnë "istivan-ë" si fuqi të Zotit të Madhëruar, por në ata të cilët e mohojnë Arshin dhe Zotin e Arshit.

Problemi i muslimanëve nuk është në ata të cilët e lexojnë me zë apo pa zë bismilahin në namaz, apo në ata të cilët përdorin forma të ndryshme në ngritjen e duarve për hyrje në namaz, por në ata të cilët asnjëherë nuk i përkulen Zotit, nuk e lëshojnë kokën në sexhde dhe nuk e njohin xhaminë.

Problemi nuk është në ata të cilët i pranojnë mendimet e ndonjë imami për vërejtjen e Hënës gjatë muajit të Ramazanit, por në ata të cilët e kalojnë tërë muajin pa agjëruar fare edhe atë pa ndier kurrfarë turpi.

Problemi nuk është në ato të cilat e mbulojnë krejtësisht apo pjesërisht kokën, por në ato që i zbulojnë krejtësisht kokën e trupin dhe që veshin rroba provokative...

Problemi i vërtetë është dobësimi i besimit, mohimi i Sheriatit, shkatërrimi i moralit, mosfalja e namazit, mosdhënia e zeqatit, ndjekja e pasioneve, përhapja e amoralitetit dhe korrupsionit, udhëheqja e keqe, braktisja e farzeve, aplikimi i ndalesave kategorike dhe mbështetja në armiqtë e Zotit, të Pejgamberit të Tij dhe të besimtarëve.

Problemi i muslimanëve është në mohimin e mendjes, në stagnimin e intelektit, në dehjen e dëshirës, në mbytjen e lirisë, në mbytjen e të drejtave, në harresën e obligimeve, në përhapjen e egoizmit, në shfuqizimin e ligjeve të Zotit në gjithësi e në shoqëri, në madhërimin e udhëheqësve mbi popullin, në fuqinë mbi të vërtetën (kundër të vërtetës) dhe në interesin personal.

Problemi i ummetit islam është i qartë si dielli dhe vërehet qartë në zhdukjen e parimeve të Islamit, shtyllave të imanit dhe parimeve të mirëbërjes, të cilat ishin edhe temë bisede ndërmjet Xhibrilit dhe Pejgamberit a.s. në hadithin autentik të njohur. Në fund të hadithit, Pejgamberi a.s.

u thotë: "Ky ishte Xhibrili dhe kishte ardhur që t'ua mësojë fenë tuaj!" Edhe pse Xhibrili i shtronte Pejgamberit a.s. vetëm pyetje, pyetjet e tilla kishin karakter mësimor ngase i përmbanin bazat e përgjithshme të fesë, gjegjësisht kishin të bënin me besimin dhe praktikën, të dukshmen e të padukshmen.

Besoj se për thirrësit në Islam dhe për muslimanët në përgjithësi është më i rëndësishëm përqëndrimi në çështjet e përbashkëta dhe se bashkëpunimi në çështjet e tilla konsiderohet nevojë dhe obligim fetar e konkret. Jam i bindur se për një çështje të tillë nevojitet një punë serioze, dëshirë e fortë, mendje e aftë, fuqi e madhe, shpirt i pastër dhe forcë konstruktive.

A nuk kemi mendim të përbashkët se Kur'ani është fjalë e Zotit dhe se Muhammedi është Pejgamber i Zotit?

A nuk kemi besim të përbashkët se Zoti është një, se nuk lind, se nuk ka lindur askënd dhe se askush nuk është rival i Tij?

A nuk kemi mendim të përbashkët se Ai është i Madhëruar, se ka cilësi të përkryera dhe se është jashtë çdo mangësie?

A nuk kemi mendim të përbashkët se emrat e Tij që i përshkruan Kur'ani janë emrat e Tij më të përsosur e më të bukur?

Të bashkëpunojmë në mbjelljen e besimit kur'anor në shpirtrat e rinj të rinisë, pa i ngarkuar me problemet filozofike dhe apologjetike që shkaktuan ndarjen e ummetit në sekte e fraksione.

A nuk kemi mendim të përbashkët se rreziku më i madh që i kanoset njerëzimit është ateizmi?

Të bashkëpunojmë në mbrojtjen e rinisë nga epidemia e ateizmit dhe nga dyshimet që luhasin besimin e që ndikojnë në mendime.

Të bashkëpunojmë në përforcimin e besimit në Zotin e Madhëruar, i cili krijoi çdo gjë edhe atë duke u mbështetur në rezultatet e shkencës bashkëkohore, të cilat vërtetojnë shumë qartë ekzistimin hyjnor.

A nuk kemi mendim të përbashkët se besimi në botën tjetër, në shpërblimin e drejtë dhe në xhennetin e xhehennemin konsiderohet shtyllë e çdo feje, posaçërisht e Fesë islame?

Besimi në Zotin e Madhëruar ndikon që njeriu të anojë nga e mira, të jetë mirëbërës, të luftojë çdo të keqe, të jetë i fortë në çastet e dobësisë dhe të shpresojë në çastet e pesimizmit.

Pra, të bashkëpunojmë në përforcimin e besimit në botën tjetër e në shpërblimin e drejtë dhe t'i largojmë dyshimet që ndikojnë në këtë besim të madhëruar, që e nxisin njeriun të anojë nga e keqja!

A nuk kemi mendim të përbashkët për pesë parimet praktike të Islamit?

Pse nuk bashkëpunojmë në edukimin e muslimanëve me këto parime, duke i përdorur të gjitha mjetet bashkëkohore audio-vizuele?

A nuk kemi mendim të përbashkët për gjashtë kushtet e imanit, gjegjësisht për besimin në Zotin, në engjëjt, në librat, në pejgamberët, në Ditën e Kijametit dhe në kaderin e Tij?

Pse nuk bashkëpunojmë në përforcimin e këtyre shtyllave në mendjet dhe në zemrat e muslimanëve, me një gjuhë të lehtë e të kuptueshme që përputhet me natyrën e Islamit, me qartësinë e

Kur'anit, me përparimin bashkëkohor pa u thelluar në polemikat e të vjetërve edhe atë, me qëllim që ta vërtetojmë atë që e vërteton Kur'ani dhe ta refuzojmë atë që e refuzon Kur'ani?

A nuk kemi mendim të përbashkët për moralin më të përsosur, me të cilin është dërguar Pejgamberi a.s. dhe i cili nënkupton mbështetjen në Zotin, falënderimin për begatitë e Tij, durimin në sprovat e Tij, dakordimin me caktimin e Tij, lutjen për mëshirën e Tij, frikën nga dënimi i Tij, sinqeritetin ndaj Tij, dashurinë ndaj Tij, animin nga të përmendurit e Tij...?

Përveç këtij morali hyjnor ekziston edhe ai njerëzor, si p.sh. sinqeriteti, besnikëria, mbajtja e premtimit, drejtësia, trimëria, turpi, modestia, sistematizimi dhe bashkëpunimi.

Pra, të bashkëpunojmë në përforcimin e vlerave të tilla në shpirtrat e të rinjve e të mëdhejve, e t'i mënjanojmë veset e këqija të cilat shkatërrojnë individin dhe shoqërinë, për të cilat Imam Gazaliu e përdor termin e huazuar nga hadithi pejgamberik dhe i quan "Shkatërrimtarët".

A nuk kemi mendim të përbashkët për parimet e Sheriatit të cilat i konfirmojnë Kur'ani dhe Sunneti, të cilat i pranon i tërë ummeti dhe të cilat prezentojnë unitet ideologjik, psikik e biheviorist?

Pra, të bashkëpunojmë në aplikimin e parimeve të Sheriatit dhe t'i mbrojmë nga ata të cilët dëshirojnë t'i shndërrojnë prej frymës së qartë në të paqartë dhe të luajnë me to sipas dëshirës së tyre, të udhëheqësve apo të djajve.

A nuk kemi mendim të përbashkët se cionizmi sot është rrezik i madh fetar, ushtarak, ekonomik, politik, shoqëror, moral, e qytetërues, i cili dëshiron të shkatërrojë çdo gjë, të depërtojë në Medine e Hajber e t'i realizojë mendimet të cilat duken se janë utopike? Cionizmi e ka pushtuar tokën, ka

depërtuar në njerëz dhe ende vepron me aktivitetin e vet armiqësor. Ai na lufton nga aspekti fetar, edhe atë duke u inspiruar nga besimi i hebrenjve në Teurat, në Talmud dhe në profetët e tyre.

Pse nuk bashkëpunojmë kundër tyre ashtu siç ata bashkëpunojnë kundër nesh, gjegjësisht me Kur'anin tonë kundër Talmudit të tyre, hebraizmin e tyre me Islamin tonë, falsifikimet e Talmudit me Sunnetin që e kemi trashëguar e që është përplot të vërteta?

Pse nuk bashkëpunojmë kundër veprimeve të fshehta të hebraizmit në Afrikë e Azi, posaçërisht në vendet islame?

A nuk kemi mendim të përbashkët se Perëndimi ende nuk është çliruar nga shpirti i kryqëzatave, i cili herë pas here del në skenë, si p.sh., me rastin e apostatit Salman Rushdi dhe mbulesës së studenteve muslimane në Francë...!

Pra, të bashkëpunojmë kundër luftërave të tilla kryqtare që kanë armë të reja dhe mundësi të mëdha.

A nuk kemi mendim të përbashkët se ekziston invadimi i misionarizmit të krishterë në botën tonë islame, i cili posedon fuqi të madhe e që orvatet edhe me pakicat islame në botë duke shfrytëzuar varfërinë, padituri në, sëmundjet dhe urinë, të cilat, për fat të keq, janë të përhapura te bijtë e ummetit tonë në Afrikë e Azi. Mijëra prej tyre, madje miliona orvaten ta largojnë ummetin tonë nga lëkura e nga besimi i tij, madje edhe arrijnë sukses në vende të shumta.

Pra, të bashkëpunojmë kundër këtij invadimi fetar që lufton ummetin e besimin e tij, e t'u kundërvihemi ashtu siç na kundërvihen neve...

A nuk kemi mendim të përbashkët se miliona muslimanë nga e tërë bota nuk i dinë parimet kryesore të Islamit përveç termit "Islam", kurse nga Kur'ani vetëm shkronjat? Kjo padituri apo boshllëk i nxitë misionarizmin e krishterë dhe ideologjitë tjera që të punojnë kundër ummetit islam.

Të bashkëpunojmë në edukimin elementar islam të popujve muslimanë si p.sh. në lëmenjtë e akaidit, ibadeteve, moralit e edukatës, rreth të cilave nuk ka mosmarrëveshje ndërmjet medhhebeve. Kjo detyrë është shumë e vështirë dhe kërkon prej nesh përpjekje të mëdha dhe serioze.

A nuk kemi mendim të përbashkët se katër miliardë banorë të tokës njohin vetëm disa gjëra nga Islami, e ai që di diçka nga leximi apo dëgjimi, ka vetëm një pasqyrë të zbehtë ose të shtrembëruar. Në të vërtetë, thirrja islame në mesin e tyre nuk ka depërtuar në formë të realtë.

Ne jemi përgjegjës për shpërndarjen e zërit të Islamit në gjashtë kontinentet e botës dhe secilit popull t'i flasim në gjuhën e tij, me qëllim që t'ua ofrojmë argumentet, t'i ç'rrënjosim dyshimet, t'ua tregojmë të vërtetat e Islamit dhe t'i zbulojmë gënjeshtrat e armiqve që luftojnë kundër Islamit.

Pse të mos bashkëpunojmë në këtë punë të madhe dhe të sigurojmë njerëz e pasuri? Në qoftë se hebrenjtë punojnë kështu dhe arrijnë sukses që të formojnë shtet në mesin e territorit islam, dhe në qoftë se të krishterët punojnë kështu për ta krishteruar botën, edhe atë duke filluar nga Bota islame, atëherë pse të mos punojmë edhe ne bashkërisht në përhapjen e Islamit dhe për ta njoftuar botën me vlerat e Islamit ashtu siç veprojnë të tjerët?

Të krishterët e kanë përkthyer e shpërndarë Biblën në qindra gjuhë e në mijëra dialekte, e ne nuk kemi mundësi të afrojmë as përkthime të plota të Kur'anit në gjuhët më të njohura të botës, e të mos flasim për gjuhët tjera më pak të njohura!?

A nuk kemi mendim të përbashkët se fuqitë laike bashkëpunojnë seriozisht për ta penguar zbatimin e Sheriatit islam dhe për ta deformuar thelbin e tij brenda shoqërive islame, ku thirret në madhërimin e All-llahut të Madhëruar nga ana e popujve të ndryshëm që jetojnë në territoret islame?

Pse nuk bashkëpunojmë të gjithë muslimanët dhe të qëndrojmë në një front kundër rrezikut që u kanoset muslimanëve nga shekullarizmi, i cili ka përkrahjen e të gjitha forcave që luftojnë kundër Islamit, qofshin perëndimore apo lindore?

NË FUND:

Pse të mos i harrojnë muslimanët mosmarrëveshjet rreth çështjeve të gjera të ixhtihadit dhe rreth atyre të dorës së dytë dhe të bashkohen në një front të përbashkët kundër fuqive të mëdha që i luftojnë, që përgatisin veprime të fshehta e që bashkohen kur janë në pyetje muslimanët?

Arritja e një gjuhe të përbashkët nuk është punë e lehtë por ka nevojë për përpjekje të mëdha që do të dominojnë në çdo ide, mendim, kohë e mundësi. Vetëm kështu do të plotësohet zbrazëtira, do të realizohen shpresat dhe do të arrihet qëllimi.

Është haram që fronti islam të hapet rreth çështjeve të mjekrës, veshjes, komenteve, lëvizjes së gishtit në momentin e dëshmisë nga njëra anë, e nga ana tjetër të lihen të pambushura zbrazëtirat e mëdha me forcën e besimtarëve të sinqertë.

PJESA E NËNTË
TOLERANCA NË ÇËSHTJET DISKUTABILE

Në qoftë se bashkëpunimi në çështjet e përbashkëta është i obligueshëm, atëherë edhe më e obligueshme është toleranca në çështjet diskutabile, dhe kështu, në këtë mënyrë përmbyllet cikli i artë, të cilin e ka formuar mendimtari i njohur reformist, Muhammed Reshid Rida (Zoti e mëshiroftë), redaktor i revistës "Menar" dhe i tefsirit "Menar", i cili thotë: "Të bashkëpunojmë në çështjet e përbashkëta dhe të bëjmë tolerancë midis nesh në çështjet diskutabile".

Imami martir Hasan Benna (Zoti e mëshiroftë) ka patur kujdes tejet të madh ndaj këtij parimi teoretikisht dhe praktikisht, saqë nxënësit e tij mendonin se ai ishte formulues i këtij parimi.

Toleranca këtu nënkupton që të mos ekzistojë ekstremizmi kundër mendimit të të tjerëve në çështjet diskutabile, kundër ndonjë medhhebi tjetër ose kundër ndonjë imami tjetër, por ta lartësojmë flamurin e tolerancës, që sipas redaktorit të "Menarit", (Zoti e mëshiroftë), nënkupton dominimin e gjuhës së përbashkët në çështjet diskutabile.

Kjo tolerancë mbështetet në disa parime:

A. RESPEKTIMI I MENDIMIT TË TJETËRKUJT

Faktori që zhduk mosmarrëveshjen dhe që ofron unitetin është respektimi i mendimit të tjëtrkujt dhe i aspekteve tjera dhe vlerësimi i përpjekjeve që janë kontribut i ixhtihadit.

E gjithë kjo mbështetet në rregullën e rëndësishme: "Çdo parim që nuk është kategorik pranon ixhtihadin e kur e pranon ixhtihadin, atëherë shndërrohet në çështje diskutabile".

Ajo që nuk e pranon ixhtihadin është çështja kategorike e cila përfaqëson unitetin ideologjik, psikik e praktik të ummetit dhe e cila nuk guxon të shndërrohet në çështje rreth të cilës zhvillohen polemika dhe dyshime teorike nga teoricienë dhe dyshues.

Dihet mirëfilli se numri i çështjeve kategorike është më i kufizuar se i atyre jokategorike që pranojnë ixhtihadin. S'ka dyshim se kjo formë e parimeve është mëshirë e Zotit të Madhëruar për robërit e Tij dhe sikur të dëshironte I Madhëruari, do të na mbyllte derën e ixhtihadit me parim konkret.

Zoti i Madhëruar ka heshtur shumë gjëra, jo nga harresa por nga mëshira ndaj nesh. Ai (xh.sh.), nuk harron asnjëherë por u ka dhënë natyrë që pranon mendime dhe komente të ndryshme, e që përshtatet me mendësinë e nduarnduart të njerëzve, prej të cilëve disa janë ekzoteristë e disa

ezoteristë. Në qoftë se kam të drejtë të hulumtoj për ta kuptuar tekstin, atëherë duhet ta vlerësoj edhe mendimin e tjetrit që orvatet ashtu siç orvatem unë.

Ixhtihadi nga natyra pranon mendime të ndryshme, e sikur të mos kishte natyrë të tillë, nuk do të quhej ixhtihad (diligjencë). Edhe sikur të jetë mendimi i gabuar, sipas hadithit të Pejgamberit a.s., shpërblimi nuk do të mungojë. Pra, nëse gabohet, nuk humb shpërblimi nga ixhtihadi.

Këtu do ta transmetoj thënien e Imam Shafi'iut (Zoti e mëshiroftë) për parimet e pjesërishme dhe dytësore praktike, i cili thotë: "Mendimi im është i saktë por mund të jetë edhe gabim, e mendimi i tjetrit është gabim por mund të jetë edhe i saktë".

Kjo natyrë e dyanshme është ajo që i ofron dallimet midis dy palëve. Kjo thënie e Imam Shafi'iut është rezultat i diturisë së tij të gjerë dhe e zemërgjerësisë së tij.

Sipas një tjetri, të gjitha mendimet që dalin nga ixhtihadi janë të sakta, ngase domethëniet e ndryshme të parimit mund të përputhen me ixhtihadin e çdo muxhtehidi. Për këtë do të bëhet fjalë në vazhdim.

B. MUNDËSIA E SAKTËSISË SË SHUMËFISHTË

Tolerancën në çështjet diskutabile dhe në respektimin e mendimit të tjetërkujt, e ndihmon edhe bindja në mundësinë e saktësisë së shumëfishtë.

Këtu shtrohet pyetja: "A mund të ketë saktësi të shumëfishtë apo saktësia është gjithmonë vetëm një dhe nuk pranon natyrën e shumëfishtë?"

Përgjigjja është se, sipas ekspertëve të Usuli-fikhut (bazat e jurisprudencës islame), saktësia në parimet e çështjeve dytësore mund të jetë e shumëfishtë dhe se e saktë konsiderohet ajo që e ka arritur muxhtehidi, pa marrë parasysh se formohen mendime të ndryshme e të llojllojshme.

Këta, në shkencën e Usuli-fikhut njihen si "qëllues", që posedojnë argumente e të vërteta ashtu siç posedojnë edhe ata që mendojnë ndryshe.

Transmetohet se disa dijetarë të selefit e kanë lejuar një gjë të tillë në çështjet jothelbësorë të besimit, rreth të cilave ka mendime të ndryshme medhhebore për shkak se nuk ekzistojnë tekste të qarta e kategorike, si p.sh., veprat e robërve (njerëzve), dëshira për mëkat etj. Transmetohet nga Ubejdullah ibën Hasan Anberi se rreth këtyre çështjeve ka thënë: "Këta njerëz e madhërojnë Zotin kurse ata njerëz e pastrojnë (nga mangësitë) Zotin".

Sipas Ibën Tejmijjes dhe Ibën Kajjimit, kjo çështje pranohet në problemet e përpikta rreth të cilave janë zhvilluar diskutime që nga kohët e lashta dhe në këto raste, edhe nëse gabon muxhtehidi, shpërblehet.

"Xhumhuri" i dijetarëve të ummetit nuk pranojnë se të gjithë muxhtehidët mund të kenë të drejtë, ngase muxhtehidi mund t'ia qëllojë ose të gabojë, edhe atë varësisht nga tekstet e qarta të Kur'anit e Sunnetit, e që i mbështesin argumentet. Edhe sipas këtyre, mund të ketë saktësi të dyfishtë në raste të posaçme.

Ekzistojnë gjëra për të cilat vetë Zoti ka dëshiruar që të kenë domethënie të ndryshme, të cilat në përgjithësi konsiderohen të sakta, e si shembull konkret mund të përmendim leximin në shumë mënyra të Kur'anit famëlart, i cili është konfirmuar nga Pejgamberi a.s. përmes transmetimeve autentike. Si rezultat i mundësisë së tillë ekzistojnë termat "shtatë leximet e njohura" ose "dhjetë leximet e njohura", të cilat janë të njohura në mesin e të gjithë muslimanëve të botës. Muslimanët nuk shohin ndonjë dëm nga leximet e tilla të ndryshme dhe për këtë shkak edhe i botojnë mus'hafët sipas këtyre leximeve konkrete. Mus'hafët lindorë botohen sipas transmetimit të Hafs ibën Asimit kurse mus'hafët perëndimorë botohen sipas transmetimit "Versh" nga Nafi'u.

Në thelb, Pejgamberi a.s. ua lexonte sahabëve Kur'anin në më shumë mënyra, kurse disa sahabë në fillim i refuzonin leximet përveç atij që e kishin dëgjuar vetë, mirëpo më vonë e kuptuan se të gjitha ishin të sakta dhe se të gjitha rrjedhin nga Pejgamberi a.s. Për këtë, Pejgamberi a.s. i ka thënë Ibën Mes'udit dhe atij që mendonte ndryshe: "Të dy keni të drejtë!"

Ekzistojnë çështje të cilat mund të kenë saktësi të shumëfishtë por në kushte të posaçme, p.sh., mendimet e muxhtehidit të jenë të sakta në kohën e tij e në një kohë tjetër të jenë të sakta mendimet e ndonjë muxhtehidi tjetër. Gjithashtu mendimi i ndonjë muxhtehidi mund të jetë i saktë në një rreth kurse në rrethin tjetër, jo, si p.sh., territori i Islamit dallohet nga ai i ateizmit, territori i Sunnetit dallohet nga ai i risive dhe territori i shkretëtirës (i fshatit) dallohet nga ai i qytetëruar.

Gjithashtu mendimi i muxhtehidit mund të jetë i saktë në ndonjë rast të posaçëm e i tjetrit në ndonjë rast tjetër të posaçëm, si p.sh., gjendja e të dobëtit nuk i ngjason gjendjes së të fuqishmit,

gjendja e zgjedhjes nuk i ngjason gjendjes së nevojës së obligueshme dhe gjendja e të riut që ka hyrë në Islam nuk i ngjason gjendjes së atij që ka rrënjë të thella në Islam.

E gjithë kjo ka ndikuar që dijetarët të thonë se fetvatë ndryshojnë me ndryshimin e kohës, vendit, gjendjes, traditës etj. Ky rregull është i njohur dhe Zoti më dha shëndet që të shkruaj për të, duke u mbështetur në argumentet nga Kur'ani famëlart, nga Sunneti i pastër, nga udhëzimet e sahabëve dhe nga veprat e imamëve. Këtë hulumtim e titullova "Avamilus-si'ati vel-muruneti fish-sheriatil-islamijjeti".

Saktësia e shumëfishtë nga ndryshimi i kohës:

Sahabët aplikojnë parime të cilat nuk kanë qenë në kohën e Pejgamberit a.s. nën ndikimin e kohës, si p.sh. refuzimi i Umerit të ndajë plaçkat e luftës në Irak ishte në kundërshtim me atë që veproi Pejgamberi a.s. në Hajber, apo djegia e mus'hafëve nga ana e Uthmanit për atë që i kishte tubuar vetë nga frika e përçarjes, apo garancia për kompensim në rast të dëmtimit të pasurisë nuk i ngjason kohës së kaluar, ngase me ndryshimin e natyrës së njerëzve, njerëzit filluan të frikohen për pasurinë e tyre. Gjithashtu vërejmë se ithtarët e imamëve filluan të mendojnë ndryshe ngase koha e imamëve dallohej nga koha e tyre, e këtë fakt shumë bukur e ka regjistruar historia e fikhut (jurisprudenca islame), madje për ndryshimet në mendime midis Ebu Hanifes dhe Ebu Jusufit e Muhammedit është thënë: "Ndryshimet janë ndryshime të kohës e jo të argumentit". Kjo ka ndikuar që një imam si Ibën Ebu Zejd Kajravani, autor i veprës së njohur "Er-risale" të marrë qen për mbrojtje përkundër faktit se Maliki urrente një gjë të tillë. Kur kritikohej se e ka kundërshtuar imamin e medhhebit, thoshte: "Sikur të jetonte Maliku në kohën tonë, do të merrte luan".

Në ndryshimin e mendimeve gjithashtu ndikon edhe vendi, dhe për këtë shkak fukahatë thonin se parimet e territorit të paqes dallohen nga ato të luftës.

Mendimet gjithashtu ndryshojnë edhe nën ndikimin e rrethanave, si të individit ashtu edhe të shoqërisë, si p.sh., Pejgamberi a.s. jepte përgjigje të ndryshme varësisht nga gjendja e pyetësve, ashtu siç vepron edhe mjeku me njerëzit e sëmurë. Ai gjithashtu pranonte nga disa njerëz diçka që s'mund ta pranonte nga të tjerët, si p.sh., qëndrimi i tij ndaj një beduini të thjeshtë i cili e ka kryer urinën në xhami, duke e arsyetuar se ai është njeri që nuk e njeh etikën islame dhe është beduin. Në atë rast, Pejgamberi a.s. u tha sahabëve: "Mos e pengoni..., ju jeni dërguar si lehtësues e jo si vështirësues!"

Për këtë shkak, fetvatë e Pejgamberit a.s. në raste specifike nuk konsiderohen të përgjithshme dhe në këtë aspekt janë mbështetur edhe fukahatë dhe e kanë formuluar parimin: "Rrethanat e gjendjeve dhe të personave nuk janë të përgjithshme".

Gjithashtu kështu kanë vepruar edhe sahabët e Pejgamberit a.s. Për këtë shkak vërejmë se në rastin e pirjes së alkoolit Ebu Bekri ka dënuar me 40 të goditura e Umeri me 80 sosh, duke u mbështetur në atë se me shtimin e konsumuesve të alkoolit shtohet edhe dënimi.

Umer ibën Abdulazizi ka thënë: "Dënoni njerëzit sipas mëkateve të bëra!" Ky i refuzonte dhuratat dhe kur i thuhej se Pejgamberi a.s. i ka pranuar, ai përgjigjej: "Në kohën e tij dhurata ishte dhuratë e në kohën time ajo është ryshfet".

Si shembull më konkret këtu mund ta theksojmë atë që e transmeton imam Ibën Kajjimi nga shejhul-islami, Ibën Tejmijje, se kur ka kaluar afër tatarëve në Damask, të cilët kanë qenë të

dehur, disa shokë të tij kanë reaguar por ai, me mendje e mprehtësi dhe intuitën e tij të shëndoshë, u ka thënë: "Lini ashtu! Zoti e ka ndaluar verën ngase ajo pengon përmendjen e Zotit, faljen e namazit, e këta i pengon nga gjakderdhja dhe grabitja e pasurisë".

Ky është fikh (jurisprudencë islame) i vërtetë që nuk ka formë statike por i studion shkaqet e motivet, dhe në bazë të tyre i përcakton parimet.

Kjo që thuhet në çështjet juridike islame gjithashtu mund të thuhet edhe në çështjet politike, shoqërore, reformiste etj.

Në ndonjë shtet lejohet pjesëmarrja në votime dhe hyrja në parlament, me qëllim të ndikimit në qeverinë e cila i dikton ligjet e shteteve demokratike, ose më së paku, të dëgjohet zëri i Islamit dhe të flasë fjala e argumentit, kurse në ndonjë shtet tjetër çdo gjë është e kotë ngase mund të ndikohet në tiraninë që mund ta çojë në humbje ummetin.

C. HARMONIZIMI ME REALITETIN

Mendimet e ndryshme që i vërejmë sot në botën islame nuk kanë të bëjnë me thelbin e parimit të Sheriatit në vete, por vetëm me harmonizimin me realitetin. Ky parim është i njohur te juristët muslimanë.

Të gjithë janë të një mendimi se ai që mohon shpalljen e Zotit, pa dyshim konsiderohet pabesimtar dhe nuk meriton të jetë pjesëtar i ummetit islam. Për refuzuesin e tillë vlen fjala e Zotit të Madhëruar:

"E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues".

(Maide, 44).

Mendoj se këtu s'ka nevojë për koment!

Çështja rrotullohet rreth asaj se udhëheqësit e ndonjë shteti a janë muslimanë apo jo?

Disa thonë se ata refuzojnë dhe mohojnë nga frika dhe për këtë konsiderohen pabesimtarë, apostatë dhe të humbur.

Disa të tjerë thonë se ata janë të dobët, robër të posteve, s'kanë fuqi feje e as shpirti që mund t'i detyrojë e të thonë me gojën e tyre: "jo".

Disa të tjerë përpiqen t'i nxjerrin nga situata duke i arsyetuar se janë të obliguar të veprojnë ashtu ngase i huaji dirigjon fuqinë e tyre dhe se s'kanë ndikim, edhe pse kanë ushtri të mëdha. I huaji i furnizon me armë e fuqi dhe u ofron kredi e ndihma të tjera!

Kësaj i ngjason edhe ndryshimi i të keqes me fuqi. S'ka dyshim se ai që ka fuqi e mundësi dhe s'frikohet prej të tjerëve, ka mundësi ta ndryshojë gjendjen. Në këtë kontekst vjen parasysh (hadithi i Pejgamberit a.s.) i cili thotë se në raste të tilla duhet të veprohet me fuqi, e nëse jo me fuqi, atëherë me gjuhë, e nëse jo edhe me gjuhë atëherë me zemër, e kjo e fundit është pjesa më e dobët e imanit (besimit).

Polemika zhvillohet këtu: a ka mundësi filani apo ky grup ta pengojnë të keqen sipas kushteve që i përmendëm apo jo?

Këtu fillojnë mendimet dhe polemikat e llojllojshme.

Disa njerëz mendojnë se njerëzit e tillë kanë mundësi ta pengojnë të keqen ngase kanë fuqi që ta mbyllin shtëpinë e amoralitetit, t'i thyejnë shishet e alkoolit e t'i ndalojnë ahengjet e devijuara.

Sipas disa të tjerëve, këta njerëz janë të dobët dhe vetëm me fjalë s'kanë mundësi ta ndryshojnë situatën e tillë.

Një grup i tretë është më mesatar dhe e analizon çështjen nga të gjitha aspektet, bën krahasime midis të mirave e të këqijave , dëmeve dhe dobive duke i dhënë përparësi largimit të të keqes ndaj realizimit të të mirës.

DYSHIME

Disa njerëz të sinqertë e të emocionuar thonë se si të bashkëpunojmë me ata që sjellin risi e të heshtim para risive të tyre, kur dihet se jemi të urdhëruar që t'i kundërshtojmë e të mos dorëzohemi para tyre?

U përgjigjemi se risitë janë të shkallëzuara dhe se prej tyre ka që shpiejnë në kufër e disa jo...! Ka risi për të cilat ekzistojnë mendime unanime ashtu siç ka risi për të cilat ka mendime të ndryshme

e të llojllojshme që hyjnë brenda suazave të ixhtihadit. Në qoftë se gabon muxhtehidi, shpërblehet me një shpërblim dhe i falet gabimi.

Prej ithtarëve të risive ka njerëz që u prijnë atyre dhe njerëz që i imitojnë prijësit risimtarë; disa prej tyre janë të ashpër e disa të butë. Pra, nuk duhet të trajtohen të gjithë të një rangu, e në qoftë se bisedohet me ta me urtësi e mençuri, ekziston shpresa se mund të binden në gabimin e tyre, të distancohen dhe të kthehen në rrugë të vërtetë. Si shembull konkret vërejmë se Imam Buhariu transmeton në "Sahih-in" e vet edhe nga disa risimtarë e që prej tyre kishte edhe të atillë që propagonin risinë e tyre ngase i konsideronte si njerëz të sinqertë e të përpiktë, madje transmeton nga Umran ibën Hattani, njëri nga thirrësit dhe poetët harithit për të cilin transmetohet të ketë thurrur vargje në të cilat e lavdëron Ibën Mulxhenin, mbytësin e Imam Aliut (r.a.).

Nga parimet e caktuara të Sheriatit është maksima "pranimi i dëmit më të butë dhe i të keqes më të lehtë". Nisur nga kjo maksimë, lejohet bahkëpunimi me risimtarin më të lehtë kundër risimtarin më të rëndë apo kundër mohuesit që është armik i mbarë ummetit. Madje, lejohet bashkëpunimi ose aleanca me mohuesin më të lehtë kundër atij që është më i vështirë, apo me mohuesin që ka mendim të mirë e respekt ndaj muslimanëve kundër mohuesit që është armik i hapur dhe konspirativ i muslimanëve.

Pejgamberi a.s. lidhi aleancë me fisin Huza'a pas paqes së Hudejbijes kundër kurejshëve, që ishin armiq të hapur dhe kundërshtarë luftarakë.

Në ngjarjen e luftës midis romakëve e persianëve ku fituan persianët zjarrputistë kundër romakëve të krishterë, u zhvilluan polemika midis muslimanëve dhe idhujtarëve kurejshitë në Mekke për këtë betejë, madje Ebu Bekri është deklaruar haptas se romakët do të fitojnë. Nga kjo

del se ndonjë kufër është më i lehtë se tjetri dhe se disa pabesimtarë janë më afër muslimanëve se disa të tjerë. Këtë e kuptuan edhe muslimanët edhe idhujtarët e Mekkes. Idhujtarët mendonin se ngadhënjimi i persianëve kundër romakëve i iriton muslimanët, ngase persianët ishin idhujtarë të zjarrit dhe besonin në dy zota: në Zotin e të mirës dhe në Zotin e të keqes, përkundër romakëve të cilët ishin ithtarë të librit dhe pjesëtarë të fesë qiellore.

S'është për t'u habitur se Kur'ani shpalli ajet që i përgëzon muslimanët se shteti do të jetë i romakëve:

"Elif, Lamë, Mimë!Bizantët (rumët) u mundën, Në tokën më afër (tokës së arabëve), po pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjejnë, brenda pak viteve. Çështja është vendim i All-llahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E atë ditë (kur do të fitojnë bizantët), besimtarët do të gëzohen për ndihmën e All-llahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i gjithfuqishëm, mëshirues".

(Er-Rum, 1-5).

PJESA E DHJETË
MOSAKUZIMI I ATIJ QË DEKLARON SE S'KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALLLLAHUT

Për çdo hulumtues është krejtësisht e qartë se faktori më kryesor dhe më i rrezikshëm që e përçanë unitetin dhe bashkimin e aktivistëve muslimanë në veçanti dhe të muslimanëve në përgjithësi është akuzimi i të tjerëve për pabesim (kufër), gjegjësisht ta mënjanosh muslimanin nga bashkësia e tij, nga familja e ithtarëve të Kibles dhe ta akuzosh me kufër e apostazi.

S'ka dyshim se një veprim i tillë shkakton dallim të madh mes teje dhe atij, ngase nuk ka takim ndërmjet muslimanit e apostatit. Rruga e të dyve nuk bashkohet në një pikë asnjëherë.

Në broshurën time "Dhahiretul-guluvi fit-tekfir" i kam theksuar rreziqet e këtij qëndrimi, duke vërtetuar se akuza e tillë konsiderohet gabim fetar, shkencor, dinamik e politik.

Sunneti pejgamberik autentik tërheq vërejtjen ndaj akuzave të tilla kundër muslimanit.

Hadithi i transmetuar nga Ibën Umeri: "Kur i thotë njeriu vëllait të vet "O pabesimtar", njëri do ta fiton këtë (ofiq) në qoftë se është ashtu si i thotë (mirë), nëse nuk është ashtu, i kthehet atij".[91]

Nga Ebu Dherri transmetohet:

[91] Transmetim i Malikit, Buhariut, Muslimit, Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

"Ai që e akuzon njeriun me kufër ose e thërret "O armik i Zotit, e nuk është ashtu, i kthehet atij (si bumerang)".[92]

Nga Ebu Kulabe transmetohet::

"Ai që e akuzon besimtarin për kufër, është sikur ta ketë vrarë atë".[93]

Nga e gjithë kjo del në pah se ithtarët e Islamit obligohen që të mos e akuzojnë për kufër atë që deklaron: "S'ka zot tjetër përveç All-llahut". Transmetohen hadithe të vërteta të cilat vërtetojnë se ai që deklaron dëshminë i mbrohen gjaku e pasuria, e llogaria e tij do të jetë te Zoti.

Fraza "llogaria e tij do të jetë te Zoti" nënkupton të vërtetën se ne nuk njohim brendinë e tij por mbështetemi në aspektin e dukshëm, e fshehtësitë i njeh vetëm All-llahu i Madhëruar.

Ngjarja e Usame ibën Zejdit me një njeri të cilin e ka vrarë gjatë një beteje, është e njohur. Ai e ka vrarë pasi që ai e ka deklaruar haptas dëshminë (shehadetin), dhe kur ka dëgjuar Pejgamberi a.s. për këtë ngjarje, e ka kritikuar Usamen. Kur i ka thënë Usameja se deklarimi i tij ka qenë nga frika prej shpatës, Pejgamberi a.s. i është përgjigjur: "A depërtove në zemrën e tij?"

Kështu pra s'duhet të mbështetemi në mëkate e risi për t'i akuzuar muslimanët për kufër. Në këtë kontekst, imam Ibën Veziri thotë:

"Pejgamberi a.s. e ka ndaluar akuzimin me kufër në mënyrë të qartë". Ndër hadithet e tilla janë:

---

[92] Transmetim i Buhariut dhe i Muslimit.

[93] Transmetim i Buhariut dhe i Muslimit. Këtë gjithashtu e ka transmetuar edhe Mundhiri në *"Et-tergib ve-terhib"*.

Transmetimi i Enesit se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Tri gjëra janë nga thelbi i imanit: Mosakuzimi i atij që thotë: "S'ka zot tjetër përveç All-llahut", të mos e akuzojmë me kufër për shkak të ndonjë mëkati e as të mos e nxjerrim nga Islami për shkak të ndonjë vepre..." Këtë hadith e ka transmetuar Ebu Davudi në librin e Xhihadit në Sunen. Gjithashtu e transmeton Ebu Ja'la në një formë tjetër pa kurrfarë dobësimi, përpos Jezid Rekkash, ky rob i sinqert i cili është trajtuar si i dobët nga aspekti mekanik. Këtë e ka lavdëruar Hafidh ibën Adiu.

Ebu Hurejreja transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë ngjashëm siç ka thënë në hadithin e transmetuar nga Enesi (pak më parë). Transmetim i Ebu Davudit.

Ibën Umeri transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

"Mos i akuzoni ithtarët e (shehadetit) "S'ka zot tjetër përveç All-llahut" me kufër për shkak të ndonjë mëkati. Ai që i akuzon ithtarët e (shehadetit) "S'ka zot tjetër përveç All-llahut", është më afër kufrit". Taberani e transmeton në *"El-Kebir"* nga Dahhak ibën Hamra nga ky Ali ibën Zejdi.

Hejthemi thotë se argumentimi me këta dy është diskutabil, mirëpo unë them se mund të përdoret si argument dhe te përforcohet me (transmetimet) e mëparshme...

Në këtë kapitull kemi edhe nga Ali ibën Ebi Talibi, Ebu Derda, Ebu Umame, Vathile, Xhabir ibën Adbullahi, Ebu Seid Hudari dhe Aisheja r.a. të gjithë këta nga Pejgamberi a.s. transmetojnë ngjashëm me këtë që u cek por me senede të thumbuara që përforcohen në forma tjera. Në hadithin e Aliut r.a. ekziston argumenti për mosakuzimin e harixhitëve për kufër. Nga Xhabiri transmetohet se kur është pyetur se a i kanë akuzuar ithtarët e Kibles për idhujtari, ai u është për-gjigjur: "Zoti na mbroftë!", dhe është rrëqethur nga pyetja e tillë. Përsëri e kanë pyetur se a e kanë

quajtur ndonjërin prej tyre kafir, e ai u është përgjigjur: "Jo!" Transmetim i Ebu Ja'lasë dhe i Taberaniut në "El-Kebir" me transmetues autentik. Këta shtatë shembuj dhe hadithi i sipërpërmendur transmetohen në "Mexhme'uz - zeva'id".

Hejthemiu gjithashtu thekson edhe një formë tjetër dhe thotë: "Ka shumë ajete e hadithe që kanë të bëjnë me faljen e gabimit dhe, siç duket, komentuesit kanë gabuar e nuk kanë vepruar qëllimisht". Në këtë kontekst, në Kur'an thuhet:

"Nuk është mëkat juaji ajo për çka keni gabuar, por (është mëkat) ajo që zemrat tuaja e bëjnë qëllimisht, po All-llahu është që falë, është mëshirues".

(Ahzabë, 5).

Zoti i Madhëruar gjithashtu thotë:

"Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë".

(Bekare, 286).

Në komentimin e këtyre ajeteve thuhet se Zoti i Madhëruar ka thënë "kështu kam vepruar" (e pranoj këtë lutje tuajën), ceket kjo në dy hadithe të vërteta, njeriun nga ta e transmeton Ibn Abbasi dhe tjetri Ebu Hurejra. Zoti i Madhëruar thotë:

"Dhe duke e ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen)".

(Ali Imran, 135).

"Kush mbyt një besimtar me qëllim, dënimi i tij është xhehennemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë".

(Nisaë, 93).

"E kush e mbytë atë me qëllim...!"

(Maide, 95).

Edhe hadithet që kanë të bëjnë me këtë çështje janë të shumta, si p.sh., transmetimet e Sa'dit, Ebu Dherres, Ebu Bekres etj.

Në këtë kontekst është edhe hadithi:

"Unë jam në përkujtimin e robit tim, pra le të më përkujtojë sa të dojë..."

Kështu, një numër i madh i dijetarëve muslimanë thonë se muslimani që deklaron pa qëllim fjalë kufri, nuk mund të akuzohet për kufër. Autori i veprës "El-Muhit" thotë se kështu thonë Ebu Ali El-Xhubai, Muhamedi dhe Shafiu.

Mendoj se hadithet e tilla autentike mjaftojnë si argument për çështjet e tilla.[94]

Shejhul islami, Ibën Tejmijje, thotë: "Nuk lejohet të akuzohet muslimani me kufër në bazë të ndonjë mëkati ose gabimi të bërë. Zoti i Madhëruar thotë:

"I dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të Tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi All-llahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij dhe thamë: "Iu përgjigjëm (thirrjes) dhe respektuam (urdhërin). Kërkojmë faljen tënde, o Zoti ynë! Vetëm te Ti është ardhmëria jonë. All-llahu nuk e obligon asnjë njeri përtej

[94] Mexhmu'atu fetava Shejhil-Islam, Ibën Tejmijje, 3/282-287.

mundësisë së tij, atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi. Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën ne nuk kemi fuqi! Na i shlyej mëkatet, na i mbulo të këqijat, na mëshiro. Ti je mbrojtësi ynë, na ndihmo kundër popullit pabesimtar".

(Bekare, 285, 286).

Në transmetimet autentike gjejmë se All-llahu i është përgjigjur besimtarëve në këtë lutje dhe i ka falur atyre mëkatin.

Harixhitët i ka luftuar prijësi i besimtarëve Ali ibën Ebu Talibi ashtu siç ishin kompaktë në luftimin e tyre edhe imamët e sahabëve, të Tabi'inë've e të pasardhësve të tyre, por pa i akuzuar për kufër. As Ali ibën Ebu Talibi, as Sa'd ibën Ebi Vekkasi e as sahabët tjerë nuk i akuzonin për kufër dhe nuk i luftonin nga ky parim, por vetëm atëherë kur shkaktonin gjakderdhje dhe kur e sulmonin pasurinë e muslimanëve. Pra, ata luftonin për t'u mbrojtur nga dëmet e tyre.

Në qoftë se nuk janë akuzuar këta për kufër, atëherë si qëndron puna me fraksionet tjera të cilat mendonin ndryshe? Nuk i lejohet asnjë fraksioni t'i akuzojë fraksionet tjera për kufër e as mbytja e ithtarëve të tyre.

Në thelb gjaku, pasuria dhe nderi i muslimanëve nuk lejohet të cenohen nga njëri-tjetri. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. në Haxhxhin e lamtumirës ka thënë: "Gjaku i juaj, pasuria juaj dhe nderi i juaj janë të shenjta, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë vend dhe në këtë muaj".

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë: "Ai që falet si ne, kthehet nga Kibla jonë dhe ushqehet nga kurbanët tanë, është musliman dhe është nën mbrojtjen e Zotit dhe të Pejgamberit të Tij".

Ai gjithashtu thotë: "Në qoftë se kacafyten dy muslimanë me shpatat e tyre, vrasësi dhe i vrari do të hyjnë në zjarr". Kur i është thënë Pejgamberit a.s. se kjo nënkuptohet për vrasësin por pse edhe për të vrarin, ai është përgjigjur: "Ai ka dëshiruar vrasjen e shokut të vet". Ai përsëri thotë: "Mos u shndërroni pas meje në pabesimtarë e të vritni njëri - tjetrin".

Të gjitha këto hadithe janë autentike.

Në dy sahihët transmetohet konflikti midis Usejd ibën Hudajrit dhe Sa'd ibën Ubades të cilit Usejdi i tha: ti je munafik që po diskuton për munafikët (e rastit të shpifjes ndaj Aishes r.a.) në mesin e të cilëve ka ndërmjetësuar Pejgamberi a.s. pa e akuzuar ndonjërin për kufër ose dyfytyrësi.

Në dy sahihët gjithashtu transmetohet se kur ka dëgjuar Pejgamberi a.s. se Usame ibën Zejdi e ka vrarë një njeri që ka deklaruar: "S'ka zot tjetër përveç All-llahut", i ka thënë disa herë: "O Usame, a e ke vrarë pas deklarimit të tij se s'ka zot tjetër përveç All-llahut?" Pejgamberi a.s. e ka përsëritur pyetjen e tij derisa Usameja thotë: "Do të kisha dëshiruar që atë ditë ta kisha pranuar Islamin!" Ai nuk është dënuar ngase deklarata e tij ka qenë se dëshmia e të vrarit ka qenë rezultat i frikës nga shpata e tij.

Edhe pse bienin në konflikt, brezat e parë të muslimanëve përsëri respektoheshin si muslimanë e besimtarë. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju pajtoni ata, e në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftone atë grup që vërsulet pa të drejtë derisa t'i bindet udhëzimit të All-llahut, e nëse kthehet, atëherë me drejtësi bëni pajtimin ndërmjet tyre, mbani drejtësinë, se vërtet All-llahu i do të drejtit. S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti)".

(Huxhuratë, 9-10).

Këtu Zoti konfirmon se edhe pse ata luftojnë kundër njëri-tjetrit, përsëri janë vëllezër muslimanë dhe urdhëron të ndërmjetësohet midis tyre me drejtësi.

Edhe kur ishte në konflikt brezi i selefit, ata e trajtonin njëri-tjetrin si muslimanë e jo si pabesimtarë. Ata pranonin dashurinë e njëri-tjetrit, mësonin nga njëri-tjetri, martoheshin në mes vete dhe e trashëgonin njëri-tjetrin.

Zoti i Madhëruar urdhëron jetën e bashkuar dhe ndalon përçarjen e shkapërdedhjen:

"Vërtet, ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhammed) nuk ke kurrfarë përgjegjësie. Çështja e tyre është vetëm te All-llahu, Ai do t'i njohë me atë që punuan".

(En'amë, 159).

Pejgamberi a.s. thotë: "Obligoheni në bashkim ngase dora e Zotit është me bashkimin".

Ai gjithashtu thotë: "Djalli është me një, kurse prej dyve është më larg".

Ai po ashtu thotë: "Djalli është ujk për njeriun, ashtu siç është ujku për dhentë. Ujku e merr delen e larguar nga tufa".

Kur të hyjë muslimani në ndonjë qytet muslimanësh përpiqet të falë namazin me ata, të bashkëpunojë me ta e jo t'i sulmojë. Në qoftë se i sheh të devijuar, le t'i udhëzojë nëse ka mundësi, e nëse jo, Zoti nuk e ngarkon asnjërin me atë që s'mund ta bëjë. Në një hadith autentik Pejgamberi a.s. thotë: "Popullin e udhëheq ai që e njeh më mirë Librin e Zotit, e në qoftë se janë të barabartë, atëherë ai që e njeh më mirë Sunnetin, e nëse janë të barabartë, atëherë ai që është më i vjetër në emigrim, e në qoftë se janë të barabartë, atëherë ai që është më i moshuar".

Madje edhe në lidhje me mendimet e njerëzve për faljen e namazit të xhumasë pas mëkatarit, gjegjësisht a të përsëritet apo jo, Ahmed ibën Hanbeli thotë: "Kush e përsërit (faljen e namazit) konsiderohet risimtar. Ky është mendimi më i preferuar ngase sahabët nuk e përsëritnin namazin kur faleshin pas mëkatarit e risimtarit, madje as që ka urdhëruar Zoti i Madhëruar të përsëritet namazi".[95]

Edhe shejhul-islami, Ibën Tejmijje, ka qenë shumë i qartë në këtë çështje. Ai kategorikisht ka refuzuar që të akuzohen njerëzit për kufër për shkak të ndonjë mëkati apo gabimi. Ai i ftonte njerëzit të jetojnë në bashkësi e të mos përçahen dhe e lejonte namazin pas risimtarit. Përkundër kësaj, vërejmë se disa njerëz që pretendojnë se janë ithtarë të Ibën Tejmijjes, i harrojnë këto të vërteta dhe i sulmojnë e i akuzojnë për kufër të gjithë ata që mendojnë ndryshe, madje i akuzojnë edhe disa nga fraksionet e mëdha të ummetit si p.sh. esharitët. Përveç fraksioneve, këtu i akuzojnë edhe disa dijetarë të mëdhej e të famshëm, edhe pse hadithi i Pejgamberit a.s. i kushton kujdes të veçantë kësaj çështjeje.

[95] Itharul - hakki alel-halki, f. 392-394.

NUK AKUZOHET PËR KUFËR AI QË I REFUZON HADITHET "AHAD" PËR SHKAK TË NDONJË DYSHIMI

(të transmetuara nga një person)

Gabim i madh i disa dijetarëve apo thirrësve të rinj në Islam është që shpejtojnë në fetva dhe e konsiderojnë kafir atë që refuzon disa hadithe autentike "ahad", të cilat mund t'i kenë transmetuar Buhariu e Muslimi për shkak të dyshimeve.

Këta njerëz i refuzojnë hadithet e tilla ngase mendojnë sipas tyre se nuk përputhen me domethënien e qartë të Kur'anit ose me hadithet autentike, apo me shkencën e përpiktë, me realitetin historik, me shqisën apo me intelektin...

Akuza për kufër nuk ka të bëjë me këtë çështje ngase dijetarët i akuzojnë vetëm ata që e mohojnë në tërësi Sunnetin dhe nuk e pranojnë si burim të parimeve të Sheriatit pos Kur'anit. Ai që mohon një gjë të tillë, mohon atë që e ka konfirmuar Sunneti në çështjet e njohura të fesë, si p.sh. pesë kohët e namazit, të cilat janë kohë të caktuara, rekate të caktuara, forma të caktuara që fillojnë me tekbir e përfundojnë me selam. Pra, të gjitha këto çështje të namazit janë përkufizuar me Sunnet.

Ai që mohon ndonjë hadith ose disa hadithe *"ahad"*, nuk akuzohet për kufër nga ndonjë fakih ose dijetar i famshëm, por më së shumti mund të akuzohet si risimtar apo i devijuar, edhe atë në bazë të argumenteve të shëndosha.

Imamët e ehlu-sunnetit nuk i kanë akuzuar për kufër harixhitët e as mu'tezilitët edhe pse mohonin shumë hadithe autentike, si p.sh., hadithin e parjes së Zotit të Madhëruar në xhennet, hadithin e sëmurjes së Pejgamberit a.s. nga sihri etj. Hadithet e tilla i ka përmendur Ibën Kutejbe në librin e tij të njohur *"Te'vilu muhtelefil-hadith"*.

Shumë imamë refuzojnë ndonjë hadith edhe pse të tjerët e pranojnë, madje edhe muhadithë që refuzojnë hadithe të cilat të tjerët i konsiderojnë autentike, si p.sh., Buhariu ka braktisur hadithe të caktuara që i kanë transmetuar të tjerët.

Imami dhe më i njohuri në kritikën e hadithit, Jahja ibën Me'in, i refuzon hadithet *"feraidus-sadaka",* të cilat i transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

Vetë Aisheja r.a. ka dhënë mendimin e vet për disa hadithe, për të cilat mendonte se nuk përputheshin me Kur'anin, dhe kështu i refuzonte me arsyetimin se sahabët që i kanë transmetuar kanë gabuar për shkak se nuk i kanë dëgjuar mirë nga Pejgamberi a.s., si p.sh. hadithin: "I vdekuri vuan nga vajtimi i familjes së tij për të", duke menduar se nuk përputhet me ajetin kur'anor "Askush nuk e bartë barrën e tjetërkujt". Këtë hadith e kanë transmetuar më shumë se një sahab.

Në këtë kontekst gjithashtu hyn edhe hadithi:

"Një grua ka hyrë në zjarr për shkak të një maceje që e ka mbyllur", ngase, sipas saj, besimtari është më i respektuar te Zoti se të dënohet për një mace, dhe se, gruaja ka qenë pabesimtare.[96]

[96] Kemi vërtetuar gabimin e Ummul-mu'ëminine. Aishes r.a. në mohimin e transmetimit të këtij hadithi nga Ebu Hurejreja në librin tim *"Kejfe neteamelu meas - sunnetin - nebevijjeti"*.

Këtu bën pjesë edhe hadithi i Pejgamberit a.s., i cili në Bedër ka qëndruar para varrezës të kurejshëve dhe u ka thënë: "A e gjetët me të vërtetë atë që ua ka premtuar Zoti juaj?

Unë me të vërtetë e gjeta atë që ma ka premtuar Zoti im"

Dhe thënia e Umerit dhe e disa sahabëve: "A u flet njerëzve që janë kalbur?"

Dijetari Ibën Kethiri, pasi që e thekson këtë hadith në librin e tij *"El-Bidaje ven-nihaje"*, thotë: "Ky hadith është nga ata të cilët i komentonte Aisheja r.a. dhe për të cilët mendonte se i kundërshtojnë disa ajete; ky hadith kundërshton fjalën e Zotit:

"E ti nuk mund ta bësh të dëgjojë ai që është në varr".

(Fatir, 22).

Ky hadith nuk e kundërshton ajetin në fjalë dhe e vërteta është me *"xhumhurin"* e sahabëve dhe pasardhësve të tyre, përkundër mendimeve të Aishesë r.a.".[97]

Asnjëri prej sahabëve ose prej pasardhësve të tyre nuk e ka akuzuar Aishenë r.a. për fe të dobët, bindje të dobët ose mohim të Sunnetit të bashkëshortit të saj, Pejgamberit a.s. Të gjithë e kanë kritikuar duke e vërtetuar gabimin në mendimet e saj, por asnjëri nuk e ka ofenduar, madje i kanë tubuar transmetimet e saj në vepra të posaçme dhe kanë folur rreth saj me respekt e nder të madh, edhe atë duke u nisur nga fakti se komentet e saj kanë qenë fryt i ixhtihadit të saj dhe për këtë shkak ajo arsyetohet, madje edhe shpërblehet.

[97] *El-Bidaje ven-nihaje*, 3/292, 293, botim i Bejrutit.

KAPITULLI I TRETË
BAZAT MORALE TË FIKHUT TË DALLIMEVE NË MENDIME
RËNDËSIA E BAZAVE MORALE

Pa e marrë parasysh rëndësinë e bazave intelektuale e shkencore në afrimin e ithtarëve të ndarë të zgjimit islam dhe në bashkimin e tyre kundër fuqive të mëdha, të cilat ndërmarin veprime të fshehta kundër Islamit dhe muslimanëve në Lindje e Perëndim, aspektet e besimit dhe të moralit kanë një rëndësi e vlerë të posaçme.

Njeriu ka nevojë për mendje të zgjuar, ndjenja të gjalla, dituri të dobishme, besim të fortë dhe moral të pastër. Për këtë shkak u përcaktuam për shqyrtimin e disa bazave morale që kanë ndikim të madh e të thellë në përforcimin e kulturës së dialogut, në bashkimin e fjalës, në konfirmimin e nocioneve të vëllazërimit, bashkëpunimit e tolerancës në të cilat thërret Islami, dhe të cilat duhet të mbizotërojnë e të thellohen në shpirtrat e muslimanëve në përgjithësi dhe në ata të aktivistëve islam në veçanti.

PJESA E PARË
SINQERITETI DHE PASTRIMI NGA EPSHET DHE PASIONET

Çështja e parë me të cilën fillojmë dhe e cila u paraprinë të gjitha parimeve dhe rregullave që i cekëm më parë, është ajo e sinqeritetit ndaj Zotit të Madhëruar, e përqëndrimit të plotë në të vërtetën dhe e pastrimit nga epshet e pasionet.

Në shumë raste sipërfaqësisht duket se polemikat midis individëve e grupeve kanë të bëjnë vetëm me çështjet shkencore ose intelektuale, mirëpo, në thelb kanë natyrë krejtësisht tjetër, gjegjësisht kanë të bëjnë me egoizmin dhe me epshet të cilat i verbërojnë njerëzit, i bëjnë memecë dhe i largojnë nga rruga e Zotit. Për fat të keq, kjo atmosferë ka ekzistuar dhe ekziston sot e kësaj dite në mesin e grupeve dhe lëvizjeve islame brenda ummetit islam.

Edhe pse në pamje të parë duken se janë islame, ato në shpirt u përkasin epsheve dhe interesave individuale aq shumë, saqë dominojnë plotësisht me sjelljet e njeriut.

Polemikat shpeshherë zhvillohen për shkak të dallimeve në mendime se kush mund të zgjedhet si udhëheqës apo kryetar, Zejdi, Amri apo Bekri. Në këtë kontekst Pejgamberi a.s. thotë: "Të përqëndruarit në pasuri e poste e dëmton më shumë fenë se dy ujq që bëjnë dëm ndër dhentë".[98]

[98] Transmetim i Ahmedit e Tirmidhiut, i cili e bën sahih nga Ka'b ibën Maliki, Mundhiri thotë se ka sened të mirë, shiko *"Fejdul-kadir*, 5/466.

Edukata islame, kur'anore-pejgamberike, përqëndrohet në formimin e njeriut besimtar i cili ten-ton vetëm të punojë për Krijuesin, për të vërtetën dhe për lumturinë në botën tjetër e jo vetëm për qëllimet e kësaj bote:

"Ajo që e keni pranë vetes është e përkohshme, e ajo që është te All-llahu është e përjetshme. E Ne do t'ua japim atyre që ishin të durueshëm shpërblimin më të mirë të asaj që vepruan".

(En-Nahl, 96).

Ky ajet (kjo edukatë) ua tërheq vërejtjen atyre që janë të preokupuar në tërësi me këtë botë, që punojnë për autoritetet, prestigji e interesi personal apo për ndonjë fanatizëm të dukshëm apo të fshehtë. Për këtë shkak, në hadithin e vërtetë Pejgamberi a.s. thotë se së pari zjarri i xhehennemit do të mbushet me hipokritët dhe me gënjeshtarët ndaj All-llahut të cilët para njerëzve paraqitën se punojnë për Zotin e në të vërtetë punojnë për interesat personale dhe pasionet e epshet e tyre po edhe në qoftë se në mesin e tyre alimi që i mëson të tjerët, dhënësi i madh (i pasurisë) dhe muxhahidi i spikatur. Ky hadith sinjalizon ushtarët e panjohur të cilët e shkrijnë dhe e harxhojnë jetën e tyre më të shtrenjtë në të ndihmuarit e fesë së tyre dhe nënshtrimi ndaj Zotit të tyre pa i përfshirë ata dritat e reflektorëve dhe as pa u bërë me gisht kah ta.

Transmetohet nga Hakimi dhe të tjerët, nga Zejd ibën Eslem dhe nga i ati i tij se njëherë, kur ka dalur Umeri r.a. në xhami, e ka parë Mu'adhin duke qarë te varri i Pejgamberit a.s. Kur e ka pyetur se çka e shtyu që të qajë, ai i përgjigjet: "Një hadith të cilin e kam dëgjuar nga Pejgamberi a.s. e që thotë: "Edhe hipokrizia e paktë konsiderohet idhujtari. Ai që i sulmon të devotshmit (evlijatë) e Zotit, ka hyrë në dyluftim me All-llahun, e All-llahu i do njerëzit e mirë, të devotshëm

e të fshehtë, të cilët janë të pranishëm edhe nëse mungojnë, e nëse prezentojnë, nuk njihen, zemrat e këtyre janë dritë e udhëzimit dhe i shpëtojnë (njerëzit) nga errësira".[99]

Unë kam parë shumë njerëz të cilët mbronin disa rryma ideologjike me fanatizëm të fortë saqë nuk pranonin asnjërin që mendonte ndryshe, madje përdornin ofendime dhe akuza të ashpra ndaj të tjerëve, me pretekst se kinse dëshironin të tregohen të sinqertë ndaj përcaktimeve të tyre ideologjike.

Këto gjëra duken shumë të qarta atëherë kur takohen me bashkëmendimtarët e tyre të cilët do t'ua përcjellin të tjerëve qëndrimet e këtyre ushtarëve të "sinqertë" të ideologjisë së përbashkët.

Musliman i vërtetë është ai që është rob i Zotit e jo i unit të vet dhe ngado që të kthehet apo të orientohet, nuk kërkon poste e as këtë botë.

Pejgamberi a.s. thotë: "I mjeruar është robi i dinarit, i mjeruar është robi i derhemit...!".

Zoti qoftë i kënaqur me shpatën e Zotit, Halid ibën Velidin, i cili njëherë luftoi si komandant dhe korri suksese të mëdha, mirëpo, kur u zëvendësua me Ebu Ubejden, u bë këshilltar dhe udhëzues më i mirë i tij.

Të tillë janë besimtarët e sinqertë!

---

[99] Transmetim i Hakimit në *"Mustedrek"*, Kitabul-iman 1/4 duke thënë se është autentik. Përkrahje i kanë dhënë Dhehebiu si dhe Mundhiri në *"Et-Tergib vet-terhib"*. Shiko hadithin numër 19 në librin tonë *"El-Munteka minet-tergibi vet-terhibi"*.

Unë vërej shumë mosmarrëveshje midis fraksioneve islame dhe i ndiej qëndrimet e tyre fanatike ndaj njërës apo palës tjetër, ndaj ndonjë province apo qyteti ose ndaj ndonjë personi, shkolle apo kulture.

Sikur të ishin të drejtë, atëherë do të ishin të sinqertë ndaj të vërtetës dhe do të kishin bindje të pastër fetare ndaj Zotit:

"Thuaj: Namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve (i pari që e pranoj dhe i bindem)".

(En'amë, 162, 163).

Ndjekja e epsheve është një lloj idhujtarie, dhe për këtë shkak, selefët thonë: "Zoti më i keq që është adhuruar në tokë (dhe që e ka bazënnë tokë) është pasioni." Kjo deklaratë del nga e vërteta se pasioni e largonë njeriun nga e vërteta edhe pse e di atë:

"A e ke parë ti (Muhammed) atë që duke e ditur, dëshirën e vet e respekton si Zot të vetin, atë All-llahu e ka humbur, ia ka mbyllur të dëgjuarit dhe zemrën e tij, i ka vënë perde mbi të pamurit e tij. Më thuaj, pos All-llahut, kush mund ta udhëzojë atë? A nuk merrni mësim?"

(Xhathije, 23).

Më vjen shumë keq kur shoh se disa dijetarë të fesë ose disa anëtarë të fraksioneve islame bashkë-punojnë me shoqëritë shekullariste kundër vëllezërve të vet, vetëm e vetëm sepse nuk mendojnë si ata dhe se nuk kanë qëndrim politik si të tyrin. Në këtë mënyrë, këta devijojnë nga udhëzimet e Kur'anit dhe Sunnetit, nga fjalët e selefit të ummetit dhe nga udhëzimet e njerëzve të devotshëm.

Vërejmë se gjatë fushatave zgjedhore në shumë vende disa njerëz fetarë dhe ithtarë të disa fraksioneve fetare, i këshillojnë bashkëmendimtarët e vet që t'ua japin votën laikëve që e refuzojnë haptazi Sheriatin e Zotit dhe i nënçmojnë parimet hyjnore. Njerëzit e tillë nuk pranojnë t'ua japin votën njerëzve të cilët janë muslimanë të pastër, të drejtë dhe aplikues të dispozitave të Sheriatit ngase mendojnë ndryshe nga ata në disa çështje.

Këtu a mund të ketë logjikë të cilën e pranon Islami? Këtu ka vetëm epshe, përleshje, armiqësi dhe pasione shkatërrimtare! A kështu mendojnë se veprojnë mirë? Zoti i Madhëruar na shpëtoftë!

PJESA E DYTË
LARGIMI NGA MBËSHTETJET EKSTREMISTE NË PERSONA, DOKTRINA E FRAKSIONE

Sinqeriteti ndaj Zotit dhe përqëndrimi në të vërtetën e çlirojnë njeriun nga qëndrimet ekstreme ndaj njerëzve, medhhebeve dhe sekteve, për shkak se në raste të tilla ai do të mbështetet vetëm në argumente, madje edhe në qoftë se e kundërshton përcaktimin e tij ideologjik apo fraksionar. Është më e realtë të pranohet e vërteta se fjala e Zejdit apo Amrit. Ne nuk e adhurojmë Zotin në bazë të fjalëve të njerëzve, dijetarëve apo imamëve, por në bazë të Kur'anit dhe hadithëve autentike të Pejgamberit a.s:

"Thuaj: "Nënshtrohuni Zotit dhe nënshtrohuni Pejgamberit".

FANATIZMI DHE MENDIMI PERSONAL

Së pari njeriu duhet të largohet nga fanatizmi ndaj mendimeve të veta personale, të cilat i pranon edhe në qoftë se janë gabim, edhe atë duke i refuzuar argumentet e të tjerëve. Njeriu i tillë ekstrem insiston në mendimet e veta, i mbron, i nënçmon të tjerët dhe i ndjek pasionet, nga frika se mos po akuzohet për padituri.

Imami Shafiu, (Zoti e mëshiroftë), thotë: "Betohem në Zotin se nuk brengosem se a del argumenti prej meje apo prej gojës së kundërshtarit tim".

Fanatizmi i llojit të tillë është njëri nga faktorët më të dëmshëm e më të rrezikshëm. Njeriu i tillë mund të krahasohet me atë që jeton në shtëpi të vet të mbushur nga të gjitha anët me pasqyra, dhe në to sheh vetëm vetveten. Kështu pra ndodh edhe me njeriun ekstrem, ngase nga të gjitha mendimet e pranon vetëm mendimin e vet personal. Mendja e tij është e kufizuar vetëm në vete dhe nuk pranon mendime tjera, ngase mendon se është më i mençur, më i ditur dhe më i fuqishëm në argumente, edhe pse pikërisht është e kundërta.

Disa kanë shumë arsyetime në të cilat mbështeten në raste konkrete kur mbeten pa tekst para kundërshtarëve të tyre, si psh., mbështeten në etërit e tyre, në më të moshuarit apo në opinionin e përgjithshëm.

Në raste të tilla këta thonë: "Ne jemi me masën, në qoftë se ata e kanë mirë, atëherë edhe ti e ke qëlluar, e nëse jo, atëherë ti ke gabuar".

Disa prej tyre paraprakisht i refuzojnë mendimet e të tjerëve, pa e shfrytëzuar rastin që t'i dëgjojnë e t'i kuptojnë.

Në këtë kontekst Kur'ani ua tërheq vërejtjen muslimanëve dhe i këshillon që të mos veprojnë kështu:

Për Beni Israilitët thotë:

"Dhe kur atyre u thuhet: "Besoni atë që e shpalli All-llahu", ata thonë: "Ne besojmë atë që na u shpall neve, kurse e mohojmë atë pas tij, edhe pse është vërtetues i atij që e kanë ata dhe është i vërtetë".

(Bekare, 91).

Zoti i Madhëruar për idhujtarët thotë:

"E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): "Pranoni atë që All-llahu e shpalli!", ata thonë: "Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë!" Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar asgjë dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t'i pasonin)".

Shembulli i (thirrësit të) atyre që nuk besuan është sikur i atij (bariut) që u lëshon britmë atyre (bagëtive), që nuk dëgjojnë tjetër vetëm se britmë e zë (e nuk kuptojnë). Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, ata nuk kuptojnë.

FANATIZMI NË MEDHHEB

Fanatizëm i urrejtur është edhe ai ndaj medhhebit, si p.sh., gulatët, të cilët nga fanatizmi medhhebor u përshkruajnë shenjtëri e përkryerje imamëve dhe medhhebit të tyre. Fanatizmi i të tillëve mbështetet në këto baza:

1. Imitimi është i obligueshëm, posaçërisht në medhhebet apo në katër imamët, siç thotë autori i librit "El-Xhewhereh" në shkencën e tewhidit.

Dihet qartë se njeriu ka përgjegjësi të domosdoshme vetëm ndaj urdhërave të Zotit dhe të Pejgamberit të Tij, kështu që as Zoti e as Pejgamberi nuk kanë udhëzuar që medoemos të ndiqen Zejdi apo Amri, qofshin edhe dijetarë të mëdhenj.

2. Njerëzit e tillë nuk i lejojnë ithtarët e medhhebit ta ndërrojnë medhhebin, edhe në qoftë se në disa çështje vërehet qartë argumentimi i dobët. Madje ai që e ndërron medhhebin konsiderohet "i luhatur". Ky është një obligim tjetër me të cilin nuk na ka ngarkuar Zoti i Madhëruar. Në këto raste, imamët e medhhebeve trajtohen si ligjdhënës, ndërsa argumentet e tyre përdoren si fakte që s'mund të kritikohen! Qëndrimet e tilla bien ndesh me vetë fjalët e imamëve ngase ata ua ndalonin njerëzve që t'i imitojnë ata apo të tjerët.

Kjo gjithashtu kundërshton edhe brezin e "Selefit" të ummetit, sahabët dhe pasardhësit e tyre gjatë shekujve të parë, që konsiderohen si shekuj më të mirë dhe më afër Pejgamberit a.s.

Kështu pra, dijetarët e mëdhej të ummetit e kanë ndaluar imitimin ekstrem, i cili për pak mund të shndërrohej në atë që e praktikonin ithtarët e librit me priftërinjtë dhe etërit e tyre të shenjtë krahas Zotit.

Imam Izzuddin ibën Abduselami thotë:

"Është me të vërtetë për t'u habitur nga fakti se ndonjëri nga juristët imitatorë mbështetet në argumentet e dobëta të imamit të cilin e imiton në një anë e largohet nga argumentet e Kur'anit, Sunnetit dhe analogjisë së vërtetë në anën tjetër. Njerëzit e tillë e mbrojnë Kur'anin dhe Sunnetin për ta mbrojtur imamin e imituar".

Ai gjithashtu thotë: "Njerëzit vazhduan pa u përcaktuar në ndonjë medhheb të ndonjë dijetari derisa u paraqitën imitatorët ekstremistë, të cilët i imitonin imamët e tyre pa u mbështetur në argumente por vetëm në fjalët e tyre, sikur të ishin profetë të dërguar. Qëndrimi i tillë i ka larguar nga e vërteta, e këtë s'e pranon asnjë mendimtar".

Imami Ebu Shame thotë: "Ai që punon me fikhun nuk duhet të përkufizohet vetëm në medhhebin e një imami e të mendojë se fjalët e imamit (të përcaktuar) janë të sakta. Një gjë e tillë është më e lehtë për të në qoftë se i njeh shumicën e lëndëve paraprake dhe në qoftë se largohet nga ekstremizmi i dallimeve të mëvonshme, ngase në të kundërtën do ta humbë kohën... Ka të drejtë Shafi'iu i cili i ndalonte (njerëzit) që ta imitojnë atë dhe të tjerët. Në veprën e Dehleviut "Haxhxhetull-llahi el-baligatu", vëll. I, transmetohet se një dijetar i njohur musliman ka thënë: "Ai që dëshiron diturinë e Shafi'iut, (le ta dijë) se ai e ka ndaluar imitimin e tij dhe të të tjerëve".

Nuk duhet të habitemi kur vërejmë se disa dijetarë të sinqertë, edhe pse anojnë nga ndonjë medh-heb, kur ballafaqohen me argumente të sakta nga medhhebet tjera, i pranojnë. Qëndrimet e tilla kanë qenë shumë evidente te vetë shokët më të afërt të imamëve si psh., Ebu Jusufi, Muhamedi dhe Zuferi nuk janë dakorduar me imamin e tyre Ebu Hanifen në shumë çështje. Kështu ka ndodhur edhe me ata të Malikut, Shafi'iut dhe Ahmedit.

Edhe në kohët e mëvonshme ka patur njerëz të tillë që i kanë preferuar mendimet e të tjerëve, si p.sh. imami dhe gjykatësi Ebu Bekër Ibën Arabi e ka preferuar medhhebin e Ebu Hanifes në dhënien e zekatit nga çdo gjë që del nga toka, përkundër medhhebit të Malikut e të tjerëve.

Kur e komenton ajetin 141 të sures "En'nam" në librin e tij "Ahkamul-Kur'an":

"Ai (All-llahu) është që krijoi kopshte (bimët e të cilave) të ngritura lart (në shtylla) dhe të rrafshta (të shtrira për tokë), edhe hurmat dhe drithërat me frute (shije) të ndryshme; (krijoi) ullinjtë dhe shegë të ngjashme (nga forma) e jo të ngjashme (nga shija). Hani frutat e tyre kur të piqen dhe ditën e korrjes (të vjeljes) së frutave jepni atë pjesë që është obligim (të varfërve e nevojtarëve) dhe (hani - jepni) mos teproni, sepse Ai nuk i do shkapërderdhësit".

Ai thotë: "Ebu Hanifeja është mbështetur në këtë ajet dhe e ka kuptuar të vërtetën...", e pastaj e ka përkrahur këtë mendim përkundër medhhebit të tij dhe medhhebeve të tjera të cilat mendonin ndryshe.

Në komentin e "Sunenit" të Tirmidhiut për hadithin: "Një e dhjeta jepet nga çdo gjë që ujitet nga qielli", thuhet se medhhebi më i argumentuar në këtë çështje është ai i Ebu Hanifes.[100]

Gjithashtu vërejmë se Imam Neveviu kur e ka komentuar Muslimin apo "Muhedhdhebin" e Shiraziut, ndonjëherë i preferon medhhebet tjera e jo të Shafi'iut.

Kështu ka vepruar edhe Kemal ibën Hemmam El-Hanefiu.

Dy imamët, Ibën Tejmijje dhe Ibën Kajjimi janë të njohur me qëndrimet e tyre ndaj medhhebit të tyre hanbelit, mirëpo në shumë raste e kanë braktisur jo vetëm medhhebin e tyre por edhe katër medhhebet në tërësi, për t'u mbështetur në "ixhtihadet" e tyre.

Kur është pyetur shejhul-islami, Ibën Tejmijje, për njeriun që largohet nga medhhebi i tij në disa çështje, ai ka thënë: "Në qoftë se ndonjëri ndjek Ebu Hanifen, Malikun, Shafi'iun apo Ahmedin, mirëpo vëren se disa çështje janë më të argumentuara te medhhebet tjera dhe i pranon si të tilla, ai vepron mirë dhe nuk cenohet as feja e tij e as drejtësia e tij, ngase e vërteta ka më tepër përparësi dhe është më e preferuar te I dërguari i Zotit. Ai që merr qëndrim ekstrem ndaj Malikut, Shafi'iut , Ahmedit apo Ebu Hanifes dhe mendon se fjalët e ndonjërit prej tyre janë të sakta dhe duhet të përcillen pa i pranuar fjalët e imamit që mendon ndryshe, trajtohet si injorant dhe i humbur, madje mund të jetë edhe pabesimtar. Ai që mendon se njerëzit duhet të ndjekin vetëm një imam (themelues të ndonjë shkolle juridike islame), duhet të kërkojë falje..."

Muslimani asnjëherë nuk thotë se e tërë masa njerëzore duhet ta ndjekë vetëm këtë apo atë imam.

---

[100] Shiko librin tim *"Fikhuz-zekati"*, vëll. 1/362, botimi, XVI, shtypshkronja Vehbe, Egjipt.

Nuk quhet "i luhatshëm" ai që i pranon mendimet e imamëve për të cilat mendon se përputhen me Sunnetin, por "i luhatshëm" është ai që luhatet midis besimtarëve dhe pabesimtarëve. Në këtë kontekst, kur flet Zoti i Madhëruar për hipokritët, thotë:

"Ata janë të luhatshëm ndërmjet atij dhe atij (besimit e mosbesimit), e nuk janë as me ata (me besimtarët) e as me ata (me jobesimtarët). Po atë që e mposhtë All-llahu, ti nuk mund të gjesh shpëtim për të".

(Nisaë, 143).

Në këtë kontekst, edhe Pejgamberi a.s. thotë:

"Hipokriti është sikur delja që luhatet mes dy tufave të dhenve, herë në njërën e herë në tjetrën".[101]

All-llahu dhe Pejgamberi i Tij i qortojnë hipokritët e tillë të luhatshëm!

Zoti i Madhëruar i urdhëron besimtarët të jenë të bashkuar dhe të unjësuar, ndërsa ua ndalon përçarjen dhe shkapërderdhjen:

"O ju që besuat, kini frikë All-llahun me një sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni, por vetëm duke qenë muslimanë (besimtarë)! Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtoni nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranonit Fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu All-

[101] Transmetim i Muslimit.

llahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur. Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillë janë ata të shpëtuarit.E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u patën zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh. Në ditën kur ka fytyra që zbardhen dhe ka fytyra që nxihen. E për sa u përket atyre që fytyrat u janë nxirë (u thuhet): "A edhe pas besimit tuaj u bëtë pabesimtarë? Vuani pra dënimin për shkak se ishit që nuk besonit.!" Ndërsa atyre që fytyrat e tyre u janë zbardhur, ata janë në mëshirën (xhennetin) e All-llahut dhe aty janë përgjithmonë. Ja, këto që po t'i lexojmë ty, janë argumentet e sakta të All-llahut...",

(Ali Imran, 102-108).

Ibën Abbasi thotë se fytyrat e zbardhura janë ato të Ehlus-sunnetit dhe xhema'atit kurse të nxira janë fytyrat e risimtarëve dhe përçarësve.

Imamët e fesë përcillnin metodën e sahabëve r.a. e sahabët ishin të bashkuar dhe të unjësuar, pa marrë parasysh se kishte dallime midis tyre në disa çështje dytësore të Sheriatit.

Ai që përcaktohet në mënyrë ekstreme vetëm për një imam (jurist), i ngjason atij që përcaktohet vetëm për një sahab, si p.sh. rafiditi përcaktohet vetëm për Aliun e i refuzon tre halifët tjerë, ndërkaq harixhiti i kritikon Uthmanin dhe Aliun r.a. Këta janë risimtarë dhe këta qortohen nga Kur'ani, Sunneti e Ixhmai (konsensusi) ngase devijojnë nga Sheriati dhe nga rruga të cilën ia shpalli Zoti Pejgamberit a.s. Vetvetiu kuptohet se ai që përcaktohet në mënyrë ekstreme vetëm për një imam, dyshon në të tjerët, qoftë i përcaktuar për Malikin, Shafi'iun, Ebu Hanifen, Ahmedin apo për të tjerët. Një qëndrim i tillë vërteton edhe paditurinë e ekstremistit, ndërkaq dihet se Zoti i Madhëruar ka urdhëruar diturinë e drejtësinë dhe ka ndaluar paditurinë e dëmin:

"Ne ua ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; vërtet ai i bëri padrejt vetes dhe ishte i padijshëm."

(Ahzabë, 72).

Ebu Jusufi dhe Muhamedi ishin përcjellësit më të mëdhej të Ebu Hanifes se çdokush tjetër, mirëpo përsëri e polemizonin në shumë çështje ngase e përcillnin Sunnetin dhe argumentin.

Edhe pse këta dy mendonin ndryshe, përsëri kishin respekt të thellë ndaj imamit të tyre. Për shkak të dallimeve të tyre ata nuk konsideroheshin "të luhatshëm", madje edhe vetë Ebu Hanifeja e imamët tjerë i kanë ndërruar mendimet e veta kur janë ballafaquar me argumente por nuk janë quajtur "të luhatshëm". Njeriu gjithmonë kërkon diturinë dhe kur zbulon diçka të fshehtë, e ndjek dhe nuk konsiderohet "i luhatshëm" por përkundrazi, i udhëzuar nga Zoti i Madhëruar. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"Dhe thuaj: "O Zot, ma shto diturinë!"

Çdo musliman është i obliguar që ta kërkojë të vërtetën dhe ta pranojë aty ku e gjenë. Ai gjithashtu duhet ta dijë se kush e qëllon ka dy shpërblime, e kush gabon vetëm një shpërblim, për shkak të ixhtihadit. Besimtarët obligohen ta përcjellin imamin e tyre, edhe atë duke u mbështetur në hadithin e Pejgamberit a.s.: "Imami është caktuar për të udhëhequr", dhe pa marrë parasysh se ai i ngrit duart lartë apo jo në namaz, namazi nuk prishet as sipas Ebu Hanifes e Shafi'iut e as sipas Malikit e Ahmedit. Në qoftë se xhemati nuk i ngre duart lart ashtu siç i ngre imami, namazi nuk prishet. Askush nuk obligohet që t'i pranojë fjalët e ndonjë dijetari si regull e përhershme.

Përçarjet dhe fitnet u shtuan aq shumë në vendet e Lindjes për shkak të tatarëve, saqë ithtari ekstremist i Shafi'ut ka kundërshtuar edhe ithtarin e medhhebit të Ebu Hanifes. Kështu ka ndodhur edhe me ithtarët e medhhebeve tjera. Pra, e gjithë kjo konsiderohet përçarje, të cilën e kanë ndaluar edhe Zoti i Madhëruar edhe Pejgamberi a.s.

Ata të cilët i përcjellin paragjykimet dhe pasionet devijojnë nga udhëzimi i Zotit dhe e meritojnë dënimin nga Ai. Si mund të përkufizohet çështja dytësore kur në të ekzistojnë horizonte të gjera!

EKSTREMIZMI KUNDËR MEDHHEBEVE DHE IMAMËVE

Në qoftë se qëndrimi ekstrem ndaj medhhebeve apo fjalëve të imamëve - siç ishte evident në kohën e imitimit dhe fanatizmit medhhebor - është i urrejtur, gjithashtu urrehet e ndoshta edhe më shumë edhe qëndrimi ekstrem kundër medhhebeve dhe imamëve në përgjithësi, me pretekst se një gjë e tillë e kundërshton Sunnetin!!

Këto qëndrime i vërejmë te disa njerëz në këtë kohë. Këta njerëz si paraprijëse të tyre nga dijetarët muslimanë e kanë vetëm ashpërsinë e Ibën Hazmit, e cila mund të krahasohet me shpatën e Haxhaxhit. Njerëzit e tillë gjithashtu mundohen të fërkohen në shejhul islamin, Ibën Tejmijje, mirëpo qëndrimet e tij janë të njohura për të gjithë.

Në librin *"Ref'ul melam anil - e immetil - ea'lam"*, Ibën Tejmijje thotë: "Muslimanët duhet ta respektojnë Zotin, Pejgamberin dhe besimtarët ashtu siç udhëzon Kur'ani, posaçërisht dijetarët që konsiderohen trashëgimtarë të pejgamberëve dhe të cilët i trajton Zoti si urë orientimi gjatë errësirave në tokë e në det. Të gjithë muslimanët e pranojnë udhëzimin dhe diturinë e tyre".

Pastaj vazhdon e thotë: "Ata janë pasardhësit e Pejgamberit në ummetin e Tij, e ringjallin Sunnetin aty ku ka vdekur, e hulumtojnë Kur'anin. Dihet se askush nuk pranon ndonjë fjalë të imamit në qoftë se nuk përputhet me parimet e Sunnetit të Pejgamberit a.s. Ata të gjithë janë unanimë se duhet të respektohen fjalët e Pejgamberit a.s. kurse fjalët e të tjerëve mund të merren dhe mund të refuzohen. Në qoftë se ndokush gjen ndonjë hadith autentik që jep mendim të kundërt, duhet të pranohet, e nëse jo, atëherë duhet të ketë arsye të fortë. Arsyet e tilla të forta ndahen në tre lloje:

1. Mosbindja se Pejgamberi a.s. e ka thënë një gjë të tillë.

2. Mosbindja se ato fjalë (ai hadith) nuk kanë të bëjnë me atë çështje

3. Bindja se parimi i tillë është shfuqizuar.

Këto tri lloje të arsyeve ndahen në shumë shkaqe, e shejhul-islami, Ibën Tejmijje, i ka numëruar dhjetë sosh në formë të hollësishme!

"Këto dhjetë shkaqe janë të dukshme. Në shumë hadithe i lejohet dijetarit të mos punojë sipas tyre, në qoftë se ka argument e të cilin nuk e kemi arritur ne. Horizontet e diturisë janë të gjera e ne nuk kemi depërtuar në të gjitha thellësitë e dijenisë së dijetarëve. Dijetari herë e zbulon

argumentin e tij e herë jo, e kur e zbulon, mund të arrijë tek ne ose jo. Kur të arrijë, atëherë mund ta kuptojmë apo të mos e kuptojmë argumentin e tij, qoftë argumenti i saktë apo jo.

Në qoftë se ndodh ndonjë rast i tillë konkret te ndonjë dijetar, nuk duhet të akuzohet se e lejon të ndaluarën apo vendos me diçka që nuk është shpallur nga Zoti. Në qoftë se në hadithet e tilla ka mallkim, hidhërim apo dënim, nuk duhet të thuhet se dijetari i cili lejon diçka të tillë ka ndërhyrë në dënim.

Sipas njohurive tona, askush nga ummeti nuk ka vepruar kështu përveç disa mu'tezilitëve nga Bagdadi, si p.sh., Murejsi dhe bashkëmendimtarët e tij, të cilët mendonin se muxhtehidi që gabon dënohet për gabimin e bërë.

Ai që ka jetuar në shkretëtirë apo që është i ri në Islam apo nuk e di se diçka është e ndaluar, nuk bën mëkat dhe nuk dënohet. Në ajetin kur'anor thuhet:

"(Përkujto) Davudin e Sulejmanin kur pleqëronin për çështjen e bimës (mbjelljes) të cilën delet e atij populli e kishin kullotur natën, e Ne ishim përcjellës të gjykimit të tyre. E Sulejmanit Ne ia mësuam atë (përgjigjen e saktë), po secilit (prej tyre) u patëm dhënë urtësi e dije. Ne bëmë që kodrat dhe shpezët të madhërojnë (bëjnë tesbih) së bashku me Davudin. Ne kemi mundësi (ta bëjmë këtë) dhe e bëmë".

(Enbija, 78, 79).

Këtu dallohet Sulejmani me virtytin e të kuptuarit, ndërsa të dy theksohen si dijetarë e të urtë.

Në të dy *"Sahihët"* transmetohet nga Amër ibën Asi se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Në qoftë se ia që-llon muxhtehidi, ka dy shpërblime, e në qoftë se gabon, një".

Këtu, pra, shihet qartë se gabimi i falet muxhtehidit, ngase është e pamundshme të qëllohet e kërkuara në të gjitha dispozitat e kërkuara. Lidhur me këtë Zoti i Madhëruar thotë: "Nuk ju ka bërë vështirësi në fe", apo në një ajet tjetër: "Zoti ju dëshiron lehtësim e jo vështirësim".

Në të dy *"Sahihët"* transmetohet se Pejgamberi a.s. në ngjarjen e Hendekut ka thënë: "Të mos e falë ndokush namazin e iqindisë përpos në Beni Kurejdha". Kur i ka zënë iqindia në rrugë, disa e kanë falur në rrugë e disa kanë pritur derisa kanë arritur te Beni Kurejdha, mirëpo asnjëri prej tyre nuk është qortuar".

Në këtë çështje mendimet e dijetarëve janë të ndryshme, gjegjësisht në çështjen se a mund të përkufizohet e përgjithshmja me analogji? Sidoqoftë, ata që u falën në rrugë ishin më të saktë.

Të gjithë e refuzojnë thënien se imitimi ndalohet për të gjithë njerëzit dhe se ixhtihadi është obligim për të gjithë, madje edhe për masën e rëndomtë.

Si mund të pranohet një gjë e tillë kur dihet se për ixhtihad parashihen kushte nga ana e usulistëve, të cilat nuk i posedojnë shumë dijetarë, e për masën e rëndomtë të mos flitet fare ngase në mesin e tyre ka afro 85 për qind të huaj që s'e dinë gjuhën arabe!

Si të kërkojmë prej njeriut të rëndomtë të bëjë ixhtihad kur nuk e kupton as ixhtihadin e pjesërishëm, qoftë edhe në një çështje?!

Ne obligohemi vetëm me atë që mund ta kryejmë, e në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"All-llahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij."

(Bekare, 286).

Refuzohet mendimi se medhhebet i kanë përçarë muslimanët, ngase dallimet në çështjet dytësore nuk e dëmtojnë unitetin e muslimanëve. Kanë ekzistuar dallime midis sahabëve, tabi'inëve e imamëve por nuk i kanë dëmtuar fare.

Supozimi se vetëm Kur'ani apo hadithi mjaftojnë për anulimin e dallimeve dhe për mbrojtjen e unitetit të të gjithë muslimanëve, ashtu siç mendon shkolla bashkëkohore tradicionale (e që unë e quaj neoeksternalist), nuk është i realtë, e për këtë kam folur në shkrimet e mia, e më konkretisht në librin tim *"Rizgjimi islam ndërmjet kundërshtimit dhe ekstremizmit",* ku them: "Në kohën tonë njohim njerëz që orvaten e që i nxisin edhe njerëzit tjerë duke supozuar se mund t'i bashkojnë njerëzit me punën që e bëjnë dhe të gjithë të përfitojnë kompaktësi në mendime, ashtu siç e kuptojnë tekstet e Sheriatit, dhe kështu do të zhduken medhhebet, do të anulohet mosmarrëveshja dhe të gjithë do të kenë fjalën e përbashkët".

Këta harrojnë se mendimi i tyre mund të jetë i gabuar, ashtu siç mund të jetë i saktë, ngase nuk ka dijetar të mbrojtur (nga gabimi, - përkthyesi) pa marrë parasysh se i plotëson kushtet e ixhtihadit. Krejt ajo që është garantuar për këtë është shpërblimi në rast të saktësisë apo gabimit.

Kështu, krahas medhhebeve të njohura, këta formojnë medhheb të ri!

Është për t'u çuditur se këta përderisa kundërshtojnë imitimin e imamëve, kërkojnë që njerëzit t'i imitojnë e t'i ndjekin.

Mos mendoni se unë mohoj thirrjen e tyre në përcjelljen e teksteve kur'anore apo ixhtihadin e tyre për t'i kuptuar, ngase kjo është e drejtë e çdo muslimani që i plotëson kushtet e ixhtihadit. Askush s'ka të drejtë ta mbyllë derën të cilën e ka hapur Pejgamberi i Zotit për ummetin.

Unë e kundërshtoj reagimin e tyre ndaj metodave të dijetarëve të ummetit, nënçmimin e fikhut të trashëguar, deklaratat e tyre se vetëm ata kanë të drejtë kurse të tjerët gabojnë apo janë në humbje dhe bindjen e tyre se mund t'i anulojnë dallimet e t'i bashkojnë të gjithë njerëzit në një fjalë të përbashkët.

Këto janë fjalë të tyre!

Njëri nga studentët e sinqertë dhe ithtar i kësaj shkolle (Shkolla e një mendimit), më pyeti: "Pse nuk bashkohen të gjithë rreth mendimit që mbështetet në tekstin (kur'anor)?.", e unë iu përgjigja: "Obligohen të gjithë ta pranojnë tekstin që është autentik, që ka kuptim të qartë dhe që nuk kundërshtohet me tekstet e pjesërishme të Sheriatit apo me parimet e përgjithshme që janë të një rangu apo më të forta.

Teksti mund të jetë autentik te ndonjë imam por i dobët te një tjetër; mund të jetë autentik por pa domethënie të qartë; për njërin mund të jetë i përgjithshëm e për tjetrin i posaçëm; për ndonjë imam është absolut e për ndonjë tjetër i kushtëzuar; për ndonjërin është vaxhib e për ndonjërin mustehab (i preferuar) apo mekruh (i urrejtur); për disa mund të jetë i qartë e për disa i shfuqizuar... Këto çështje dhe shumë sosh i përmendte shejhul-islami, Ibën Tejmijje, në librin e tij *"Ref'ul-melam anil-immetil-e'alam"*, dijetari musliman Velijjull-llah Dehlevi në librin *"Huxhxhetull-llah el-baliga' dhe në traktatin "El-insaf fi esbabil-ihtilaf"*, si dhe dijetari i njohur shejh Ali El-Hafifi në librin *"Esbabu ihtilafil-fukahai"*.[102]

[102] Rizgjimi islam ndërmjet kundërshtimit dhe ekstremizmit, f. 162-164.

Ndoshta mendimi më korrekt rreth imitimit dhe përcaktimit medhhebor është ai i martirit Hasan El-Benna, (Zoti e mëshiroftë), i cili në *"Njëzet parimet"* e tij thotë: "Çdo musliman që nuk ka arritur shkallën e të kuptuarit (zgjedhurit) të argumenteve të parimeve të Sheriatit obligohet që të përcjellë ndonjë imam nga imamët e fesë, preferohet për të që t'i njohë argumentet e imamit të vet aq sa ka mundësi, ta pranojë udhëzimin e tij që mbështetet në argumente..., dhe ta shtojë diturinë (në qoftë se është njeri i shkencës) derisa ta përfitojë gradën e analistit".[103]

Kjo është deklaratë mesatare (objektive) ngase nuk i obligon të gjithë me imitim ashtu siç thonë madje edhe për dijetarët ekstremistët medhhebistë, e as që i ndalon të gjithë, ashtu siç thonë ekstremistët jomedhhebistë. Ky e detajizon këtë çështje aq bukur saqë bën dallim midis dijetarëve dhe masës së rëndomtë që ua lejon atyre që nuk posedojnë aftësi të tilla. Ai thotë se duhet të pasohet ndonjë imam e jo të imitohet dhe termi *"pasim"* është më i preferuar se termi *"imitim"*. Ai nuk i përkufizon muslimanët vetëm me katër imamët por muslimani mund të ndjekë medhhebin e ndonjë sahabi, tabi'ini etj... Sidoqoftë, ndjekësi duhet t'i njohë argumentet e imamit të vet, posa-çërisht në rastet e paqarta, si dhe obligohet t'i pranojë edhe udhëzimet e të tjerëve që janë të mbështetura në argumente bindëse, nëse dalin nga ai që ka besim në diturinë dhe fenë e tij edhe nëse ato janë në kundërshtim me medhhebin e tij.

Shejhi këtu gjithashtu thekson se dijetarët nuk duhet të jenë përtacë por duhet të bëjnë përpjekje që t'i përkryejnë dhe thellojnë njohuritë e tyre rreth Kur'anit, Sunnetit, qëllimeve, burimeve (të jurisprudencës islame), gjuhës etj., derisa të përfitojnë gradën e ixhtihadit, qoftë edhe atë të pjesërishme.

---

[103] *"Risaletut - te'alim" - Traktati i udhëzimeve* si pjesë e traktateve të imamit martir Hasan El-Benna.

Ai që kërkon, gjen dhe ai që punon, përfiton!

Ne e kemi sqaruar pjesërisht këtë çështje në komentet tona të "Njëzet parimeve" të cilat i thekson imami martir Hasan El-Benna, (Zoti e mëshiroftë), dhe të cilat i konsideron si bazë për një të kuptuar të përbashkët të të gjithë atyre që punojnë për Islamin. InshAll-llah ky punim do të botohet në një libër dyvëllimor.

FANATIZMI NDAJ NJONJË GRUPI APO PARTIE

Gjithashtu duhet të kemi kujdes edhe nga fanatizmi ndaj ndonjë grupi, partie apo xhemati, gjegjësisht ndaj muslimanit i cili në raste të tilla i mbron ato pa marrë parasysh se a kanë të drejtë apo jo. Kjo i ngjason thënies së arabëve në kohën e xhahilijetit: "Ndihmoi vëllait tënd, qoftë dëmtues apo i dëmtuar", të cilën më vonë e ndryshoi Pejgamberi a.s. dhe ia dha karakterin që përputhet me parimet e Islamit.

Ky lloj fanatizmi nënkupton pranimin e cilësive që i ngjasojnë shenjtërisë apo mbrojtjes nga gabimet (përkryerjes), gjegjësisht çdo gjë që thuhet konsiderohet e vërtetë, çdo gjë që veprohet pranohet, çdo gjë që del prej tyre është e saktë, çdo gjë nga historia e tyre glorifikohet dhe të gjithë burrat e tyre (udhëheqësit) janë engjëj!

Kjo nuk është e vërtetë ngase çdo grup që është ngritur për ta mbrojtur e ripërtërirë Islamin në mendje, shpirt, jetë e shoqëri nënkupton vetëm një përpjekje të një kolektivi muslimanësh për t'i shërbyer Islamit dhe për ta lartësuar fjalën e tij. Përpjekjet e tilla mund të jenë të sakta e të gabuara, por gjithsesi të shpërblyera. Çdo muxhtehid merr atë që meriton dhe secili njeri shpërblehet sipas qëllimeve të veta.

Karakteristikë e këtij fanatizmi është se partia apo sekti vetëm lavdërohen kurse të tjerët ofendohen, për partinë thuhen vetëm fjalë miradie kurse të tjerët nënçmohen, qofshin edhe njerëz të diturisë e të veprës.

Islami e obligon muslimanin që të jetë i drejtë me atë që e don dhe me atë që e urren, që të punojë drejt, qoftë edhe në dëm të vetvetes, që të mos e shkelë të vërtetën në rast hidhërimi, që të mos pranojë mëkatin, që të mos e pengojë armiqësia nga dëshmia e drejtë. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfanjak, meqë All-llahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionet e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, All-llahu hollësisht di çka punoni".

(Nisaë, 135).

"O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini dro All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni!"

(Maide, 8).

Karakteristikë e këtij fanatizmi gjithashtu është të gëzuarit në rast të gabimit të të tjerëve, e ndoshta edhe ta rrah tupanin për këtë, por në anën tjetër i mbyll sytë para gabimeve të grupit apo xhematit të tij, e nëse i pranon ato mundohet t'i arsyeton ato dhe t'i mbron ato.

Karakteristikë e këtij fanatizmi gjithashtu është edhe trajtimi i formave organizative si forma adhurimi, të cilat në disa raste dominojnë mbi thirrjen islame dhe mbi interesin e ummetit islam me qëllim të qëndrimit sa më besnik ndaj tyre.

Këtu ekziston një botëkuptim jashtëzakonisht i gabuar ngase format organizative (mekanizmat dhe mjetet) ndryshojnë me ndryshimin e kohës, vendit dhe njeriut. Këto forma nuk janë (idhuj që adhurohen) e as synime finale siç po kuptohet kjo nga disa ekstremistë në rrespektimin e fraksionit (organizativ)!

FORMAT MORALE TË ÇLIRIMIT NGA FANATIZMI

Këtu vlen të përqëndrohemi në disa forma morale që realisht mund të na çlirojnë nga fanatizmi dhe t'i përkujtojmë, ngase përkujtimi është në dobi të besimtarëve, e këto janë:

Njeriu duhet të shikojë fjalën e jo folësin, të ketë guxim për vetëkritikë, ta pranojë gabimin, t'i pranojë me zemërgjerësi kritikat nga të tjerët, të kërkojë këshilla e mendime nga të tjerët, të shfrytëzojë diturinë dhe urtësinë e të tjerëve, të flasë mirë për atë që mendon ndryshe dhe ta

mbrojë në qoftë se akuzohet me ndonjë të pavërtetë ose në qoftë se sulmohet me ndonjë padrejtësi.

Të gjitha këto virtyte apo vlera kanë nevojë për shqyrtim, e një gjë të tillë do ta bëj në studimin tim të ardhshëm për *"Rizgjimin islam prej adoleshencës deri në pjekuri"*, dhe lus All-llahun e Madhëruar që ta përfundoj me sukses dhe sa më shpejtë!

PJESA E TRETË
TË MENDUARIT MIRË PËR TË TJERËT

Njëri nga parimet e rëndësishme morale për marrëdhënie të mira midis muslimanëve është të menduarit mirë për të tjerët dhe mosmarrja e qëndrimit të përhershëm negativ ndaj veprave e mendimeve të tyre. Pra, besimtari nuk duhet që ta pastrojë veten e t'i akuzojë të tjerët.

Zoti i Madhëruar e ndalon vetëlavdërimin:

"Ai di më së miri për ju edhe para se t'ju krijojë edhe kur e filloi krijimin tuaj nga dheu, e edhe kur ishit të fshehur në barqet e nënave tuaja, pra mos e lavdëroni veten, se Ai e di kush është më i ruajtur".

(En-Nexhmu, 32).

Ai i qorton hebrenjtë ngase e lavdëronin vetveten dhe pretendonin se janë fëmijë të Zotit dhe të preferuarit e Tij.

"A nuk ke kuptuar për ata që vlerësojnë vetveten? Jo, All-llahu vlerëson atë që do dhe nuk bën padrejt asnjë fije".

(Nisaë, 49).

Sipas disave nga selefi, besimtari më së shumti e kontrollon vetveten se çdo gjë tjetër. Ai asnjëherë nuk është tolerant në raste të tilla, nuk i arsyeton gabimet e veta, nuk e tepron në çështjet ndaj Zotit dhe nuk pakëson në të drejtat e robërve të Zotit.

Ai bën vepra të mira, është i devotshëm dhe thotë: "Frikësohem se Zoti ndoshta nuk m'i pranon përpjekjet e mia ngase Ai i pranon vetëm nga të devotshmit, e unë nuk di se a u takoj atyre apo jo!"

Ai u ndihmon krijesave të Zotit, posaçërisht vëllezërve të tij dhe aktivistëve që punojnë për t'i ndihmuar fesë së Zotit.

Pjesa më e madhëruar e besimit është të menduarit mirë për Zotin dhe për njerëzit, kurse e kundërta është të menduarit keq për Zotin dhe njerëzit. Të menduarit keq është ves i keq dhe për këtë shkak na e tërheqin vëmendjen Kur'ani e Sunneti që të kemi kujdes prej tij. Në thelb, muslimani duhet të mendojë mirë e të veprojë mirë, qoftë edhe atëherë kur e kaplon dobësia, me qëllim që aspekti pozitiv ta mbizotërojë atë negativ. Zoti i Madhëruar thotë:

"O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgojoni njëri-tjetrin".

(Huxhuratë, 12).

Këtu ka për qëllim dyshimin që nuk mbështetet në argumente faktike.

Pejgamberi a.s. thotë: "Kini kujdes nga dyshimi, ngase biseda më e rrejshme është ajo e dyshimit (e pabazuar në fakte)". (Transmetim unanim).

Kur dëgjon muslimani diç të keqe për vëllain e vet, obligohet që nga mendja e vet ta largojë para-gjykimin negativ dhe vetëm mirë të mendojë për të. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"E përse kur e dëgjuan atë (shpifje) besimtarët dhe besimtaret të mos mendonin të mirën si për vete dhe të thoshin: "Kjo është shpifje e qartë?!"

(Nurë, 12).

Dyshimi është ves prej të cilit vështirë çlirohet secili, madje edhe Pejgamberi a.s. lidhur me këtë thotë:

"Djalli lëviz në njeriun ashtu siç lëviz gjaku dhe frikohem që të mos mbjellë (gjuaj) në zemrat tua-ja të keqen". (Transmetim i Buhariut).

Kështu pra, muslimani nuk duhet të dorëzohet para djallit në këtë ves kundër muslimanëve, dhe duhet t'u ndihmojë atyre në vend që t'i ofendojë.

Njerëzit që bartin në vete këtë ves negativ do të jenë më të urrejturit dhe më larg Pejgamberit a.s. në Ditën e Gjykimit.

Edhe pse paragjykimet negative janë të shumta në mendjen e njeriut, ai duhet të bëjë përpjekje që t'i zëvendësojë me mendime pozitive. Në qoftë se ndokujt i ndodh diçka, të mos shpejtohet me akuzime ngase ndoshta ai ka ndonjë arsye të cilën ti nuk e di!

Duhet të kihet kujdes nga akuzimi i qëllimtë ngase fshehtësitë i di vetëm Zoti i Madhëruar, i cili e di të dukshmen e të padukshmen. Kësisoj janë të obliguar të gjithë muslimanët e të mos flasim për ata që janë aktivistë të Islamit, që e mbrojnë atë e që sakrifikojnë për të.

Ne habitemi kur vërejmë se aktivistët e Islamit e akuzojnë njëri-tjetrin për tradhti dhe vrapojnë pas laikëve e kundërshtarëve të Islamit. Ndonjëri akuzon kolegun e vet për tradhti e spiunim, për shkak se mendon ndryshe apo ka qëndrim tjetër. Ai që është i edukuar në frymën islame, nuk guxon të veprojë kështu. Politika e Sheriatit është e mirëseardhur dhe në të ekzistojnë dallime në mendime ngaqë vetë natyra e njerëzve është e ndryshme. Gjithmonë duhet t'i japim përparësi mendimit të mirë e të mos i pranojmë paragjykimet negative. Disa mendojnë se në periudhën e parë duhet të heshtet para sunduesit, e tjetri mendon se duhet të luftohet, sipas disave kundër-shtimi është politik e sipas disa të tjerëve ushtarak. Ndonjëri hyn në fushata zgjedhore e ndonjëri jo. Të gjitha këto obcione janë pjesë e ixhtihadit që nuk guxojnë ta cenojnë autoritetin e fesë e të bindjes së njerëzve. Zoti i Madhëruar i kritikon njerëzit e tillë, ashtu siç i kritikon idhujtarët:

"Po ata (idhujtarët) nuk ndjekin tjetër vetëmse paragjykimet dhe çka dëshirojnë vetë, megjithëqë prej Zotit të tyre u pat ardhur udhëzimi".

(Nexhm, 23).

"E nëse ata nuk të përgjigjen ty, atëherë dije se ata ndjekin vetëm dëshirat e veta, e kush është më i humbur se ai që duke mos patur fakt prej All-llahut, ndjek epshin e vet?"

(Kasas, 50).

Edhe pse pejgamberët kanë qenë të respektuar, Zoti i Madhëruar ua tërheq vërejtjen nga paragjykimi dhe pasionet:

Zoti i Madhëruar i thotë Davudit a.s.:

"O Davud, Ne të kemi bërë sundimtar në tokë, e ti pra gjyko me drejtësi midis njerëzve, e mos shko pas dëshirave se ato të shmangin prej rrugës së All-llahut".

(Sad, 26)

Në ajetin e shpallur në Mekke, Muhammedit a.s. i thotë:

"Pastaj Ne të vumë ty në një rrugë të drejtë të fesë, pra ti ndiqe atë e mos ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë".

(Xhathije, 18).

Në ajetin e shpallur në Medine përsëri i thotë:

"(Të zbritëm) që edhe ti të gjykosh me atë që ta zbriti All-llahu, e mos ndiq dëshirat e tyre dhe ruaju rrezikut të tyre, që mos të shmangin nga një pjesë e asaj që ta zbriti All-llahu".

(Maide, 49).

Sinqeriteti ndaj Zotit bashkon dhe unjëson kurse ndjekja e dëshirave përçan e shkapërderdhë.

E vërteta është një, kurse dëshirat janë aq sa ka njerëz.

Ndjekja e dëshirave dhe pasioneve personale e të të tjerëve, konsiderohet faktor kryesor i përçarjes së ummetit islam në fraksione e grupacione prej kohëve të mëhershme e deri më sot, dhe për këtë shkak selefi i ka quajtur njerëzit e tillë me emrin "ithtarë të epsheve" ngase ishin larguar nga rruga e drejtë. Në shumë raste dallimet kanë qenë jothelbësore dhe sipërfaqësore, mirëpo pasionet kanë ndikuar në shtimin dhe zgjerimin e tyre katastrofal.

Lusim Zotin që të na shpëtojë!

PJESA E KATËRT
MOSAKUZIMI I ATYRE QË MENDOJNË NDRYSHE

Njëri nga faktorët e afrimit dhe bashkimit është edhe mosakuzimi i atyre që mendojnë ndryshe, edhe atëherë kur mendon se ata gabojnë. Ndodh që ti të jeshë gabim e ata të kenë të drejtë, ngase në ixhtihad nuk ka vendim të prerë kategorik midis dy mendimeve përpos animit apo preferimit. Gjithashtu nuk guxon t'i akuzosh edhe nëse gabojnë, për shkak se në rastet e ixhtihadit gabimi falet, madje, sipas hadithit pejgamberik, njerëzit e tillë shpërblehen. Si të akuzohet e të qortohet rreth çështjeve për të cilat ka shpërblim nga Zoti i Madhëruar, qoftë edhe me një shpërblim?

Këtë metodë e zbatonin pjesëtarët e brezit të selefit gjatë dallimeve në ixhtihad, gjegjësisht ata nuk e akuzonin njëri-tjetrin por i respektonin mendimet e tyre.

SHEMBUJ NGA KULTURA E DIALOGUT MIDIS DIJETARËVE TË NJOHUR

Shembulli më i mirë i kulturës së dialogut është letra e shkëlqyeshme shkencore të cilën dijetari Lejth ibën Sa'd ia ka dërguar Imam Malikut, në të cilën i shkruan mendimet dhe qëndrimet e veta për çështje të shumta për të cilat Imam Maliku mendonte ndryshe. Ai i shënon mendimet e veta në një stil elegant e elokuent, ndërsa ne, për shkak të gjatësisë së letrës, do t'i veçojmë vetëm disa citate, me qëllim argumentimi për kulturën e tyre të lartë gjatë zhvillimit të dialogut.

Lejth ibën Sa'di thotë: "...Paqja qoftë mbi ty! Unë falënderoj All-llahun që është Zoti i vetëm, e pastaj Zoti na shpëtoftë neve dhe ty dhe na mëshiroftë në këtë botë e në botën tjetër. E pranova letrën tënde në të cilën më tregon për gjendjen tënde të mirë, u gëzova shumë dhe Zoti të mbroftë përgjithmonë!" Më tej thotë: "Je informuar se unë u jap njerëzve fetva të cilat nuk përputhen me të tuat. Unë frikohem për vetveten... Njerëzit i përcjellin medinasit ngase aty është bërë hixhreti, aty ka zbritur Kur'ani... Unë më së shumti e urrej atë dijetar që mbështetet në fetva e që del jashtë rregullave dhe më së shumti i respektoj dijetarët e Medines dhe i pranoj fetvatë e tyre.

Falënderimi i qoftë All-llahut, i cili s'ka shok!"

Më tej Lejth ibën Sa'di vazhdon dhe i sqaron dallimet midis mendimeve të tij dhe atyre të Imam Malikit, (Zoti e mëshiroftë), për natyrën argumentuese të medinasve. Ai thotë se shumë njerëz të formuar në shkollën e Pejgamberit janë shpërndarë në Lindje e në Perëndim për të bërë xhihad dhe për të sqaruar atë që e kanë mësuar nga Kur'ani i Zotit dhe Sunneti i Pejgamberit të Tij. Ai gjithashtu thekson se ka patur dallim mendimesh në mesin e tabi'inëve dhe pasardhësve të tyre, si

psh. Rebi'a ibën Ebi Abdurrahmani, dhe pasi që i kritikon disa mendime të tij, thotë: "Nga Rebia ka dobi të mëdha, mendje të shkathët, gjuhë elokuente, vlera të mëdha, jetë të bukur islame dhe dashuri të sinqertë ndaj vëllezërve të tij në përgjithësi, e ndaj nesh në veçanti, Zoti e mëshiroftë, e faltë dhe e shpërbleftë me shpërblime të mira për atë që ka punuar!"

Pas kësaj ai vazhdon dhe i thekson pikat rreth të cilave ka ekzistuar dallimi midis mendimeve të tij dhe të Malikit, si p.sh., gjykimi me dëshmitar dhe betim; falja e namazit para hutbes në kohën e istiskasë, etj., dhe në fund të letrës thotë: "Ka edhe shumë gjëra të tilla të cilat nuk i kam cekur... Zoti të ndihmoftë e jetofsh gjatë, për të patur njerëzit dobi prej teje! Unë pikëllohem kur humbim njerëz si ti... Kështu të respektoj dhe kështu mendoj për ty... Mos ngurro të më informosh për vetveten, për gjendjen tënde dhe të familjes tënde, për ndonjë nevojë në rast se ke. E tërë kjo shumë do të më gëzojë...!

Paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi ty".[104]

Më vjen keq që sot hasim në aktivistë të thirrjes në Islam, që i akuzojnë ata që mendojnë ndryshe, me besim të dobët, me ndjekjen e pasioneve, me risi, me devijim, me hipokrizi, madje edhe me kufër!

Shumica prej këtyre nuk kënaqen vetëm me akuza sipërfaqësore por edhe me ato thelbësore. Këta i akuzojnë qëllimet dhe fshehtësitë të cilat i di vetëm All-llahu i Madhëruar, ashtu sikur të kenë depërtuar në thellësitë e zemrave të tyre dhe t'i kenë parë fshehtësitë e tyre! Nga gjuha e tyre gati nuk ka shpëtuar ndokush nga të vjetrit apo nga bashkëkohanikët tanë të cilët nuk mendojnë siç

[104] Shiko letrën e plotë në *"E'alamul-muwekki'in"*, 3/83-88.

mendojnë ata për disa çështje, madje disa prej tyre i kanë ofenduar katër imamët e fikhut e disa të tjetër, imamët e zuhdit dhe të sjelljes.

Pra, njerëzit e tillë i akuzojnë të gjithë ata që mendojnë ndryshe apo që i përkasin medhhebit tjetër në besim e në fikh. Ata që merren me hadith i akuzojnë katër fukahatë e njohur dhe ithtarët e tyre, të cilët janë të njohur me diturinë, ixhtihadet, besimin dhe devotshmërinë e tyre.

Këta gjithashtu i akuzojnë sufistët e dalluar, që janë të respektuar nga dijetarët e njohur të ummetit e madje shkojnë edhe deri mohimi i sufizmit tanësisht. Këta ndonjëherë i akuzojnë edhe imamët e njohur esh'aritë, të cilët gëzojnë autoritet në njohuritë e tyre në mbrojtje të fesë, Kur'anit e Sunnetit.

Shiko qëndrimin e imam Ibën Kajjimit ndaj shejhul-islamit, Herevi Ensarit, autor i veprës "Menazilus - sa'irin ila mekamati - ijjake na'budu ve ijjake neste'in", të cilin e ka komentuar në një vepër tjetër me titull "Medarixhus-Salikin". Ibën Kajjimi edhe pse mendon ndryshe nga Ensari për shumë çështje, përsëri për të thotë fjalë miradie dhe e vlerëson diturinë, moralin dhe autoritetin e tij.

Edhe pse e sqaron konceptin e gabuar të Ensarit për "pendimin", Ibën Kajjimi përsëri thotë se nuk duhet të cenohet autoriteti i tij në shkencë, njohuri, sjellje..."[105]

[105] Shiko: *"Medarixhus-salikin",* vëll. 1, f. 196-198, botim i Darus-sunnetil-muhammedijjeti.

Disa fetarë gabojnë kur i akuzojnë njerëzit e njohur në fe e shkencë vetëm për shkak të ndonjë gabimi eventual, dhe kështu ua shkatërrojnë tërë kontributin të cilin e kanë dhënë gjatë tërë jetës dhe e njollosin jetëshkrimin e tyre në tërësi.

Sikur të sillej Zoti me robërit e vet ashtu siç sillen këta me të tjerët, përveç pejgamberëve askush nuk do të shpëtonte nga shkatërrimi në këtë botë dhe nga dënimi në botën tjetër, mirëpo Ai në këtë kontekst thotë:

"Çfarëdo e keqe që mund t'ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai falë".

(Shura, 30).

"Nëse largoheni prej mëkateve të mëdha, të cilat u janë të ndaluara, Ne ua shlyejmë mëkatet e vogla dhe ju fusim në një vend të ndershëm".

(Nisaë, 31).

Ai kështu i përshkruan robërit e Tij.

"Ata që largohen prej mëkateve të mëdha dhe prej punëve të ndyta, përpos ndonjë pune të imët, s'ka dyshim se Zoti yt është që gjerësisht përfshin me falje, se Ai di më së miri për ju edhe para se t'ju krijojë, edhe kur e filloi krijimin tuaj nga dheu e edhe kur ishit të fshehur në barqet e nënave tuaja, pra mos lavdëroni veten, se Ai e di kush është më i ruajtur".

(Nexhm, 32).

Zoti i gjykon njerëzit sipas veprave të tyre si dhe i shton shpërblimet e jo dënimet:

"S'ka dyshim se All-llahu nuk bën padrejt as sa grimca, e nëse ajo vepër është e mirë, Ai e shumëfishon atë dhe Vetë Ai i jep shpërblim të madh!"

(Nisaë, 40).

Pejgamberi a.s. thotë: "Të gjithë njerëzit gabojnë, e gabimtarët më të mirë janë ata që pendohen".[106]

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë: "Pasha Atë në duart e të cilit është shpirti im, sikur të mos bënit mëkat, Zoti do t'ju zhdukte dhe do të sillte njerëz që bëjnë mëkat dhe që kërkojnë falje nga Zoti, e Ai ua falë".[107]

Nga ngjarjet e tilla është edhe rasti i Hatib ibën Ebi Belte'as (r.a.) para Betejës së Çlirimit (të Mekkes) kur ka dashur t'u dërgojë një letër mekkasve e t'i informojë për përgatitjen e Pejgamberit që t'i luftojë, e Pejgamberi a.s. dëshironte t'i befasonte ashtu që të ketë sa më pak viktima. Hatibi e ka dërguar letrën përmes një gruaje që shkonte në Mekke, dhe kur e ka zbuluar Aliu r.a., Umeri r.a. ka thënë: "O Pejgamber i Zotit, më lejo t'ia pres kokën (Hatibit) ngase ka tradhtuar!" Pejgamberi a.s. ka refuzuar një gjë të tillë dhe ka thënë: "Çka dinë ti o Umer, ndoshta All-llahu u është drejtuar pjeësmarrësve të luftës së Bedrit dhe u ka thënë: veproni çka të doni se Unë u kam falur juve"[108]. Nga kjo nënkuptohet se aktivitetet e mëparshme kanë ndikuar në faljen e këtij sahabiu, edhe pse ajo që ka vepruar konsiderohet tradhti e madhe.

---

[106] Transmetim i Ahmedit, Tirmidhiut, Ibën Maxhes dhe Hakimit nga Enesi; transmetohet edhe në *"Sahihul-xhami'is-sagir"* (4015).

[107] Transmetim i Ahmedit dhe i Muslimit nga Ebu Hurejreja si dhe në *"Sahihul-Xhami'is-sagir"* (7074).

[108] Transmetim i Buhariut.

Nga fjalët e urta është edhe transmetimi i Ebu Davudit në sunenin e tij nga juristi i njohur Mu'adh ibën Xhebeli (r.a.), i cili thotë: "Kini kujdes nga risia ngase risia është humbje! Ua tërheq vërejtjen nga devijimi i dijetarit ngase djalli mund të shkaktojë që dijetari të flasë të pavërtetën e hipokriti të vërtetën![109]

Me këtë rast vlen të theksohet thënia e Mu'adhit se njeriu nuk duhet të akuzohet për gjëra të tilla ngase mund të përmirësohet, dhe se njeriu nuk duhet të zhvlerësohet për ndonjë fjalë goje të pavërtetë.

Parim konkret është e vërteta se gabimi i falet ummetit ashtu siç i falet harresa. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

"Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë!"

(Bekare, 286).

Pejgamberi a.s. e vërteton një gjë të tillë dhe thotë: "All-llahu ia falë ummetit gabimin, harresën dhe veprën të cilën është i detyruar ta bëjë!"[110]

Zoti i Madhëruar thotë:

---

[109] Transmetim i Ebu Davudit në *"Kitabus-sunneti"* (2611).

[110] Transmetim i Ibën Maxhes në Sunnenin e tij (2040), i Ibën Hibbanit në Sahihin e tij, i El-Mevarid (1498) dhe i Hakimit. Është bërë *"sahih"* sipas kushteve të Buhariut e Muslimit dhe e ka pranuar Dhehebiu (2/198) e Bejhekiu në Sunen (7/356) nga Ibën Abbasi. Ekzistojnë edhe rrugë tjera të këtij hadithi.

"Nuk është ndonjë mëkat i juaji ajo për çka keni gabuar, por (është mëkat) ajo që zemrat tuaja e bëjnë qëllimisht, po All-llahu është që falë, është mëshirues."

(Ahzabë, 5)

"All-llahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij".

(Bekare, 286).

Ai që përpiqet e hulumton për ta arritur të vërtetën dhe gabon nuk ka mëkat, ngase, në të kundërtën, do të obligohet përtej mundësive të tij dhe do të kundërshtohet me ajetin kur'anor:

"Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën ne nuk kemi fuqi!

PJESA E PESTË
LARGIMI NGA QËNDRIMET KATEGORIKE E ARMIQËSORE

Faktor i rëndësishëm në afrimin e dallimeve në mendime është edhe largimi nga qëndrimet kategorike e armiqësore.

Islami i cili urdhëron që polemikat të zhvillohen në formën më të bukur, e qorton njeriun i cili orvatet të ngadhënjejë në çfarëdo mënyre, pa u mbështetur në korrektësi e logjikë të shëndoshë. Kur'ani e kritikon mendjemadhësinë e idhujtarëve dhe të pabesimtarëve.

"E ka ndonjë prej njerëzve që bën polemikë rreth çështjes së All-llahut, duke mos patur kurrfarë dije, kurrfarë udhëzimi dhe kurrfarë libri të besueshëm. Ai që shtrembëron qafën (në shenjë mendjemadhësie), e përpiqet t'i humbë njerëzit nga rruga e All-llahut, atij do t'i takojë poshtërimi në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kijametit atij do t'ia veshim dënimin e djegies të (zjarrit)".

"E megjithatë, ata që nuk besuan polemizojnë me të pavërtetën, në mënyrë që me të ta mbizotërojnë të vërtetën dhe argumentet e Mia, dhe atë me çka i qortuam i marrin për tallje". (Kehf, 56).

"A nuk ke arritur të dishë për atë që përse All-llahu i kishte dhënë pushtet: Ai (Nemrudi) polemizoi me Ibrahimin rreth Zotit të tij. Kur Ibrahimi tha: "Zoti im është Ai që jep jetë e vdekje!", e ai tha: "Edhe unë jap jetë dhe vdekje!". Ibrahimi tha: "Zoti im e sjell diellin nga Lindja, sille pra ti atë nga Perëndimi?" Atëherë ai që nuk besoi mbeti i hutuar. All-llahu nuk e shpie në rrugë të drejtë popullin mizor".

(Bekare, 258).

Mendjemadhi dhe tirani në fjalë pretendon se ka mundësi të japë jetë e vdekje, ngase dënon disa njerëz me vdekje. Kur ua falë, u thotë: "Unë u jap jetë", dhe kur i dënon, u thotë: "Unë ju jap vdekjen!" Përkufizimi i tij i jetës dhe i vdekjes dallon nga ai i Ibrahimit a.s. i cili thotë: "Ai që jep jetë e vdekje!"

Gjithashtu edhe hadithet e Pejgamberit a.s. e urrejnë një gjë të tillë, i qortojnë dhe i urdhërojnë njerëzit që të largohen prej saj.

Ebu Umameja transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

"Një popull humb pas udhëzimit në qoftë se mbështetet në polemikë", dhe pastaj e ka lexuar:

"Ata nuk ta thanë atë vetëm si polemikë, por ata janë njerëz ngatërrestarë".

(Zuhruf, 58).[111]

Ky fenomen është evident te popujt të cilët largohen nga puna dhe zhvillojnë vetëm polemika, ngase natyrën e tyre nuk e ka edukuar imani (besimi):

"Në këtë Kur'an Ne shtruam çdo lloj shembulli për hir të njerëzve, por njeriu (jobesimtar) më shumë se çdo tjetër është kundërshtar".

(Kehf, 54).

Ne vërejmë se në botën islame ka njerëz të cilët zhvillojnë vetëm polemika dhe të cilët dëshirojnë që edhe të tjerët të mendojnë ashtu siç mendojnë ata. Njerëzit e tillë mendojnë se gjithmonë kanë të drejtë kurse të tjerët gjithmonë gabojnë, madje disa kanë krijuar terminologji të posaçme dhe ua imponojnë të tjerëve. Ky qëndrim i tyre kundërshton parimin e dijetarëve tanë se "nuk ka koprraci në terminologji".

Ekzistojnë njerëz të cilët kritikojnë përcaktimin ekstrem në ndonjë medhheb në një anë, ndërsa në anën tjetër formojnë medhheb të ri dhe i sulmojnë ata që mendojnë ndryshe.

Sulmohet imitimi, ndërkaq kërkohet prej njerëzve t'i imitojnë!?

Ndalohet imitimi i të kaluarve, ndërkaq imitohen disa njerëz bashkëkohorë!?

---

[111] Transmetim i Tirmidhiut në kapitujt e tefsirit të Kur'anit (3250) dhe thotë se është hadith *"hasen sahih"*.

Ai që zhvillon polemika rreth çështjeve sekondare apo të pjesërishme, nuk mund të formojë relacione të shëndosha.

Pra, mendjemadhësinë dhe qëndrimin kategorik në mendime e qortojnë edhe Zoti i Madhëruar edhe Pejgamberi a.s.

Nga Aisheja (r.a.) transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë:

"Ndër njerëzit më të urrejtur te Zoti është kundërshtari kryeneç[112] (që dëshiron të dominojë në çdo polemikë)".

Kur i qorton Zoti idhujtarët rreth çështjes së Kur'anit, u thotë:

"Ne e bëmë atë (Kur'anin) të lehtë me gjuhën tënde, vetëm që me të t'i përgëzosh të devotshmit dhe me të t'i tërheqish vërejtjen një populli që është kryeneç".

(Merjem, 97).

Ai gjithashtu për idhujtarët kurejshitë thotë:

"Ata nuk ta thanë atë vetëm si polemikë, por ata janë njerëz ngatërrestarë".

(Zuhruf, 58).

Kur'ani kritikon disa kategori njerëzish.

[112] Transmetim i Muslimit në Librin *"El-ilmu",* (2668).

"Ka ndonjë nga njerëzit që fjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë (ngaqë në botën tjetër gjykon Ai që i di të fshehtat), dhe për atë që ka në zemrën e tij e paraqet All-llahun dëshmues, e në realitet, ai është kundërshtari më i rreptë".

(Bekare, 204).

Kundërshtimi më i urrejtur është ai që zhvillohet rreth Kur'anit, të cilin e zbriti All-llahu për t'i udhëzuar njerëzit, e sikur të shkaktonte përçarje, atëherë çfarë rëndësie do të kishte udhëzimi? Për këtë shkak edhe Pejgamberi a.s. hidhërohej pa masë kur dëgjonte polemika të rrepta rreth Kur'anit.

Abdullah ibën Umeri (r.a.) transmeton se një ditë ka shkuar herët te Pejgamberi a.s. dhe kur dëgjon se dy njerëz polemizonin me zë të lartë rreth një ajeti aq sa kishin rënë në konflikt, del me një hidhërim të dukshëm në fytyrën e tij dhe u thotë: "Ata që jetuan para jush u shkatërruan për shkak të polemikave rreth librit (të shpallur)".[113]

Neveviu sqaron se "shkatërrimi ka qenë pasojë e konflikteve rreth çështjeve fetare".[114]

Gjithashtu në një transmetim të Abdullah ibën Umerit thuhet se rreth atyre që bien në konflikt nga polemika, Pejgamberi a.s. ka thënë: "Ata që jetuan para jush për këtë u shkatërruan; ata krijonin kundërthënie në Librin e Zotit, ndërsa Libri i Zotit është shpallur për të konfirmuar! Mos

[113] Transmetim i Muslimit në librin *"El-Ilmu",* (2666).
[114] Komentimi i Neveviut në Sahihin e Muslimit 16/218, botim i *Darul-Kutubil-ilmijje*.

gënjeni por thuani vetëm atë që e dini, e nëse nuk e kuptoni, mbështetuni në atë që e kupton atë".[115]

Në disa transmetime thuhet se ata kanë rënë në konflikt nga polemikat rreth Kaderit (problemi i determinizmit dhe indeterminizmit), edhe atë duke u mbështetur në ajete.[116]

Në një transmetim thuhet: "Disa thanë: "A nuk e ka thënë Zoti këtë dhe këtë?, E disa të tjerë thanë: "A nuk e ka thënë Zoti këtë e këtë?"

Në një transmetim tjetër thuhet se një ditë Ibën Umeri dhe vëllai i tij kanë kaluar afër një grupi të sahabëve të Pejgamberit a.s. dhe i kanë dëgjuar se si zhvillojnë polemika rreth një ajeti kur'anor, dhe pas një kohe janë konfrontuar dhe i kanë ngritur zërat e tyre, saqë në atë rast del Pejgamberi a.s. me fytyrë të skuqur nga hidhërimi, i gjuan me dhe e u thotë: "Ngadalë, o popull! Për këtë janë shkatërruar popujt para jush! Ata kanë polemizuar rreth pejgamberëve të tyre dhe kanë shkaktuar kundërthënie në librat (e shpallur). Kur'ani nuk është shpallur që t'i përgënjeshtrojë ajetet njëri me tjetrin, por që t'i konfirmojë. Veproni sipas asaj që e dini, e në qoftë se nuk e dini, mbështetuni në atë që e di!"[117]

---

[115] Transmetim i Ahmedit në *Musned* (6741), Shakiri thotë se ka sened autentik, kurse Buhariu e transmeton në librin *"Halkul-ef'al",* f. 78. Këtë e transmeton Amër ibën Shuajbi nga babai dhe gjyshi i tij.

[116] Shiko *Musnedin* (6846), Shakiri e bën *"sahih"* senedin e tij.

[117] Në *Musned* (6702), 1/174, 175. Shakiri thotë se ka *"sened sahih"*.

PJESA E GJASHTË
ZHVILLIMI I DIALOGUT NË FORMËN MË TË MIRË

Parimi kryesor në kulturën e dialogut është zhvillimi i dialogut në formën më të mirë e më të bukur. Dialogu i tillë është edhe imperativ kur'anor.

"Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira".

(Nahl, 125).

Këtu vërehet qartë dallimi midis asaj që kërkohet nga këshilla e mirë dhe asaj nga polemika e zhvilluar në mënyrën më të mirë. Në qoftë se ekzistojnë dy mënyra, e njëra është më e mirë, atëherë duhet të aplikohet ajo më e mira.

Fshehtësia e dallimit të tillë ekziston në faktin se këshilla ka të bëjë me njerëzit bashkëmendimtarë që kanë nevojë vetëm për rikujtime, për zbutje të zemrave dhe për përforcim të bindjes së tyre, kurse polemika si zakonisht zhvillohet me njerëzit që mendojnë ndryshe, dhe në këtë rast, dialogu i ashpër mund të ketë pasoja negative, dhe ky ishte edhe shkaku kryesor që Kur'ani të urdhërojë aplikimin e polemikës më të mirë. Karakteristikë e kësaj metode është zgjedhja e fjalëve më të buta dhe më të përshtatshme në situatën e dhënë.

Kur u drejtohet Kur'ani hebrenjve dhe të krishterëve, u flet për afërsinë që ekziston midis tyre e muslimanëve dhe i quan "Ithtarë të Librit" ose "Të cilëve u është shpallur Libri". Në këtë kontekst, Kur'ani thotë:

"O Ithtarë të Librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thuani tjetër gjë për All-llahun përveç asaj që është e vërtetë".

(Nisaë, 171).

"O Ithtarë të Librit, juve ju erdhi I dërguari jonë që ju sqaron...!"

(Maide, 15).

"O Ithtarë të Librit, ejani në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush...!"

(Ali Imran, 64).

Kur i shkruante Pejgamberi a.s. letrat për perandorët dhe mbretërit e krishterë, si Nexhashiut e Mukavkisit, u drejtohej me ajetin kur'anor:

"E thuaju edhe atyre që u është dhënë Libri dhe injorantëve: "A pranuat Fenë islame?"

(Ali Imran, 20).

Kur'ani nuk u drejtohej as idhujtarëve me fjalët "O ju idhujtarë!" por "O ju njerëz!".

Idhujtarët përmenden me titullin e "shirkut" dhe "kufrit" vetëm në suren "El-Kafirun", dhe vetëm atëherë kur idhujtarët i humbën shpresat, se muslimanët do të largohen nga besimi i tyre, gjegjësisht nga monoteizmi. Këtu disa herë përsëritet përforcimi dhe në fund përfundon me një tolerancë të madhe ku thuhet:

"Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!"

(Kafirunë, 6)

I njëjtë është edhe ajeti kur'anor:

"Po nëse ata të përgënjeshtrojnë ty, thuaj: "Mua më takon (shpërblimi nga) vepra ime, e juve nga veprimi juaj, ju nuk përgjigjeni për atë që bëj unë, e as unë për atë që bëni ju".

(Junus, 41).

Islami u konfrontua me idhujtarinë si dhe Pejgamberi a.s. me idhujtarët, ngase idhujtarët nuk e pranonin konceptin e Islamit e të Pejgamberit a.s. dhe thoshin: "Ne kemi fenë tonë e ju (muslimanët) nuk keni fenë tuaj; ne mund të punojmë e ju jo, ne kemi të drejtë t'i adhurojmë idhujt e ju nuk keni të drejtë ta adhuroni All-llahun dhe se ne kemi të drejtë ta rikthejmë në fenë tonë atë që pranon fenë tuaj".

Edhe një karakteristikë tjetër e dialogut në formën më të mirë është përqëndrimi në pikat e takimit mes teje dhe polemizuesit. Kur'ani e aplikon këtë metodë kur zhvillon dialog me Ithtarët e Librit, gjegjësisht me hebrenjtë dhe të krishterët.

"Ithtarët e Librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj), vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: "Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij!"

(Ankebut, 46)

"Thuaj: "A doni të grindeni me ne për All-llahun, e Ai është Zoti ynë dhe Zoti juaj...!"

(Bekare, 139)

Nëse kështu duhet të veprojë muslimani me atë që zhvillon dialog nga ithtarët e Librit, të cilët nuk kanë besim të njëjtë, nuk besojnë në Muhammedin a.s. se është Pejgamber i Zotit, nuk e pranojnë Kur'anin si libër të Zotit dhe e refuzojnë Islamin si ligj nga Zoti, atëherë si duhet të jetë qëndrimi i tij ndaj vëllait të vet musliman, i cili beson në parime të përbashkëta, si psh. në fe, sheriat, pejgamber e Kur'an?!...

Këtu do të theksoj një shembull të mrekullueshëm nga mënyrat e dialogut të cilat i aplikon Kur'a-ni me ata që mendojnë ndryshe, vetëm e vetëm për t'i përfituar e afruar. Metoda kur'anore nuk nxit armiqësi por qetësim dhe afrim.

Zoti i Madhëruar ju drejtohet idhujtarëve në suren "Sebe'ë" dhe ju thotë:

"Thuaj: "Kush ju furnizon nga qiejt e nga toka?" Thuaj: "All-llahu, e atëherë ose ne ose ju jemi në rrugë të drejtë, apo në një humnerë të dukshme!" Thuaj: "Ju nuk jeni përgjegjës për gabimet tona, e as ne nuk përgjigjemi për atë që veproni ju!" Thuaj: "Zoti ynë na tubon neve dhe juve, e pastaj me drejtësi gjykon mes nesh, se Ai është gjykatës i drejtë, i dijshëm"

.(Sebe'ë, 24-26)

Në komentin e këtyre ajeteve, Fahruddin Raziu thotë:

"Ky është udhëzim i Zotit për Pejgamberin e Tij në zhvillimin e dialogut në shkenca e në (sfera tjera), ngase njëri nga polemizuesit kur i thotë tjetrit: "Ti je gabim dhe ajo që e thua është gabim", atëherë e hidhëron e në momentet e hidhërimit nuk ka logjikë të shëndoshë dhe humbet qëllimi... Edhe pse Zoti nuk dyshon në udhëzimin e Vet, përsëri u thotë: "Ose ne ose ju".

Zoti i Madhëruar gjithashtu u thotë: "Ju nuk jeni përgjegjës për gabimet tona, e as Ne nuk përgjigjemi për atë që veproni ju". Me këtë pjesë të ajetit, ai ia bashkangjet vetes gabimin me qëllim që të mos i hidhërojë e të mos e kuptojnë.

Pastaj I Madhëruari thotë: "Zoti ynë na tubon neve dhe juve, e pastaj me drejtësi gjykon mes nesh, se Ai është gjykatës i drejtë, i dijshëm," me qëllim që ta fokusojë çështjen rreth të cilës duhet menduar.[118]

Nga rrëfimet e Kur'anit vërehet qartë se pejgamberët kanë zhvilluar polemika e dialogje me popujt e vet në mënyrën më të mirë, më të bukur e më të butë, dhe si shembull konkret përmendim dialogun e Nuhit a.s. me popullin e vet për ta treguar kulturën e lartë pejgamberike:

Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar në suren "Hudë" thotë:

"Ne e patëm dërguar edhe Nuhin te populli i vet (me porosi të njëjtë si Muhammedin që t'u thotë): "Unë ua tërheq vërejtjen haptazi. Që të mos adhuroni tjetërkë pos All-llahut, sepse unë kam frikë për dënimin tuaj në ditën e pikëllueshme". Paria që nuk besoi nga populli i tij, tha: "Ne nuk të shohim ndryshe vetëm si njeri, sikurse edhe ne, ne nuk po shohim se të pasoi kush, përveç atyre që janë më të poshtërit e më mendjelehtët nga mesi ynë, dhe ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne, përkundrazi, ne ju konsiderojmë gënjeshtarë!" (Nuhu) tha: "O populli im, më thuani nëse unë jam i mbështetur në argument të qartë nga Zoti im dhe Ai më dha mëshirë nga ana e Tij, e juve u janë fshehur ato (argumentet ngase jeni dhënë pas kësaj jete), a mos do t'ju detyrojmë për to (pranimin e tyre), kur ju jeni urrejtës të tyre! O populli im, unë për këtë nuk

[118] *"Et-tefsirul-kebir",* Fahruddin Razi, 25/257.

kërkoj prej jush ndonjë pasuri, shpërblimi im është vetëm te All-llahu. Dhe unë kurrsesi nuk i largoj ata që besuan, ata janë afër Zotit të tyre; por unë ju shoh si popull që nuk di e nuk kupton. O populli im, a nuk po mendoni se nëse unë i përzë ata, kush do të më mbrojë mua nga All-llahu (dënimi i Tij)? Unë nuk ju them juve se te unë janë thesarët e All-llahut, as nuk ju them se unë e di të fshehtën, as nuk ju them se unë jam engjëll, as nuk ju them atyre që sytë tuaj i nënçmojnë se All-llahu nuk u dhuroi atyre të mira. All-llahu e di më së miri se çka ka në shpirtrat e tyre, pse atëherë unë konsiderohem zullumqar?!" Ata thanë: "O Nuh, ti polemizove me ne dhe e zgjate polemikën tonë. Urdhëro, e nëse flet të vërtetën, sille pra, të na godasë ajo me çka na kërcënohesh!" Ai tha: "Atë ua sjell vetëm All-llahu, po qe se dëshiron, e ju nuk mund ta pengoni! Nëse përpiqem t'ju këshilloj, po qe se All-llahu dëshiron t'ju humbë, këshilla ime nuk ju bën dobi. Ai është Zoti juaj dhe vetëm te Ai do të ktheheni".

(Hudë, 25-34).

Disa polemizues rreth çështjeve shkencore dhe fetare mendojnë se zhvillojnë polemika mirëpo, në të vërtetë, ajo që është në bindjet e tyre është shpatë që derdh gjak të kuq. Më mirë do të ishte sikur mbi ta të mbizotëronte atmosfera e qetë shkencore, kurse nga fjalët e tyre të frynte erë e lehtë e jo furtunë.

S'ka nevojë për fjalë rigoroze, ngase ato s'kanë ndikim dhe nuk janë frytëdhënëse në shpirtrat e njerëzve. Sheukiu thotë:

"Dallimi në mendime nuk e shkatërron dashurinë".

Koncepcioni i tij ka të bëjë me atë dallim që mbështetet në kulturën dhe objektivitetin e dialogut dhe që është larg provokimeve emocionale, e në të kundërtën, duhet të kihet kujdes ngase pasojat mund të jenë të rënda dhe drastike.

Sipas një poeti, zemrat e thyera janë sikur qelqi, i cili kur thyhet nuk ngjitet.

Zgjedhja e fjalëve dhe termave përkatës në raste konkrete zgjidh probleme e mosmarrëveshje, dhe pikërisht kjo u preferohet "du'atëve" (thirrësve në fe) dhe mendimtarëve muslimanë, ngase në këtë mënyrë njerëzit nuk do t'i kthehen Islamit ngase ata as që janë larguar prej tij, por do të përparojnë në Islam.

Pra, thirrësit islamë dhe aktivistët muslimanë nuk kanë nevojë të përdorin fjalë që përçajnë e shkapërderdhin dhe që nuk e mbrojnë unitetin e bashkimin.

Si të veprohet ndryshe, kur udhëzimet pejgamberike urdhërojnë përgëzimin e jo dëbimin!

Në një transmetim unanim nga Enesi, thuhet se Pejgamberi a.s. ka thënë:

"Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos dëboni!"

PËRMBYLLJE
Ç' DËSHIROJMË ME KËTË HULUMTIM?

Vërtet, ç'dëshirojmë me këtë hulumtim?

Dëshirojmë që muslimanët e gjithë botës të marrin një qëndrim të përbashkët ndaj çështjeve të rëndësishme të ummetit, ndaj vlerave të mëdha të da'ves dhe të mos jetë dallimi në çështjet e dorës së dytë dhe në ato të pjesërishme me pengesë para bashkimit, solidaritetit e unitetit përballë armikut të përbashkët si dhe para realizimit të qëllimeve të përbashkëta jetësore.

Dallimet në komentimet e pjesërishme nuk na dëmtojnë në qoftë se jemi të bashkuar në parimet thelbësore e në qëllimet e përgjithshme dhe në qoftë se e kuptojmë se dallimet e tilla nuk shkaktojnë përçarje, armiqësi e urrejtje.

E gjithë kjo realizohet në qoftë se e kuptojmë fikhun e dallimeve, kulturën e dialogut në këtë sferë dhe parimet e tij shkencore e morale.

Ky ishte pra edhe qëllimi i këtij hulumtimi, dhe shpresoj se e kam kryer me sukses.

Përpjekjet e mundimshme që po i bën ummeti ynë musliman në të gjitha anët e botës për t'u çliruar, përparuar e bashkuar në bazë të fesë sonë të pastër, duhet të na largojnë nga të gjitha dallimet dytësore e t'i harrojmë të gjitha konfliktet e brendshme, me qëllim që të bashkohemi para intrigave të fuqishme armiqësore, të cilat janë unike vetëm atëherë kur bashkohen kundër nesh. Në këtë kontekst, Kur'ani famëlart thotë:

“Ata që e mohuan të vërtetën janë miq të njëri-tjetrit. E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoni e të kujdeseni për njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmujë e madhe në tokë”.

(Enfalë, 73).

Në qoftë se individët, shoqëritë e popujt kanë qëllim të pastër, atëherë ballafaqimet dhe vështirësitë i bashkojnë në një rresht, e kështu edhe Zoti i urdhëron muslimanët:

“All-llahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij të rreshtuar si të jenë ndërtesë e fortifikuar”.

(Saff, 4)

Fronti islam te ne nuk ka përparuar shumë edhe pse në shpirtrat e “ummetit ekziston fuqi e madhe dhe reale, e cila prezenton vetëdijen, historinë dhe realitetin e ummetit”.

Faktori kryesor i mospërparimit të frontit islam qëndron në faktin se fuqia është e ndarë dhe e përçarë, e sikur të bashkohej e të mbështetej në parimin e solidaritetit, bashkimit e bashkëpunimit , kundër mosmarrëveshjeve, nënçmimeve e koprracisë, atëherë rruga e ardhmërisë sonë shumë shpejtë do të hapej, dhe në këtë mënyrë shpejtësia jonë do të krahasohej me atë të raketës e jo me hapat e ngadaltë të breshkës.

Pra, të fillojmë një epokë të re ku të gjithë do ta bashkojmë tërë potencialin tonë intelektual e moral, të cilin deri diku e ilustruam në këtë studim tonin.

Edhe më parë kam bërë thirrje për bashkimin e domosdoshëm të aktivistëve dhe lëvizjeve islame, për solidarizimin midis tyre, për thellimin e marrëveshjeve, për hapjen e shtigjeve të dialogut në çështjet diskutabile dhe për shfrytëzimin e mundësive maksimale për të shpëtuar nga dallimet e

ndryshme. Një thirrje të tillë e kam bërë vite më parë në revistën "El-Umme" nën titullin "Ku qëndron gabimi?!"

Ky studim është përforcim dhe detajizim i një thirrjeje të tillë dhe shpresoj të jetë për hir të Zotit të Madhëruar dhe për t'i ndihmuar fesë së Tij. Ky punim është thirrje për të gjithë ithtarët e Kibles, për të gjithë që e kanë pranuar All-llahun si Zot, Islamin si fe, Muhammedin a.s. si pejgamber dhe Kur'anin si udhërrëfyes, me shpresë se do t'i harrojnë mosmarrëveshjet e përçarjet e tyre përballë fuqive ateiste, kryqtare, cioniste e idhujtare, edhe atë, në qoftë se mendojnë e kuptojnë siç duhet.

Çdo refuzim i kësaj thirrjeje në këto kohë kritike, konsiderohet i paarsyeshëm dhe i papranuar te Zoti dhe te ata që kanë besuar. Refuzimi i tillë gjithashtu nuk ka kurrfarë logjike fetare e morale, meqë pas tij qëndron vetëm hipokrizia e fshehur ose marria e dukshme, ashtu siç quheshin më parë fanatikët ekstremistë.

Thirrësi, që është i pajisur me urtësi nga Zoti, është i sinqertë në misionin e tij, tenton dhe insiston në aktivitet të tillë derisa t'ua hapë Zoti veshët, mendjet dhe zemrat e të përgjigjen në mënyrë pozitive:

"Me lejen e All-llahut, toka e mirë mbinë bimët".

(A'raf, 58).

IMAM HASAN EL-BENNA DHE FIKHU I DALLIMEVE

Në mesin e ripërtërirësve bashkëkohorë të Islamit nuk kam parë ndonjë që e njeh fikhun e dallimeve më thellësisht, që e ka kuptuar nevojën e bashkimit të fjalës midis xhemateve fetare dhe institucioneve islame dhe që ka kujdes ndaj bashkimit të aktivistëve të Islamit më shumë se imami martir, Hasan El-Benna.

Thirja e tij doli në skenë në momentin kur njerëzit përjetonin përçarje e shkapërderdhje në territorin e shteteve arabe dhe islame.

ASPEKTI POLITIK

Rënia e Hilafetit dhe shtimi i flamujve të ngritur pas tij, mosekzistimi i një ombrelle që e mbulon tërë ummetin islam nën parimin e besimit dhe dështimi i përpjekjes për ringjalljen e idesë së hilafetit ose për transferimin e tij në ndonjë vend tjetër, ndikuan që të valojnë flamuj kombëtarë të cilët luftojnë njëri-tjetrin dhe të formohen parti politike të cilat janë marrë vesh që të mos merren vesh dhe të cilat i shfrytëzon armiku për nxitje të konflikteve të brendshme.

ASPEKTI IDEOLOGJIK

Doli në skenë ideja e uesternizimit dhe e imitimit të qytetërimit perëndimor në të gjitha aspektet, qofshin ato pozitive apo negative, të mira apo të këqija.

Në këtë mënyrë kjo lëvizje synon zbatimin e obcionit liberal-demokratik kapitalist të qytetërimit të Perëndimit.

Në anën tjetër, ekziston lëvizje që thërret në të majtën socialiste apo komuniste, ashtu siç ekziston edhe lëvizja që thërret në një izolim të plotë nga qytetërimi i tillë, për të shpëtuar nga ndikimi i tij.

ASPEKTI FETAR

Këtu ekzistojnë disa lëvizje që kanë obcione specifike e autonome:

Lëvizja e Az-harit me katër medhhebet: dallimet e dijetarëve rreth ixhtihadit dhe imitimit.

Lëvizja sufiste e cila përmes shejhëve, prijësve dhe ithtarëve të vet ka depërtuar thellë në mesin e popullit.

Shoqatat islame të cilat ndahen në: Shoqata Sheriative, Shoqata të Ndihmuesve të Sunnetit, Shoqata e Rinisë Muslimane, Shoqata e Rinisë së zotëriut tonë, Muhammedit a.s. etj.

Që nga fillimi i thirrjes (da'vetit) në qytetin ismailije profesori El-Benna gjithmonë është ballafaquar me konfliktet midis shoqatave fetare, posaçërisht midis shoqatave selefiste dhe atyre sufiste. Konfliktet e tilla u futën edhe nëpër xhamitë saqë i përçanë faltarët e namazit në dy grupe që ofendojnë njëri - tjetrin, që nuk pranojnë të falen njëri pas tjetrit dhe që e akuzojnë njëri-tjetrin për kufër. Atmosfera e tillë ndikoi që martiri El-Benna t'i braktisë konfliktet e tilla të rrepta që zhvilloheshin nëpër xhami e të formojë organizma tjerë që ishin pa komplekse të tilla por edhe pa ndonjë përvojë të madhe fetare. Pra, aktivitetet e tilla ai filloi t'i zhvillojë nëpër klube, kafene e në vende të tjera.

Imami El-Benna i zbërthente dallimet ideologjike e fetare me një mençuri të madhe. Ai nuk i refuzonte mendimet pozitive kombëtare por i ndante dhe i klasifikonte, e pastaj i pranonte apo i refuzonte pas analizave të mbështetura në baza islame. Ai i pranonte mendimet kombëtare që nuk e kundërshtonin Islamin, e këtë e ka shpjeguar shumë qartë në traktatin "Thirrja jonë".

Ai më së shumti përqëndrohej në dallimet fetare dhe i zbërthente problematikat e tilla në shumë traktate të veta, madje i përpiloi "Njëzet parimet" rreth të cilave mund të bashkohen ata që punojnë në shërbim të Islamit, dhe për këtë shkak ai nuk e ka thënë fjalën përfundimtare në disa çështje, si psh., në çështjen e "teves-sul-it", rregullsia në "ibadete", ngase qëllimi i tij ishte unjësimi i radhëve dhe bashkimi i fjalës.

Pra, ai interesohej për çështjet e përgjithshme e jo për ato të pjesërishme, ngase të parat bashkojnë e unjësojnë kurse të dytat përçajnë e shkapërderdhin.

Për ne është me rëndësi që ta citojmë atë që e cekë në traktatin "Da'vetuna", rreth qëndrimit të da'vetit (thirrjes) ndaj dallimit fetar. Ky koncept vërteton potencialin e tij intelektual dhe

dëshmon vizionin e tij të thellë e dëshirën e tij të kahershme për ndërtim e jo për shkatërrim, për bashkim e jo për përçarje. Edhe pse kam përmendur diç nga kjo në librin tim "Rizgjimi islam ndërmjet kundërshtimit dhe ekstremizmit", mendoj se nuk është keq t'i ripërsëris mendimet e tij me qëllim përkujtimi e përforcimi.

Ai (Zoti e mëshiroftë) thotë:

"Tash të flas për "da'vetin" tonë para mospajtimeve fetare dhe mendimeve medhhebore.

BASHKOJMË E NUK PËRÇAJMË

Dije (Zoti të bëftë të kuptosh) së pari, se thirrja e vëllezërve muslimanë është thirrje e përgjithshme që nuk i përket ndonjë fraksioni të posaçëm dhe nuk mbështetet në mendimin të cilin njerëzit e njohin si specifik e individual, por depërton në thellësi të fesë. Ne dëshirojmë që të bashkohen mendimet e idetë, me qëllim që aktiviteti të jetë sa më efektiv, sa më i madh dhe sa më frytdhënës. Da'veti i vëllezërve është thirrje e sinqertë, e pastër dhe nuk është e ngjyrosur me ndonjë ngjyrë, ngase është gjithmonë me të vërtetën, dëshiron bashkimin, urren përçarjen. Përvoja më e keqe e muslimanëve është përçarja e shkapërderdhja kurse parimi i fitores së tyre është dashuria dhe uniteti. Ummeti do të përmirësohet vetëm nëse vepron ashtu si vepruan të parët.

Ky ishte parimi kryesor, qëllimi parësor i çdo vëllai musliman dhe besimi i thelluar në shpirtrat tanë, prej të cilit nisemi dhe në të cilin thërrasim.

DALLIMI ËSHTË I DOMOSDOSHËM

Ne mendojmë se dallimi në çështjet dytësore të fesë është nevojë e domosdoshme. Nuk mund t'i bashkojmë idetë e mendimet e ndryshme në çështjet e tilla dytësore për shkak se ekzistojnë dallime midis intelekteve gjatë procesit të induksionit në të kuptuarit e koncepteve, në lidhshmërinë e të vërtetave dhe në komentimin e ajeteve e hadithe brenda definicioneve gjuhësore e normative. Meqë natyrat e njerëzve janë të llojllojshme, atëherë duhet të ketë dallime.

Pastaj këtu ndikon horizonti i gjerë i diturisë ngase ndokush e arrinë atë që s'e ka arritur tjetri. Maliku i thotë Ebu Xha'ferit: "Sahabët e Pejgamberit a.s. janë shpërndarë në vende (të ndryshme) dhe në çdo popull ka dituri, e në qoftë se i obligon në një mendim, lind fitneja".

Gjithashtu ndikon edhe e vërteta se ambientet janë të ndryshme, këtu si shembull konkret kemi Shafi'iun, i cili në Egjipt kishte dhënë fetva që nuk u ngjasonin fetfave të tij të dhëna në Irak.

Pastaj ndikon edhe qetësia shpirtërore në pranimin e transmetimit, si p.sh., ai që e pranon me bindje të plotë transmetimin nga ndonjë transmetues, nuk është i qetë në transmetimin e ndonjë transmetuesi tjetër.

Po ashtu ndikon edhe llojllojshmëria e domethënieve si psh., ndonjëri i preferon veprat e njerëzve më shumë se hadithet "ahad", e ndonjëri jo.

UNANIMITETI NË ÇËSHTJET DYTËSORE ËSHTË I PAKUPTIMTË

Të gjithë këta faktorë që i përmendëm, na detyrojnë të bindemi se unanimiteti në çështjet dytësore të fesë është i pakuptimtë, madje e kundërshton natyrën e fesë. Zoti dëshiron që kjo fe të jetë e përshtatshme për të gjitha kohët dhe për këtë shkak ajo është fleksibile dhe e butë, e nuk është statike e as e vrazhdë.

KËRKOJMË FALJE PREJ ATYRE QË MENDOJNË NDRYSHE NGA NE

Ne jemi të bindur në gjithë këtë dhe kërkojmë falje prej atyre që mendojnë ndryshe nga ne në disa çështje dytësore. Jemi të mendimit se dallimi i tillë nuk mund ta pengojë lidhshmërinë e zemrave, dashurinë e ndërsjellë dhe bashkëpunimin në vepra të mira.

Meqë parimet dhe rregullat e Islamit na bashkojnë, atëherë edhe ne edhe ata jemi muslimanë! A nuk dëshirojmë të gjithë që të kemi qetësi në shpirtrat tanë? A nuk obligohemi që ta duam për vëllezërit tanë atë që e duam për vete?

Pra, pse të ketë mosmarrëveshje?

Pse të mos i analizojmë mendimet tona së bashku? Pse të mos pajtohemi në një atmosferë të pastër e përplot dashuri, pasi që ekziston ajo që na thërret në mirëkuptim?

Sahabët e Pejgamberit a.s. kanë dhënë fetva të ndryshme, por a ndikoi një gjë e tillë që edhe ata vetë të përçahen? A u shkapërderdhën? Jo! Ngjarja e namazit të ikindisë në Kurejdha u theksua pak më parë!

Pasi që ata kanë patur mendime të ndryshme dhe kanë jetuar në kohën e Pejgamberit a.s. dhe se kanë qenë më të diturit në parimet e Sheriatit, atëherë pse të mbytemi nga dallimet e pavlefshme por jo edhe të parrezikshme? Pse nuk veprojmë ashtu siç vepruan imamët të cilët nuk u pajtuan në disa çështje edhe pse ishin njohësit më të mirë të Librit të Zotit dhe të Hadithit pejgamberik? Në qoftë se formohen mendime të ndryshme nga problematikat më të njohura të dorës së dytë, si p.sh., thirrja e ezanit pesë herë në ditë, atëherë si mendon për çështjet e vogla të cilat mbështeten në zbërthimet racionale e induktive?

Gjithashtu vlen të theksohet se njerëzit kanë shkuar te halifi kur janë ballafaquar me ndonjë problematikë të tillë divergjente dhe ai e ka zbërthyer, mirëpo tash ku është halifi? Në qoftë se ndodh diç e tillë, atëherë për muslimanët më mirë do të ishte t'i drejtohen gjykatësit (kadisë) sepse, në të kundërtën, do të paraqiten mosmarrëveshje të reja.

Vëllezërit muslimanë shumë mirë i kuptojnë gjërat e tilla dhe i pranojnë me zemërgjerësi ata që mendojnë ndryshe. Ata mendojnë se në mesin e çdo populli ka dituri dhe se në çdo da'vet ka të vërteta e të pavërteta.

Këta e hulumtojnë vetëm të vërtetën dhe bëjnë përpjekje që t'i bindin të tjerët me butësi në qoftë se binden, mirë, e në qoftë se jo, atëherë lusin All-llahun që t'i udhëzojë të dy palët.

Këtë metodë e zbatojnë vëllezërit muslimanë para divergjentëve në çështjet dytësore të fesë së Zotit. Mund të rrumbullakoj se vëllezërit e lejojnë dallimin, e urrejnë fanatizmin dhe ekstremizmin në mendime, përpiqen ta arrijnë të vërtetën dhe i bindin njerëzit në mënyrë të butë e të mbushur përplot dashuri.

Kjo është metoda e cila prezenton objektivitetin (mesataren) islam, në të jemi të bindur dhe në të thërrasim!

Vetëm Zoti e thotë të vërtetën (apsolute) dhe vetëm Ai udhëzon në rrugë të drejtë.